



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 44/2022 regjistër (JR)
Datë 04.10.2022

Nr. 25 i vendimit
Datë 26.03.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 26.03.2025, ditën e mërkurë, ora 10:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Arben Sharra, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 546, datë 30.06.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes, Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Arben Sharra (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).
 - 2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë, në zbatim të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë¹ së subjektit të rivlerësimit, duke konkluduar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.
 - 2.2. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i ka përcjellë Komisionit Raportin e Grupit të Punës, me anë të të cilit është konstatuar: *përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Arben S. Sharra*².
 - 2.3. KLP-ja, pasi ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dosje të tjera, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit³.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni kreu hetimin administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të nenit 4, pika 2, nenit 58, pika 1, shkronja “c”, si dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016,

¹ Raporti i ILDKPKI-së është dërguar në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 27.09.2018.

² Raporti i DSIK-së nr. {***} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZh-së nr. {***}, datë 26.05.2021.

³ Raporti i KLP-së nr. {***} prot., datë 11.05.2021.

“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni vendosi: *“Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arben Sharra, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”*. Këtë vendimmarrje, Komisioni e ka mbështetur në konkluzionet si më poshtë.

3.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

(i) *subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë të pasurive dhe burimeve të ligjshme të tyre në deklaratën e pasurisë vetting, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016;*

(ii) *subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016;*

(iii) *subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, sipas parashikimeve të pikës 5, të Aneksit D, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë;*

(iv) *subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurive në pronësi/posedim/përdorim, në kuptim të Aneksit D/5 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016;*

Në këto rrethana, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat, sipas pikës 3, të nenit 61, të këtij ligji, përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

3.2 Për kriterin e vlerësimit të figurës

Subjekti i rivlerësimit, z. Arben Sharra, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

3.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Shkeljet e konstatuara në kriterin e aftësive profesionale nuk janë të tilla, që mjaftojnë për të kualifikuar subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

3.4 Në lidhje me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, Komisioni ka konkluduar se:

Në vlerësimin tërësor të procedurave, lidhur me cenimin e besimit të publikut, duke vlerësuar në tërësi kriterin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, rezultojnë disa rrethana, të cilat, të analizuara së bashku e të para në harmoni me njëra tjetrën, tregojnë për një sjellje të subjektit të rivlerësimit në raport me detyrën, e cila do të ishte e papranueshme për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe te roli i subjektit, si një funksionar i denjë i këtij sistemi. Në vlerësimin e Komisionit, këto rrethana do të përbënin mjaftueshëm një bazë të dhënash, mbi të cilën mund të konkludohej se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, edhe sikur të mos ekzistonin rrethanat që kanë bërë të mundur aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke bërë të zbatueshëm në mënyrë autonome

paragrafin 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, si një prej shkaqeve të shkarkimit nga detyra të subjektit.

4. Në konkluzionin përfundimtar të hetimit të kryer për procesin e rivlerësimit, Komisioni arrin në përfundimin se: (i) Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016. (ii) Nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

III. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit

5. Subjekti i rivlerësimit Arben Sharra ka ankimuar vendimin nr. 546, datë 30.06.2022, të Komisionit, duke e konsideruar si vendim të marrë në shkelje të parimeve të përcaktuara nga neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNJ”) dhe neni 42 i Kushtetutës, për një proces të rregullt ligjor, në interpretim të gabuar të provave të administruara. Bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”): (1) çeljen e hetimit gjyqësor dhe kalimin e çështjes në seancë publike, duke përsëritur hetimin gjyqësor, me qëllim marrjen në shqyrtim edhe një herë të provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit në Komision, në funksion të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike; (2) ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Arben Sharra, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
6. Vendimi i Komisionit është kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit, si në zbatimin e ligjit procedural, ashtu edhe sa i përket zgjidhjes në themel të çështjes për kriterin e vlerësimit të pasurisë, si dhe konstatimit mbi cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë.
7. *Shkaqet procedurale të ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, që lidhen me procesin e rregullt ligjor, në mënyrë të përmbledhur, konsistojnë në sa vijon:*

7.1. Shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, pasi gjykata nuk ka qenë e pavarur dhe e paanshme, ka treguar njëanshmëri dhe paragjykim.

(i) Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka vepruar nën doza të larta paragjykimi dhe në shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë.

(ii) Subjekti pretendoi se në vendimin e Komisionit përsëritet gjithmonë si refren togfjalësh: “argumentet dhe provat e subjektit nuk janë të bazuara” dhe, madje, në shumë pika të vendimit, Komisioni shton fjalinë: “por dhe sikur të merren parasysh këto argumente, rezultati nuk ndryshon”. Të tilla fjali në përmbajtjen e vendimit e bëjnë vendimmarrjen e Komisionit haptazi të pabazuar. Gjatë seancës dëgjimore në Komision, argumenteve të subjektit dhe mbrojtëses së tij, të ilustruara me vendime të Kolegjit, relatorja e çështjes iu përgjigjet: “Le ta vendosin ata kur të shkojë çështja në Kolegj”. Pra, në mënyrë të pandërgjegjshme, relatorja i bëri me dije subjektit të rivlerësimit se shkarkimi i tij ishte i paravendosur dhe argumentet e tij mund t’i paraqiste në Kolegj.

7.2. Shkelje të nenit 7 të KEDNJ-së, për shkak se është cenuar parimi i sigurisë juridike. Komisioni i ka kërkuar subjektit të justifikojë bindshëm të ardhurat e siguruara rreth 30 vite më përpara, nga

prindërit e tij. Subjekti i rivlerësimit është ngarkuar me një barrë prove të paarsyeshme dhe është shkarkuar nga detyra për një “shkelje administrative”, e cila edhe sikur të qëndrojë, nuk është kryer për faj të tij.

7.3. Komisioni në vendim ka përdorur koncepte të paqarta, të papërcaktuara dhe të pasqaruara nga ligji nr. 84/2016, duke sjellë si pasojë interpretimin e tyre në mënyrë arbitrare dhe në kundërshtim flagrant me legjislacionin e zbatueshëm.

7.4. Shkelje e parimit të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, duke e trajtuar subjektin e rivlerësimit, z. Sharra, për situata të njëjta, në mënyrë të diferencuar nga subjektet e tjerë rivlerësues. Standardi i dyfishtë i mbajtur nga Komisioni, është një argument që mbështet konkluzionin e subjektivizmit të vlerësimit të provave në dosjen e tij.

7.5. Komisioni ka kryer hetim të pavarur dhe ka nxjerrë konkluzione të gabuara, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 3, nenit 4, pika 2 dhe nenit 58, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Subjekti nuk ka kryer fshehje të pasurisë, deklaram të rremë dhe deklarimet e tij janë në përputhje me ligjin. Duke interpretuar në mënyrë sistematike, së bashku nenet 59 dhe 61 të ligjit nr. 84/2016, i vetmi shkak për të cilin mund të merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, është ai i parashikuar nga pika 1 e nenit 61 të këtij ligji: *deklarimi më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme*, në situatat kur Komisioni nuk gjen dëshmi pozitive ose fshehje të pasurisë.

7.6. Konkluzionet e Komisionit në vendimin përfundimtar, nuk janë rrjedhojë e vlerësimit të drejtë dhe të paanshëm të provave të depozituara e shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe provave të administruara nga vetë Komisioni në këtë proces.

8. *Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e pasurisë, në mënyrë të përmbledhur, paraqiten si më poshtë:*

8.1. Për pasurinë “*Shtëpi banimi 2 (dy) kate + papafingo me sipërfaqe 364 m² dhe 500 m² truall*”, në Kodër - Kamëz, Tiranë:

(i) Konkluzionet e Komisionit janë tërësisht të gabuara dhe të paragjykuara, nuk i jepen përgjigje pretendimeve të subjektit, madje Komisioni argumenton fakte të paqena, lidhur me pasaktësinë në deklarimin e kësaj pasurie, përcaktimin e vitit të ndërtimit, mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së ndërtimit, si dhe mungesën e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e saj.

(ii) Ligjshmëria e krijimit të katit të dytë dhe papafingos, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit, nuk është objekt verifikimi në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Nga aktet e administruara përcaktohet saktësisht se në pronësinë e subjektit të rivlerësimit është regjistruar dhe pronësia e truallit prej 500 m², poshtë godinës, si pjesë integrale e saj.

(iii) Konkluzioni i Komisionit, për të moskonsideruar të ardhurat e siguruar nga prodhimi dhe shitja e produkteve bujqësore, duke arsyetuar se pretendimet e subjektit mbeten në nivel deklarativ, është i gabuar.

8.2. Për pasurinë “*Banesë, ndodhur në parcelën me sipërfaqe 370.15 m²*”, pretenduar të ndërtuar nga z. I. L., në Kodër - Kamëz, Tiranë. Konkluzioni i Komisionit se: *krijohet bindja se kjo është pasuri e fshehur e subjektit*, bazuar vetëm në faktin se në procedurat e legalizimit është shënuar numri i telefonit të tij, është i pabazuar.

8.3. Për “*Të ardhurat paradhënie, marrë nga I. L., në vitin 2014 dhe 2015*”, si rezultat i shitjes së banesës dy kate + papafingo në Kodër - Kamëz, në vitin 2017, argumenti i përdorur nga Komisioni, se përfshirja e këtyre shumave në analizën financiare, *nuk ndikon në rezultatin përfundimtar të saj*, është i papranueshëm dhe tregon haptazi që Komisioni ka paravendosur rezultatin e hetimit dhe konkluzionet i nxjerr bazuar në faktin nëse rrethanat ndryshojnë ose jo rezultatet e hetimit.

8.4. Për pasurinë “*Apartament banimi me sipërfaqe 128.1 m² dhe garazh, me sipërfaqe 45 m²*”, në rrugën “{***}”, Tiranë:

(i) Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të sakta dhe ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e këtyre pasurive. Nëse në analizën financiare do të përfshiheshin të ardhurat nga produktet bujqësore, rezultati financiar do të rezultonte me balancë pozitive.

(ii) Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove për konkluzionin në vendim, “*se mospagimi i shumës 13.127 euro, për shkak të bllokimit të llogarisë bankare të shoqërisë “{***}” ShPK, duhet të jetë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti duket se, së paku në mënyrë indirekte, mund të ketë ndihmuar këtë shoqëri për të mos deklaruar të ardhurat e saj reale, duke u bërë pengesë për mosekzekutimin e veprimeve përmbaremore*”.

(iii) Ndryshe nga sa ka konstatuar Komisioni, babai i subjektit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të dhënë hua shumën prej 4.000 euro, në vitin 2013, të cilën Komisioni nuk e ka përfshirë në analizën financiare.

(iv) Diferenca negative e rezultuar, në verifikimin e këtyre pasurive, nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk përbën shkak për marrjen e masës disiplinore.

8.5. Për “*Të ardhurat nga toka bujqësore*”, konkluzioni i Komisionit për mospërfshirjen e tyre në analizën financiare është tërësisht i gabuar, në kundërshtim me legjislacionin tatimor dhe jurisprudencën e organeve të rivlerësimit.

8.6. Për pasurinë “*Banesë*”, në emër të prindërve, në fshatin Shëngjergj, Tiranë, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer fshehje të kësaj pasurie. Një konkluzion i tillë është i palogjikshëm, që tregon haptazi një vendim të paracaktuar dhe tërësisht të njëanshëm.

8.7. Për “*Veprimtarinë ekonomike*”, konkluzioni i Komisionit se: *ushtrimi i veprimtarisë ekonomike të shitjes së produkteve bujqësore prej tij dhe posedimi i tokës bujqësore pa titull, është në papajtueshmëri me detyrën e prokurorit*, nuk është në përputhje me parashikimet ligjore, dhe është tërësisht i pabazuar. Pavarësisht se prona figuron e regjistruar me pronar shtet, nga organet vendore është vërtetuar që ka qenë pronë e familjes së origjinës dhe njihet si “{***}”.

8.8. Për pasurinë “*Automjet Mercedes-Benz*”, blerë nga kunati, në vlerën 7.000 euro, konkluzioni i Komisionit, se ky automjet ka qenë pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, nuk është i bazuar. Automjeti ka kaluar në pronësi të subjektit të rivlerësimit, vetëm 35 ditë pas plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting* dhe vazhdon të jetë në pronësi të tij aktualisht. Konstatimi se subjekti nuk ka pasur automjet gjatë vitit 2016, nuk mund të shërbejë si indicie në favor të këtij konkluzioni të gabuar.

8.9. Për “Pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të prindërve të subjektit ⁴”:

(i) Komisioni ka hetuar pasuritë që i përkasin prindërve në tejkalim të kompetencave të hetimit, në kushtet kur ata nuk janë persona të lidhur apo të tjerë të lidhur me të.

(ii) Dyshimet e ngritura për pasuri të fshehura janë të pabazuara, pasi prindërit e subjektit kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar këto pasuri.

(iii) Konkluzioni i Komisionit se: [...] subjekti ka tentuar të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë këto pasuri, duke deklaruar të dhëna të pasakta ose duke mos i deklaruar fare, me qëllim që procesi i kontrollit dhe i verifikimit të pasurisë, i mbështetur në këto të dhëna, të prodhojë një rezultat në favor të subjektit të rivlerësimit, është tërësisht i pabazuar, i pambështetur në provat e administruara.

8.10. Për “Adresën e banimit në rrugën “{***}””, Tiranë konkluzioni i Komisionit është i pabazuar dhe në kundërshtim të plotë me aktet e administruara dhe jurisprudencën e tij, në raste të ngjashme.

8.11. Për “Cenimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë”, konkluzioni i Komisionit për të aplikuar si shkak shkarkimi nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar vetëm në një nga kriteret, nuk është i drejtë, për arsye se për zbatimin e kësaj dispozite kërkohet një vlerësim tërësor i të tria kriterëve të rivlerësimit së bashku.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

i. Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arben Sharra, vendim të cilin, nëpërmjet ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkon ta ndryshojë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas parashikimit të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimimi i ankuesit

10. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

⁴ (1) Automjet tip “Volkswagen”, i blerë nga nëna e subjektit, për shumën 5.750 euro; (2) Pasuri “apartament banimi me sipërfaqe 60.16 m²”, i ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, porositur nga babai i subjektit të rivlerësimit, në vlerën 60.000 euro; (3) Depozitë, në shumën 100.000 USD, në Raiffeisen Bank ShA, në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, me emërtim “Kursime gjatë jetës dhe trashëguar nga prindërit”.

iii. *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes*

11. Në përputhje me nenin 65, pika 1⁵ e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i çështjes në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 546, datë 30.06.2022, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Arben Sharra, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore, të zhvilluar në dhomë këshillimi, më datë 26.03.2025.
12. Në fillim të seancës gjyqësore, trupi gjykues mori në analizë shkaqet e ankimit me natyrë procedurale të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, për të vlerësuar nëse ishte i nevojshëm debati gjyqësor, për korrigjimin e ndonjë shkelje të rëndë procedurale në kuadër të cenimit të procesit të rregullt ligjor të kryer në Komision apo me qëllim konstatimin e saktë, të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike të çështjes, në kuptim të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.
13. *Subjekti i rivlerësimit pretendon shkelje të nenit 6 të KEDNj-së*, pasi sipas tij, gjykata nuk ka qenë e pavarur dhe e paanshme, si një nga parimet e procesit të rregullt ligjor, bazuar në analizën e kriterëve të përcaktuara nga GjEDNj-ja në çështjen *Volkov kundër Ukrainës*. Këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit e mbështet në drejtim të përbërjes së Komisionit, mospërfaqësimit thelbësor të gjyqtarëve në të, mospërmbushjen e kushteve të zgjedhshmërisë së anëtarëve të tij, mungesën e mekanizmit procedural sa i përket verifikimit të integritetit të lartë të tyre moral apo profesional, mbi natyrën e dyfishtë, hetimore dhe vendimmarrëse të Komisionit, si dhe kohëzgjatja e mandatit të tyre, rrethana që kanë passjellë shkarkimin e tij nga detyra.

Trupi gjykues konstaton se pretendimet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, në këtë shkak ankimi, janë trajtuar gjerësisht nga Kolegji në jurisprudencën e tij, duke nënvizuar faktin se kuadri ligjor i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve i është nënshtruar vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ekspertizën e Komisionit të Venecias⁶. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar pajtueshmërinë me Kushtetutën të ligjit nr. 84/2016 dhe ofrimin nga organet e procesit të rivlerësimit të të gjitha garancive të nevojshme për zhvillimin dhe respektimin e një procesi të rregullt ligjor⁷. Në vendimet e saj, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se: *për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së*.

Për shkak të natyrës *sui generis* të procesit të rivlerësimit, referimi në jurisprudencën e GjEDNj-së, tashmë orientohet nga vendimi i kësaj gjykate në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, që materializon vlerësimin e saj mbi institucionet e procesit të rivlerësimit në Shqipëri, në drejtim të garantimit të një procesi të rregullt ligjor. Sa i përket kriterëve të përmendura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton si vijon:

⁵ *Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; nenet 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"*.

⁶ *Opinion CDL - AD (2016) 03610*.

⁷ *Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 18.01.2017, paragrafi 67, dhe nr. 78, datë 12.12.2017, paragrafi 41*.

(i) Lidhur me përbërjen e Komisionit dhe kërkesën për përfaqësimin e gjyqtarëve në të, në paragrafët 299 dhe 300 të vendimit në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, GjEDNJ-ja ka theksuar se:

299. [...] Gjykata duhet të marrë parasysh natyrën e posaçme të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Ky proces mori jetë në përgjigje të nevojës urgjente, siç vlerësohet nga legjislatura vendase, për të luftuar nivelin e lartë të korrupsionit që kishte pushtuar sistemin e drejtësisë. [...]. Dhe është pikërisht kjo arsyeja që procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri është sui generis dhe duhet të dallohet nga çdo proces i zakonshëm disiplinor ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve.

300. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, fakti që anëtarët e KPK-së nuk vinin nga radhët e gjyqtarëve profesionistë në detyrë, ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, domethënë për të shmangur çdo konflikt individual interesi dhe për të siguruar besimin e publikut në këtë proces. Gjykata u referohet më tej kërkesave të rrepta të përzgjedhjes që anëtarët e KPK-së pritej të përmbushnin (shih paragrafin 123 më lart). Ajo vëren se këta anëtarë u përzgjedhën nga Parlamenti në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj [...].

(ii) Lidhur me mënyrën e caktimit të anëtarëve të Komisionit dhe ekzistencën e garancive ndaj presioneve të jashtme, GjEDNJ-ja, në paragrafët 295 dhe 296 të vendimit, ka vlerësuar se:

295 [...], megjithëse parimi i ndarjes së pushteteve midis organeve politike të qeverisë dhe gjyqësorit ka pësuar rritje në praktikën e saj gjyqësore, përzgjedhja ose emërimi i gjyqtarëve nga pushteti ekzekutiv ose legjislativ është i lejueshëm sipas Konventës, me kusht që, pasi të përzgjidhen ose emërohen, ata të jenë të lirë nga ndikimi ose presioni dhe të ushtrojnë veprimtarinë e tyre gjyqësore me pavarësi të plotë [...].

296. Edhe pse, në përgjithësi, Gjykata nuk ka asnjë arsye të verë në pikëpyetje mënyrën në të cilën u emëruan anëtarët e KPK-së, përsëri i mbetet asaj të vlerësojë nëse, në çështjen në fjalë, KPK-ja kishte “shfaqjen/dukjen e pavarësisë”, që kërkohet nga praktika gjyqësore e Gjykatës në lidhje me masat mbrojtëse kundër presionit të jashtëm. Kërkuesja nuk arriti të provojë se anëtarët e KPK-së që shqyrtuan çështjen e saj, kishin marrë ndonjë udhëzim ose kishin qenë nën presion nga pushteti ekzekutiv. Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e çështjes, nuk rezulton të ketë ndonjë provë të një udhëzimi të tillë ose presioni që i është ushtruar trupit gjykues nga pushteti ekzekutiv. [...].

(iii) Lidhur me pretendimin mbi natyrën e dyfishtë, hetimore dhe vendimmarrëse të Komisionit, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit në jurisprudencën e tij, se kompetenca e Komisionit, për të kryer hetimin dhe për të dhënë vendimin, është në përputhje me natyrën e procesit të rivlerësimit, si një proces administrativ i nisur kryesisht në përputhje me kompetencën që i njeh Kushtetuta dhe Kreu VII, “Procedura e rivlerësimit”, i ligjit nr. 84/2016, në të cilin detajohen kompetencat hetimore dhe vendimmarrëse të Komisionit. Për t’iu rikthyer përsëri vendimit *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, në paragrafët 307 dhe 308 të tij, GjEDNJ-ja është shprehur se:

307. Në momentin që KPK-ja mori vendimin, në përfundim të procesit, vlerësoi nëse provat e marra, përfshirë argumentet dhe dokumentet e parashtruara nga kërkuesja si përgjigje, mjaftonin për ta konfirmuar atë në postin e saj ose për të vendosur një sanksion disiplinor në përputhje me ligjin nr. 84/2016 [...]. Konstatimet paraprake të bazuara në informacionin e disponueshëm, jo në përfitim të mbrojtjes së kërkueses, nuk mund të konsiderohet se sjellin në vetvete ndonjë paragjykim për rezultatin përfundimtar që do të merret pas parashtrimeve të argumenteve të kërkueses në seancë

publike. Ajo që është e rëndësishme është që vendimi përfundimtar të merret në bazë të të gjithë elementeve në dispozicion, përfshirë provat e paraqitura dhe argumentet e parashtruara në seancë [...].

308. Prandaj, nuk ka asnjë ngatërresë mes detyrimit ligjor të KPK-së për të hapur hetimin, në të cilin nuk u bënë akuza ose konstatime të shkeljeve disiplinore të kërkueses, dhe detyrës së tij për të marrë një vendim në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të kërkueses. Një rregullim i tillë procedural nuk është i pazakontë në proceset disiplinore apo procese të tjera administrative në sistemet ligjore evropiane. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, vetëm fakti i thjeshtë që KPK-ja konstatoi gjetje paraprake në çështjen e kërkueses, nuk është i mjaftueshëm për të nxitur ndonjë frikë të justifikuar objektivisht në lidhje me paanësinë e KPK-së.

(iv) Sa i përket elementit të kohëzgjatjes së mandatit të anëtarëve të Komisionit, në paragrafin 297 dhe 298 të vendimit të sipërcituar, GjEDNj-ja shprehet:

297. Në lidhje me kohëzgjatjen e mandatit të anëtarëve të këtyre organeve, Gjykata vëren se, në përputhje me ligjin e brendshëm, anëtarët e KPK-së kanë një mandat pesëvjeçar, pa të drejtë riemërimi. Sipas Gjykatës, kohëzgjatja e caktuar e mandatit të anëtarëve të organeve të rivlerësimit, nuk përbën asnjë problem. Duke supozuar që periudha kohore e përcaktuar ishte relativisht e shkurtër, kjo është e kuptueshme, duke pasur parasysh natyrën specifike të procesit të rivlerësimit, siç vihet në dukje edhe më tej nga vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafin 164 më lart).

298. [...] As pushteti legjislativ dhe as ai ekzekutiv nuk mund të kërkojnë dorëheqjen ose largimin nga detyra të anëtarëve të organeve të Vetting-ut. Neni 17 i ligjit nr. 84/2016 përcakton rastet specifike kur ata mund të hiqen nga detyra (shih paragrafin 127 më lart). Fakti që anëtarët e institucioneve të rivlerësimit mund të hiqen nga detyra vetëm në rast të kryerjes së një shkeljeje disiplinore, në përputhje me procedurën e parashikuar nga ligji, nuk vë në dyshim garancitë e nevojshme për mos heqjen e tyre nga detyra, të cilat janë të pranishme në çështjen në fjalë.

Për sa arsyetuar më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar.

14. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni, në të gjithë procedurën e ndjekur si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, ka vepruar nën doza të larta paragjykimi dhe në shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë, çfarë ka ndikuar në humbjen e ekuilibrit gjatë procesit të vlerësimit të subjektit të rivlerësimit. Nga shqyrtimi i akteve të administruara, trupi gjykues i Kolegjit nuk evidenton të dhëna se vendimi ka qenë i paracaktuar apo i paragjykuar dhe vetë subjekti, nuk shpjegon dhe nuk shtjellon se çfarë e motivon sipas tij këtë lloj sjelljeje të Komisionit. Nga ana tjetër, procesi i rivlerësimit është tërësisht administrativ dhe kryhet mbi parimet e parashikuara në ligjin nr. 84/2016 dhe, kur është rasti, mund të zbatohen edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin për gjykatat administrative. Ndërkohë që shkelja e parimit të prezumimit të pafajësisë është një parim i procesit penal, çfarë nuk gjen zbatim dhe mbështetje në këtë proces. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk qëndron, pasi nuk gjendet i mbështetur në ligj.

14.1 Subjekti pretendoi se në vendimin e Komisionit, përsëritet gjithmonë si refren togfjalëshi: “argumentet dhe provat e subjektit nuk janë të bazuara” dhe, madje, në shumë pika të vendimit, Komisioni shton fjalinë: “por dhe sikur të merren parasysh këto argumente, rezultati nuk ndryshon”.

Të tilla fjali në përmbajtjen e vendimit e bëjnë vendimmarrjen e Komisionit, haptazi të pabazuar. Gjatë seancës dëgjimore në Komision, argumenteve të subjektit dhe mbrojtësës së tij, të ilustruara me vendime të Kolegjit, relatorja e çështjes iu përgjigjet: *“Le ta vendosin ata kur të shkojë çështja në Kolegj”*. Pra, në mënyrë të pandërgjegjshme, relatorja i bëri me dije subjektit të rivlerësimit se shkarkimi i tij ishte i paravendosur dhe argumentet e tij, mund t’i paraqiste në Kolegj.

Në analizë të këtij shkaku ankimor, trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve në dosjen gjyqësore të Komisionit⁸ dhe dëgjimi audio i seancës dëgjimore, konstatoi se relatorja e çështjes referon një çështje të trajtuar më parë nga Komisioni, sa i përket qëndrimit të mbajtur mbi të ardhurat nga produktet bujqësore në atë rast, e sjellë në vëmendje në këtë seancë nga përfaqësuesja ligjore e subjektit të rivlerësimit. Për të bërë dallimin me çështjen e subjektit të rivlerësimit, relatorja shprehet se: *“Mund t’ju sqaroja dhe që nuk ka lidhje fare me këtë lloj rasti, atje bëhej fjalë për ullahte, po që gjithsesi kur zbardhet vendimi i Kolegjit, ndoshta do jetë më e qartë si situatë”*. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit gjendet i pabazuar.

14.2 Subjekti i rivlerësimit pretendon shkelje të nenit 7 të KEDNj-së, për shkak se është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi është ngarkuar me një barrë prove të paarsyeshme dhe është shkarkuar nga detyra për një shtëpi të ndërtuar nga babai i tij në vitin 1990, në kohën që subjekti ka qenë nxënës në gjimnaz. Një periudhë e pakufizuar për çështjet disiplinore, që përfshijnë gjyqësorin, paraqet një kërcënim serioz për parimin e sigurisë juridike.

Trupi gjykues i Kolegjit, për këtë shkak ankimor, në përgjigje të pretendimit mbi cenimin e sigurisë juridike dhe objektivitetin e kalimit të barrës së provës, çmon nevojën për kualifikimin e duhur ligjor të situatës faktike, veçanërisht në funksion të të provuarit të shkaqeve të përdorura për shkarkimin e subjekteve, në lidhje me cilësimin e personit/personave të tretë, si person/persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit apo të marrëdhënies konkrete të subjekteve të rivlerësimit me pasuritë e caktuara, rrethana të cilat do vlerësohen nëpërmjet arsytimit të këtij vendimi, në përgjigje të shkaqeve materiale të ankimit të subjektit të rivlerësimit, për këtë pasuri.

14.3 Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni në vendim ka përdorur koncepte të paqarta, si: pasaktësi në deklarin e burimeve financiare, deklarim i pamjaftueshëm i të ardhurave dhe deklarim i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, të cilat nuk janë të sqaruara nga ligji nr. 84/2016. Shkarkimi i subjektit bazuar në termat e mësipërm, sjell për pasojë interpretimin e ligjit në mënyrë arbitrare dhe, në më shumë se një rast, në kundërshtim flagrant me legjislacionin e zbatueshëm në çështjen ndaj subjektit të rivlerësimit.

14.4 Trupi gjykues çmon se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, se konceptet, si: pasaktësi në deklarin e burimeve financiare, deklarim i pamjaftueshëm i të ardhurave dhe deklarim i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, janë të paqarta dhe të pasqaruara nga ligji nr. 84/2016, nuk mund të shqyrtohen të shkëputura nga shkaqet konkrete të ankimit lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar tashmë dhe në qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e Kolegjit⁹, i cili në vendimin nr. 8/2022, ka arsyetuar se: *Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për cenim të parimit të sigurisë juridike nëpërmjet përdorimit në vendimin e Komisionit të koncepteve të paqarta, si “pasaktësi në deklarin e burimeve financiare”, “deklarim të pamjaftueshëm të të ardhurave” dhe “deklarim të*

⁸ Referohuni minutës [01:53 - 02:2] të regjistrimit audio të seancës gjyqësore (pyetje-përgjigje), të subjektit të rivlerësimit Arben Sharra, si dhe procesverbalit të zbardhur në dosje të Komisionit.

⁹ Referohuni vendimit nr. 45/2022 (JR) dhe vendimit nr. 33/2024 (JR).

pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë”, trupi gjykues çmon se, referuar edhe qëndrimit të mbajtur nga Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj nr. 2, datë 18.01.2017, lidhur me terminologjinë e paqartë të përdorur në ligjin nr. 84/2016, ku citohet: [...] është detyrë e gjykatave ose e organeve të tjera shtetërore e shoqërore, të ngarkuara me ligj, që mangësi të caktuara të një ligji t’i plotësojnë natyrshëm përmes interpretimit dhe zbatimit të tij në praktikë [...], përdorimi nga Komisioni i koncepteve të sipërcituara dhe kuptimi i dhënë atyre në vendim janë objekt vlerësimi dhe kontrolli nga ana e Kolegjit, sipas shkaqeve konkrete të ankimit lidhur me kriterin e rivlerësimit të cilit i përket. Për rrjedhojë, vetëm fakti i përdorimit të këtyre togfjalëshave në vendimin e Komisionit, pa vlerësuar kontekstin në të cilin kanë gjetur përdorim, si dhe kuptimin që i ka dhënë Komisioni nëpërmjet arsytimit të tij, nuk vlerësohet i mjaftueshëm për t’u ngritur në nivelin e një shkakut ligjor që mund të cenojë vlefshmërinë e vendimit të Komisionit.

14.5 *Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka shkelur parimin e barazisë para ligjit, të mosdiskriminimit dhe, për rrjedhojë, edhe të sigurisë juridike, pasi e ka trajtuar subjektin e rivlerësimit në mënyrë të diferencuar nga subjektet e tjerë rivlerësues, në rastin e tyre ka vendosur konfirmimin në detyrë, ndërsa në rastin e subjektit ka vendosur shkarkimin nga detyra. Subjekti i rivlerësimit u është referuar disa vendimeve të Komisionit¹⁰ dhe të Kolegjit në drejtim të qëndrimit të mbajtur për sa i përket konsiderimit të të ardhurave nga produktet bujqësore.*

14.6 *Trupi gjykues vlerëson se një pretendim i tillë, nuk mund të përbëjë a priori shkak për ta konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe zbatimit të duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjerë të rivlerësimit nga Komisioni. Vendimmarrja e Komisionit i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, çfarë adreson rëndësinë e nënvizuar nga GjEDNJ-ja për krijimin e mekanizmave që mund të sigurojnë koherencën e praktikës dhe njësimin e jurisprudencës¹¹. Përpos këtij arsytimi, trupi gjykues sjell në vëmendje përgjegjësinë e tij si i vetmi organ gjyqësor i procesit të rivlerësimit, i cili garanton ruajtjen e trajtimit të barabartë të subjekteve, qoftë për shkak të ushtrimit të funksioneve gjyqësore, por edhe për shkak të kompozimit të tij. Sa më sipër, nga ana e Kolegjit vendosen standardet në bazë të parimeve kushtetuese, kur çështja gjykohej prej tij.*

14.7 *Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka kryer fshehje të pasurisë, deklaram të rremë dhe deklarimet e tij janë në përputhje me ligjin. Duke interpretuar në mënyrë sistematike, së bashku nenet 59 dhe 61 të ligjit nr. 84/2016, i vetmi shkak për të cilin mund të merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, është ai i parashikuar nga pika 1 e nenit 61 të këtij ligji, deklarimi i më shumë se dyfishit të pasurisë së ligjshme, në situatat kur Komisioni nuk gjen dëshmi pozitive ose fshehje të pasurisë.*

14.8 *Trupi gjykues sjell në vëmendje që ky argument, i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, ka gjetur trajtim gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit.¹² Në analizë të argumenteve të ngritura nga subjekte të tjerë rivlerësimi, Kolegji ka theksuar se pika 1 e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, përcakton rrethana*

¹⁰ *Vendimit nr.191, datë 26.07.2020; nr. 229, datë 28.01.2020; nr. 372, datë 22.04.2021, të Komisionit, si dhe vendimet e Kolegjit nr. 18 (JR), datë 12.07.2021 dhe nr. 10/2020 (JR).*

¹¹ *Shih Beian v. Romania (no. 1), §§ 37 dhe 39; Lupeni Greek Catholic Parish and Others v. Romania [GC], §§ 116-35.*

¹² *Shih vendimet e Kolegjit: nr. 1/2021 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit A. S., nr. 26/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Ç. Sh., nr. 23/2022 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit A. Sh. dhe nr. 38/2023 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit S. S.*

faktike dhe ligjore – kur subjekti i rivlerësimit ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, përfshirë edhe personat e lidhur me të – rrethana këto autonome nga të tjerat që normohen nga ky nen, në të cilat organet e rivlerësimit, pa ushtruar diskrecion, zbatojnë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra. Trupi gjykues sjell në vëmendje se rastet për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, nuk janë kumulative, që do të thotë se, ndonëse nuk gjenden rrethana që mund të kualifikohen sipas pikës 1 të kësaj dispozite, mund të gjenden dhe janë gjetur rrethana që kualifikohen sipas pikave të tjera të këtij neni, të cilat urdhërojnë njësoj vendosjen e masës disiplinore.

15. Në parashtrimet e datës 05.03.2025, të depozituara në Kolegj përpara zhvillimit të seancës gjyqësore, në dhomë këshillimi, subjekti i rivlerësimit paraqiti pretendime të reja, konkretisht se, pasi është njohur me dosjen e vënë në dispozicion nga Kolegji, ka konstatuar që Komisioni, për vendimet e ndërmjetme, nuk ka mbajtur procesverbale, por ka konsideruar si të tilla *email*-et e dërguara në datat përkatëse. Për subjektin, ky fakt përbën shkelje të rëndë procedurale dhe është Kolegji, i cili, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, mund të rregullojë çdo gabim procedural të Komisionit. Po ashtu, procesverbali i datës 27.06.2022 dhe ai i datës 30.06.2022, nuk janë nënshkruar nga kryesuesi i seancës gjyqësore, në përputhje me nenin 118, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile. Bashkëlidhur parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit paraqiti dokumente, për të cilat kërkoi që të administrohen prej Kolegjit si prova të reja.¹³

15.1. Nga shqyrtimi i akteve në fashikull, trupi gjykues vërën se Komisioni i ka njoftuar subjektin të rivlerësimit vendimet e ndërmjetme, në përputhje me nenin 46 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: “[...] 1. Njoftimi dhe çdo komunikim gjatë procesit të rivlerësimit bëhet në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit që është dhënë në deklaratën e pasurisë, të parashikuar në nenin 31, pika 1, të këtij ligji. [...] 3. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë dhe është i detyruar të aksesojë e të përdorë adresën elektronike zyrtare gjatë procesit të rivlerësimit. [...] 4. Në rast se njoftimi nuk realizohet sipas

¹³ (i) Plotësim “Raport Vlerësimi” për llogaritjen e të ardhurave nga prodhimi i pemëve të mbjella nga familja Sh., në tokën e përfutur me ligjin nr. 7501/1991, të ndodhur në fshatin Shëngjin, Njësia Administrative Shëngjergj, Tiranë, përgatitur nga eksperte L. B., më datë 07.10.2024; (ii) Plotësim “Raport Vlerësimi” për llogaritjen e të ardhurave nga prodhimi në parcelën me nr. {***}, e ndodhur në z. k. {***}, {***}, {***}, në fshatin Shëngjin, Njësia Administrative Shëngjergj, Tiranë, përgatitur nga eksperte L. B., datë 07.10.2024; (iii) Vendim nr. {***}, datë 29.12.2023, për legalizimin e ndërtimit pa leje, Drejtoria Vendore Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim “AShK”) Tirana - Gentplan, Drejtoria Vendore ASHK Tirana Veri, I. T. L. - Certifikatë regjistrimi pronësie, kartelë e pasurisë së paluajtshme, fragment i hartës kadastrale, I. T. L., nr. pasurie {***}, z. k. {***}, datë 29.12.2023; (iv) Deklaratë noteriale nr. {***} rep./kol., datë 25.01.2023 - Mandatpagesë, datë 01.02.2023, Raiffeisen Bank ShA - Deklaratë noteriale nr. {***} rep./kol., datë 25.01.2023; (v) Urdhër për heqjen e sekuestros konservative nr. {***} prot., datë 22.12.2022; (vi) Nxjerrje llogarie, datë 28.02.2025, Credins Bank ShA, për periudhën 01.02.2023 – 20.02.2023; (vii) Deklaratë noteriale nr. {***} rep./kol., datë 09.07.2021; (viii) Kontratë investimi nr. {***} rep./kol., datë 09.10.2006, vërtetuar me njësinë origjinale me nr. {***} rep., datë 03.03.2025; (ix) Vendim nr. {***}, datë 09.05.2023, për miratimin e kërkesës për kalimin në pronësi të objektit pa titull pronësie me truallin funksional, Drejtoria Vendore ASHK Tirana Rurale 1; (x) Certifikatë regjistrimi pronësie, kartelë e pasurisë së paluajtshme, fragment i hartës kadastrale, H. B. Sh., nr. pasurie {***}, z. k. {***}; (xi) Deklaratë noteriale nr. {***} rep./kol., datë 19.07.2022; (xii) Vërtetim nr. {***} prot., datë 13.03.2023 dhe vërtetim nr. {***} prot., datë 24.03.2023, lëshuar nga Njësia Administrative Shëngjergj, Bashkia Tiranë, lidhur me pronësinë e pasurive nr. {***}, z. k. {***}; (xiii) Deklaratë noteriale nr. {***} rep./kol., datë 21.03.2023; (xiv) Deklaratë noteriale nr. {***} rep./kol., datë 25.03.2023; (xv) Kërkesë nr. {***}, datë 21.07.2022, e bërë nga Arben Sharra në e-Albania, për Drejtorinë Vendore ASHK Tirana Veri; (xvi) Certifikatë regjistrimi pronësie, kartelë e pasurisë së paluajtshme, fragment i hartës kadastrale, nr. pasurie {***}, z. k. {***}; (xvii) 9 (nëntë) Certifikata regjistrimi pronësie, kartelë e pasurisë së paluajtshme, fragment i hartës kadastrale, Arben S. Sharra, nr. pasurie {***}-{***}-{***}-{***}-{***}-{***}-{***}-{***}, z. k. {***}.

parashikimeve të mësipërme, mund të përdoren forma të tjera të komunikimit, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative [...]”. Nga aktet rezulton se subjekti ka komunikuar dhe ka marrë rregullisht njoftime gjatë procesit të rivlerësimit në adresën e tij elektronike, dhe nuk ka ngritur pretendime lidhur me to. Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

Po ashtu, trupi gjykues konstaton se seancat dëgjimore të datës 27.06.2022 dhe 30.06.2022 janë mbajtur në prani të subjektit të rivlerësimit, janë regjistruar në audio, janë transkriptuar të plota dhe jo në formë të përmbledhur,¹⁴ si dhe janë firmosur nga sekretari gjyqësor, konform parashikimeve të neneve 118 dhe 118/1 të Kodit të Procedurës Civile¹⁵. Për më tepër, edhe në analizë të detyrimeve për transparencë dhe garanci të procesit, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka qenë vetë i pranishëm në këto seanca dhe nuk shpreh pretendime mbi përmbajtjen e tyre – ky aspekt procedural konsiderohet i shteruar dhe në vlerësim të trupit gjykues, nuk cenon procedurën e ndjekur apo të drejtat procedurale të subjektit.

Sa i përket akteve të paraqitura nga subjekti me parashtrimet, trupi gjykues referon se, në kuptim të neneve 47 dhe 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012¹⁶, i ndryshuar, deri pesë ditë përpara seancës së shqyrtimit të çështjes, palët kanë të drejtë të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, por jo prova të reja. Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar apo argumentuar pamundësinë e paraqitjes së këtyre akteve që në fazën e hetimit administrativ në Komision, që do të lejonte kalimin e testit të vendosur nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012¹⁷, sa i përket mundësisë së subjektit për të paraqitur prova të reja me ankimin. Edhe në një analizë alternative, në një vështrim *prima facie* të përmbajtjes së këtyre akteve, trupi gjykues konstaton se plotësimi i raportit të vlerësimit për llogaritjen e të ardhurave nga prodhimi i pemëve të mbjella nga familja *Sh.*, në tokën e marrë me ligjin nr. 7501/1991, të datës 07.10.2024, rregullimi i situatave juridike në AShK sa i përket gjetjeve të Komisionit lidhur me mosdeklarimin dhe posedimin e tokës bujqësore, banesën e pretenduar të ndërtuar nga z. I. L., deklaratat noteriale të paharmonizuara me dokumentacion tjetër ligjor, vlerësohen të panevojshme dhe pa ndikim në vendimmarrjen e Kolegjit, në kuptim të nenit 49, pika 6¹⁸ e ligjit nr. 84/2016.

16. Në përmbyllje të sa më sipër, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit të paraqitura në shkaqet procedurale të ankimit, trupi gjykues e gjeti të pambështetur në fakte dhe në parashikimet e nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, kërkesën për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe për marrjen e provave të reja. Trupi gjykues, në konkluzion të arsyetimit të mësipërm, vendosi të shqyrtojë çështjen në dhomë këshillimi mbi bazë aktesh, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

¹⁴ Neni 118 i Kodit të procedurës Civile parashikon se: “[...] Nëse procesverbali mbahet në formë të përmbledhur me shtypshkrim apo dorëshkrim, ai nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga sekretari dhe në fund të dokumentit nga kryetari i seancës, menjëherë pas seancës, dhe përfshihet në dosjen gjyqësore. [...]”.

¹⁵ Neni 118/1 i Kodit të Procedurës Civile, “Transkriptimi i procesverbaleve të mbajtura me mjete të regjistrimit audio ose audiovizive”.

¹⁶ Ligji nr. 49/2012, në nenin 49, pika 2, parashikon: “[...] Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim”.

¹⁷ Kjo dispozitë parashikon: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

¹⁸ Neni 49, pika 6, ndër të tjera, përcakton: “[6]. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; [...] d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili, edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit [...]”.

B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me kriterin e pasurisë dhe shkaqet e ankimit mbi këtë kriter

Për pasurinë “Shtëpi banimi, me sipërfaqe 134.5 m²”, në Kodër - Kamëz, Tiranë

17. Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e kësaj pasurie në shumën 4.273.611,69 lekë. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.
18. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit lidhur me: (i) konstatimin e pasaktësisë në deklaramin e kësaj pasurie; (ii) përcaktimin e vitit të ndërtimit, mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së ndërtimit, si dhe (iii) konstatimin e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e saj.
19. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve në fashikullin gjyqësor të Komisionit dhe pretendimeve të subjektit në ankim e parashtime, konstaton dhe vlerëson si vijon.

(i) Lidhur me deklaramin e pasurisë

20. Në deklaramin e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Shtëpi banimi, kati i parë me sipërfaqe 134.5 m², dhuruar nga babai me kontratën nr. {***}, datë 08.01.1997, në Kodër - Kamëz Tiranë. Kati i dytë + papafingo është pronë e babait, për të cilën kam bërë deklaramin noteriale nr. {***} rep./kol., datë 03.12.2009, dorëzuar te Drejtoria e ALUIZNI-t me nr. {***} prot., datë 10.12.2009. Bërë marrëveshje verbale për shitjen e shtëpisë me shtetasin I. L. në vitin 2014. Pjesa takuese 100%”.

20.1 Së bashku me deklaramin e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin provues lidhur me përfitimin e kësaj pasurie: (i) Kontratë dhurimi nr. {***} rep./kol., datë 08.01.1997, me të cilën babai i dhuron subjektit të rivlerësimit, shtëpinë njëkatëshe të ndodhur në Kodër - Kamëz, Tiranë, e përbërë nga katër dhoma, e njohur me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. {***}, datë 21.06.1996; (ii) Deklaramin noteriale nr. {***}/{***} rep./kol., datë 03.12.2009, e subjektit të rivlerësimit, për efekt të procedurave të legalizimit të pasurisë së dhuruar, mbi legalizimin e katit të parë të godinës në emrin e tij, ndërsa pjesa tjetër, kati i dytë + papafingo të bëhej në emër të babait, S. Sh.; (iii) Certifikatë për vërtetim pronësie në emër të subjektit të rivlerësimit, në të cilën shënohet: *me leje legalizimi nr. {***}, datë 03.07.2015*, godinë banimi 3 (tre) kate, kati përdhe 107.6 m², verandë 26.9 m², sipërfaqe totale 364 m², 500 m² truall, regjistruar më datë 28.07.2015.

20.2 Në deklaramin e personit që mbart detyrimin për deklaram pasurie 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Shtëpi private, ndodhur në lagjen nr. {***}, Kodër - Kamëz. Sipërfaqja 90 m²”. Pjesa që zotëron 17%. Burimi i krijimit: “dhuruar nga babai”. Në deklaramin e interesave privatë periodikë vjetorë 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) Shtëpi banimi në K. Kamëz, “dhuruar nga babai me kontratë dhurimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.01.1997, regjistruar në ZVRPP në vitin 2017”, pjesa takuese: kati I (i parë), me certifikatë pronësie e ZRPP nr. {***}, datë 28.07.2015; (ii) Pagesë për legalizimin e banesës në K. Kamëz, në vlerën 361.000 lekë dhe 500.000 lekë bono privatizimi, shumë me paguar në Credins Bank ShA, ku ½ e kësaj shume i përket babait.

20.3 Nga dokumentacioni i përcjellë nga ASHK Tiranë¹⁹ rezulton se: (i) subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin “Vetëdeklarim për legalizim”, më datë 23.03.2005, protokolluar me nr. {***}, për legalizimin e ndërtimit të një objekti informal, me sipërfaqe ndërtimi 130 m², i përbërë nga 3 (tre) kate mbi tokë, i ndërtuar më datë 25.10.1990. (ii) Në emër të subjektit të rivlerësimit është lëshuar leja e legalizimit nr. {***}, datë 03.07.2015, si pronar i vetëm i pasurisë nr. {***}, z. k. {***}, i trullit me sipërfaqe 500 m², dhe godinë banimi 3 (tre) kate, me sipërfaqe totale ndërtimi 364 m². (iii) Në emër të subjektit të rivlerësimit ka kaluar pronësia e parcelës ndërtimore me sipërfaqe 500 m², me vendimin nr. {***}, datë 14.10.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e pronësisë së parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale”, si dhe (iv) nga subjekti është nënshkruar kontrata me ALUIZNI-n²⁰, “Kalim i pronësisë së parcelës ndërtimore”, nr. {***}/{***} rep./kol., datë 01.07.2015, si dhe janë kryer pagesat nëpërmjet sistemit bankar për blerjen e parcelës ndërtimore prej 500 m².

20.4 Gjatë hetimit administrativ në Komision, i pyetur nëpërmjet pyetësorit nr.1, të datës 07.10.2021, pikërisht mbi arsyet se përse aplikimi për legalizimin, regjistrimi i pasurisë dhe nënshkrimi i kontratës për blerjen e parcelës ndërtimore janë bërë prej tij, ndërkohë që pasuria e dhuruar nga babai përfshin vetëm katin e parë të godinës, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, në përgjigjen e dhënë, ka sqaruar se me ndryshimet e bëra në Kodin Civil, neni 193, si dhe bazuar në nenin 46, pika 2 e ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”, vendimi gjyqësor që vërteton faktin juridik të pronësisë, i miratuar pas datës 01.11.1994, nuk mund të regjistrohej dhe ndaj i është nënshtruar procedurave të legalizimit. Në vijim, subjekti i rivlerësimit sqaron se regjistrimi i banesës është bërë në emër të tij, pasi Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tiranë, nuk kishte marrë parasysh deklaratën noteriale dhe kërkesën e depozituar nga ai pranë kësaj drejtorie, për saktësimin e pjesëve takuese të kësaj godine. Ndërsa, sa i përket blerjes së parcelës ndërtimore, subjekti ka deklaruar se fillimisht ajo duhej blerë, që më pas të bëhej i mundur legalizimi i banesës.

20.5 Me rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës, për të provuar të kundërtën e konstatimeve se: (1) *Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting se është pronar i vetëm i kësaj pasurie*; (2) *subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting pronësinë mbi parcelën ndërtimore me sipërfaqe 500 m², mbi të cilën është ndërtuar ndërtesa e legalizuar, por vetëm katin e parë të kësaj banese*; (3) *subjekti nuk ka deklaruar në të gjitha deklaratat periodike faktin se ka aplikuar për legalizimin e një banesë 2 kate + papafingo, si dhe nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2015, pronësinë e tij mbi këtë banesë e të trullit me sipërfaqe 500 m².*

20.6 Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit sqaron se, së bashku me deklaratën e pasurisë *vetting*, ka paraqitur edhe kontratën e dhurimit, certifikatën e vërtetimit të pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe akte të cilat pasqyrojnë të gjitha të dhënat e pronës, sipërfaqen e trullit dhe ndërtesës, numrin e kateve, pronarin e pasurisë, mënyrën e përfitimit të saj, si dhe deklaratat noteriale të paraqitura pranë ALUIZNI-t, nëpërmjet të cilave kërkohej nga ky institucion vetëm legalizimi i katit të parë të banesës në emrin e tij. Subjekti i rivlerësimit pretendon se këtë pasuri dhe legalizimin e saj e ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2015, si dhe ka paraqitur shkresën “Kthim përgjigje”, nr. {***} prot., datë 30.05.2022, të ASHK-së, Drejtoria Rajonale Tirana Veri, në të cilën citohet se: “Pas verifikimeve të bëra nga sektori i arkiv/protokollit, rezulton se

¹⁹ Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri, shkresa nr. {***} prot., datë 17.11.2021.

²⁰ Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale.

subjekti ka depozituar deklaratën noteriale, protokolluar me nr. {***}, datë 10.12.2009”. Referuar kësaj deklarate, subjekti ka kërkuar që legalizimi i katit të parë të godinës të bëhet në emrin e tij, ndërsa pjesa tjetër, në emër të babait, S. Sh.

20.7 Në ankimin e paraqitur, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni nuk ka asnjë arsye të dyshojë në lidhje me deklarin e bërë prej tij. Banesa është ndërtuar tërësisht nga babai i subjektit të rivlerësimit. Ai ka fituar me dhurim katin e parë (pavarësisht se kontrata e dhurimit, për shkak të ndërtimit informal dhe mosregjistrimit të pasurisë, nuk mund të regjistrohej në ZVRPP). Të gjitha të dhënat dhe dokumentet e pasurisë, si në vitin 2015, kur është legalizuar banesa, ashtu edhe në deklaratën *vetting*, i ka paraqitur pranë autoriteteve verifikuese dhe regjistrimi vetëm në emër të tij, ka ardhur si pasojë e veprimeve të punonjësve të ALUIZNI-t.

20.8 Trupi gjykues, sa i përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit mbi saktësinë e deklaramit të kësaj pasurie, konstaton se, në datën e plotësimit të deklaratës *vetting*, më 26.01.2017, subjekti i rivlerësimit rezulton pronar i vetëm i banesës 2 (dy) kate + papafingo, me sipërfaqe totale 364 m², pasuri të cilën e ka fituar në pronësi ligjore, nëpërmjet lejes së legalizimit, nr. {***}, më datë 03.07.2015. Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton ta ketë deklaruar saktësisht, plotësisht dhe në mënyrë të detajuar këtë pasuri, sipas detyrimit ligjor të përcaktuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës, pasi ka deklaruar vetëm pronësinë mbi katin e parë të kësaj banese, por jo pronësinë mbi katin e dytë dhe papafingon, si dhe pronësinë mbi parcelën ndërtimore me sipërfaqe 500 m². Detyrimi i subjekteve të rivlerësimit, për të qenë të saktë dhe të vërtetë në deklaramet që ata bëjnë në deklaratën e pasurisë *vetting*, nuk është vetëm një kërkesë formale ligjore, por edhe tregues përgjegjësie në drejtim të detyrimeve që mbartin subjektet e rivlerësimit në këtë proces.

20.9 Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë deklaruar në deklaramet periodike vjetore, posedimin e ndërtesës 2 (dy) kate + papafingo, aplikimin për legalizimin e banesës në emër të tij, si dhe të drejtat reale mbi parcelën ndërtimore me sipërfaqe 500 m², detyrim ky i përcaktuar në nenin 4, shkronja “a” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar. Për sa kohë rezultoi e provuar nga hetimi administrativ në Komision, që për këtë ndërtesë 2 (dy) kate + papafingo, subjekti i rivlerësimit kishte bërë vetëdeklarim për legalizim, më datë 23.03.2005, e kishte regjistruar në favor të tij në ZVRPP dhe kishte nënshkruar kontratën për kalimin e pronësisë mbi truallin me sipërfaqe 500 m², në vitin 2015, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ligjor të deklaronte të gjitha të drejtat reale mbi pasuritë e sipërcituara, sipas përcaktimeve që u jep këtyre të drejtave Kodi Civil. Referuar VKM-së nr. 1038, datë 14.10.2009, “Për kalimin e pronësisë së parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale”, emri i subjektit të rivlerësimit figuron në listën e poseduesve të objekteve informale, me numër rendor {***}, si posedues i ndërtesës informale 2 (dy) kate + papafingo, me numër protokollit të vetëdeklaramit për legalizim, {***}.

20.10 Sa i përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, *se regjistrimi i pronës në emër të tij ka ardhur si rezultat i shkeljeve në kryerjen e detyrës nga ana e punonjësve të ALUIZNI-t Tiranë*, trupi gjykues, bazuar në qëndrimin e Kolegjit në jurisprudencën e tij²¹, e gjen të pabazuar këtë pretendim, pasi edhe në rrethana në të cilat subjekti do të arrinte të justifikonte në kuptimin formal se ka paraqitur në kohë kërkesat pranë Drejtorisë së ALUIZNI-t, për saktësimin e pjesëve takuese të pronësisë mbi ndërtesën objekt legalizimi, dhe se pronësia *de jure* ka kaluar në emër të subjektit për shkak të

²¹ Referohuni vendimit nr. 15/2019 (JR) të Kolegjit, paragrafi 29, për subjektin e rivlerësimit D. Rr.

pavarura prej tij, kërkesat e paraqitura pranë ALUIZNI-t janë kryer në funksion të një procesi tjetër, jo relevant për procesin e rivlerësimit, në funksion të të cilit subjekti i rivlerësimit ka detyrimin për të qenë i saktë dhe i vërtetë në deklaratimet e tij.

20.11 Pas verifikimit të akteve në dosjen gjyqësore të Komisionit, ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit se vendimi gjyqësor, që vërteton faktin juridik të pronësisë, sipas ligjit të kohës nuk regjistrohët, trupi gjykues konstaton se në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja, më datë 25.01.2016,²² subjekti ka deklaruar që, mbi bazën e kontratës së dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.01.1997, dhe vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë, nr. {***}, datë 21.06.1996, kjo pronë është e regjistruar në Regjistrin hipotekor me nr. {***}, si dhe ka depozituar aktin “Vërtetim pronësie”, të datës 22.04.1998, në të cilin shkruhet shprehimisht: [...]. Në regjistrin hipotekor nr. {***}, datë 08.01.1997, në pronësi të shtetasit Arben Sharra, i biri i S., figuron e regjistruar një shtëpi banimi, e ndodhur në Kodër - Kamëz, e përbërë nga katër dhoma [...]. Regjistrimi hipotekor është bërë në bazë të kontratës së dhurimit [...] nga vendimi i Gjykatës Tiranë nr. {***}, datë 21.06.1996. [...].

20.12 Sa më sipër analizuar, trupi gjykues vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit në vendim se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin lidhur me këtë pasuri, në kundërshtim me kërkesat e nenit 33, pika 5, shkronja “a” të ligjit nr. 84/2016.

(ii) Lidhur me kohën e ndërtimit të banesës objekt shqyrtimi

- 21.** Nga vendimi nr. {***}, datë 21.06.1996, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt vërtetimin e faktit juridik të ndërtimit të një shtëpie në Kodër - Kamëz, rezulton se: *Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës së shtetasit S. Sh. dhe faktin që ky shtetas, në vitin 1990, ka ndërtuar një shtëpi në vendin e quajtur Kodër - Kamëz, Tiranë, me shpenzimet e tij financiare. Kjo shtëpi është njëkatëshe dhe përbëhet nga katër dhoma. Kjo pasuri, më pas, i është dhuruar nga babai subjektit të rivlerësimit, me kontratë dhurimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.01.1997, pa asnjë kusht. Në aktin vetëdeklarim për legalizim, datë 23.03.2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si kohë ndërtimi të objektit informal, me sipërfaqe ndërtimi 130 m², të përbërë nga 3 (tre) kate mbi tokë, datën 25.10.1990.*

21.1 Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, të datës 07.10.2021, lidhur me kohën dhe vendin e ndërtimit, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: [...]. *Banesa është ndërtuar në periudha të ndryshme, duke filluar nga viti 1990 e në vazhdim. Dokument provues nuk disponoj për shkak se unë në atë kohë kam qenë nxënës në shkollë të mesme dhe nuk jam marrë me ndërtimin e saj. Gjithashtu, për shkak të viteve të tranzicionit dhe informalitetit të kohës, as babai im i ndjerë nuk di të ketë ruajtur ndonjë dokument provues. Kjo banesë është ndërtuar mbi të njëjtën banesë që më është dhuruar mua nga babai [...].* Bashkëlidhur, subjekti ka paraqitur deklaratë noteriale nr. {***}/{***} rep./kol., datë 07.03.2020, të znj. H. Sh., nënës së subjektit, në të cilën deklaron se nga të ardhurat e kursyera gjatë jetës nga puna, aktiviteti në bujqësi e blegtori dhe disa të ardhura të trashëguara nga prindërit e bashkëshortit, ndërtuan në periudha të ndryshme ndër vite, një shtëpi në Kodër - Kamëz.

21.2 Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi *nuk ka shpjeguar gjatë hetimit administrativ kohën e ndërtimit të kësaj banese.*

²² Kthim përgjigje e ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 28.06.2021.

21.3 Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti ka theksuar se kati i parë i kësaj ndërtese është ndërtuar në vitin 1990, kohë kur ai ka qenë në moshën 17-vjeçare (1973 – 1990). Ky fakt vërtetohet plotësisht me kërkesën që babai i tij ka paraqitur në datën 12.06.1996, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “*Vërtetim fakti të pronësisë së banesës së ndërtuar prej tij që para 6 viteve*”, e cila, me vendim gjyqësor të formës së prerë, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë sipas objektit më lart. Ndërsa, kati i dytë është ndërtuar gjatë viteve 1997 – 1998.

21.4 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e vëna në dispozicion prej tij, vlerësoi se ato nuk janë bindëse, për sa i përket kohës së ndërtimit të banesës. Për nevoja të llogaritjes së vlerës së investimit të kësaj banese, për sa kohë nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është depozituar dokumentacion provues, por dhe nuk është saktësuar periudha kohore e ndërtimit të saj, Komisioni i është referuar ortofotove digjitale, përcjellë nga ASIG-u, me shkresën nr. {***} prot., datë 23.02.2022, duke arsyetuar se, në vitin 1994, kati i parë i shtëpisë nuk ka qenë ende i ndërtuar dhe si vit i përfundimit të ndërtimit për këtë kat, do të merret viti 1996, kohë kur është paraqitur kërkesa në gjykatë nga babai i subjektit, për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë të banesës²³, ndërkohë, bazuar në ortofotot, ka vlerësuar vitin 1999, si vit i përfundimit të ndërtimit të dy kateve të tjera.

21.5 Në shkaqet e ankimit, subjekti ngre pretendimet se: (i) Kati i parë i godinës është ndërtuar në vitin 1990, dhe ky fakt, në kushtet kur ka një vendim gjyqësor të formës së prerë, që vërteton kohën e ndërtimit të banesës, nuk lë vend për diskutime të mëtejshme. (ii) Konkluzioni i Komisionit, bazuar në interpretimin e të dhënave të përfituara nga ortofotot e vitit 1994, të administruara nga ASIG-u me shkresën nr. {***} prot., datë 23.02.2022, është i gabuar; (iii) Komisioni, edhe pse nuk ka njohuri teknike, analizon ortofoton e ASIG-ut dhe nuk jep asnjë arsye përse ka hedhur poshtë mendimin e specializuar të ekspertit gjeodet, por edhe të ekspertëve të ndërtimit. Kati i dytë është ndërtuar në vitet 1997 – 1998. Ortofotot sipas subjektit nuk mbulojnë të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk japin një pamje të plotë dhe të qartë të ndërtimeve në të.²⁴ (iv) Raportin e Vlerësimit Tekniko - Ekonomik të Ing. I. S. dhe Ark. I. S., qershor 2022, të paraqitur gjatë hetimit administrativ prej tij, Komisioni e ka hedhur poshtë pa arsye.

21.6 Trupi gjykues, në analizë të akteve në fashikull të Komisionit dhe sa pretenduar nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe në shkaqet e ankimit, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të

²³ Në këtë konstatim, Komisioni ka marrë në konsideratë edhe faktet e mëposhtme: (i) Babai i subjektit ka paguar rregullisht deri në vitin 1995, pranë arkës së Komunës Shëngjergj, detyrimin për energjinë elektrike, provuar me librezën e energjisë elektrike, të depozituar nga subjekti, së bashku me pyetësin e datës 13.01.2022; (ii) Njësia Bashkiake, me shkresë nr. {***} prot., datë 02.03.2022, nr. {***}, ka informuar se, referuar regj. {***}, shtetasi Arben Sharra është vendosur në këtë regjistër nga Zyra e Gjendjes Civile Vërri, Tiranë (e cila mbulonte dhe fshatin Shëngjin), në muajin shkurt të vitit 1995 dhe është larguar nga ky regjistër me transkriptim në Njësinë Bashkiake nr. {***} regj., {***}. nr. {***}, datë 17.05.2004; (iii) Njësia Bashkiake nr. 11 ka informuar se z. S. Sh. është vendosur në këtë Njësi në datën 18.10.1993, nga Zyra e Gjendjes Civile Vërri, Tiranë.

²⁴ Subjekti ka deklaruar se: [...]. Ortofotoja e vitit 1994, sipas faqes zyrtare të ASIG-ut mbulon vetëm një sipërfaqe të vogël të territorit të Republikës së Shqipërisë dhe nuk jep një pamje të plotë dhe të qartë mbi ndërtimet e të gjithë territorit, duke vënë në diskutim, jo vetëm cilësinë e dobët të figurës dhe shikueshmërinë, por edhe vërtetësinë reale faktike mbi ndërtimet e asaj periudhe. Po kështu, edhe ortofotot e viteve 1999 – 2001 nuk janë të plota dhe nuk e mbulojnë tërësisht të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, madje në ortofoton e vitit 2001, zona ku është e ndërtuar banesa në Kodër - Kamëz nuk mbulohet fare nga pamja satelitore dhe, për rrjedhojë, nuk evidentohet asnjë ndërtim në atë zonë. Vetëm në ortofoton e vitit 2007, i gjithë territori i Shqipërisë ka një fotografim të plotë të çdo sipërfaqeje të tij. [...].

provojë me dokumentacion provues, vitin e ndërtimit të banesës, i cili ndërthuret edhe me vlerën e ndërtimit të saj, si dhe rezulton i pasaktë dhe kontradiktor në deklarinimet e tij lidhur me sa pretendon, për arsyet më poshtë.

21.6.1 Subjekti i rivlerësimit ka pranuar se nuk disponon dokument provues lidhur me vitin e ndërtimit të banesës në Kodër - Kamëz, Tiranë. Akti i sjellë me përgjigjet e rezultateve të hetimit, të cilit subjekti i referohet edhe në shkaqet e ankimit, Raporti i Ekspertimit Tekniko-Ekonomik, qershor 2022, referon dy periudha ndërtimi të objektit “Godinë banimi 2 (dy) kate + papafingo”, konkretisht, *një shtëpi në Kodër - Kamëz, e përbërë nga katër dhoma, e ndërtuar në periudhën janar – dhjetor 1990, dhe më pas, katet e të tjera, të ndërtuar mbi katin përdhe, ndërtim i realizuar në periudhën 1997 – 1998*. Trupi gjykues vlerëson se ky akt është hartuar nga ekspertët, në përgjigje të pyetjeve të parashtruara nga vetë subjekti i rivlerësimit, në referim të viteve të ndërtimit të deklaruara nga vetë ai, e për rrjedhojë, merret me rezervë në këtë drejtim. Për më tepër, përcaktimi i viteve të ndërtimit të kateve në Raportin e paraqitur nga subjekti, për efekt të llogaritjes së vlerës së investimit, bie ndesh me aktin “Vetëdeklarim për legalizim”, datë 23.03.2005, në të cilin subjekti ka specifikuar si kohë ndërtimi të objektit informal në analizë, datën 25.10.1990.

21.6.2 Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se Komisioni nuk ka dhënë asnjë arsye përse ka hedhur poshtë mendimin e specializuar të ekspertit, trupi gjykues, në analizë të vendimit të ankimuar, vëren se Komisioni ka arsyetuar: “[...] 53. iii. pretendimet e subjektit për sa i përket kohës së ndërtimit të katit të parë në vitin 1990, vlerëson të mos e marrë në konsideratë, sepse Aktekspertimi i depozituar nga subjekti nuk është bazuar në të dhënat e kohës. Nga ana tjetër, nga ortofotot e vëna në dispozicion nga ASIG-u, del qartë se kati i parë nuk ka qenë i ndërtuar përpara vitit 1994. Referuar ortofotos së vitit 1994, në parcelën në të cilën është ndërtuar banesa e subjektit, nuk ka asnjë ndërtim të përfunduar apo mure rrethuese, ndërkohë, në parcelat përballë parcelës së subjektit, si dhe në të gjithë zonën, ndërtimet dallohen lehtësisht, qoftë edhe ato pa çati apo në themel”. Për sa sipër, trupit gjykues çmon se Komisioni ka arsyetuar qartë qëndrimin e tij, duke e vlerësuar Aktekspertimin të pabazuar në të dhënat e kohës dhe se ortofotot e përcjella nga ASIG-u nuk pasqyrojnë sa pretendon subjekti në deklarinimet e tij mbi vitet e ndërtimit. Në kushtet kur subjekti: (i) pranoi mungesën e dokumentacionit provues, (ii) nuk arriti të provonte periudhën e ndërtimit të objektit informal me dokumentacion tjetër mbështetës, si dhe (iii) dokumentacioni i paraqitur bie ndesh me aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, organet e rivlerësimit, me të drejtë, iu referohen standardeve ligjore të njohura e të zbatuara për të realizuar verifikimin e vërtetësisë së deklarinimeve të subjektit të rivlerësimit, siç janë të dhënat nga aktet zyrtare, ortofotot apo kostoja e unifikuar nga Enti Kombëtar i Banesave.

21.6.3 Në këto rrethana, trupi gjykues, ashtu sikurse edhe Komisioni në vendimin objekt shqyrtimi, vlerëson të konsiderojë me vlerë provuese, për përfundimin e katit të parë, vitin kur është marrë vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vitin 1996, ndërsa për katet e tjera, në mungesë të ndonjë akti që të vërtetojë të kundërtën, është vlerësuar si kohë e përfundimit të ndërtimit, viti 1999, bazuar në ortofotot e administruara nga ASIG-u.

(iii) Lidhur me mungesën e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e objektit

- 22.** Në kushtet kur subjekti, në deklaratën *vetting*, e ka deklaruar këtë pasuri të dhuruar nga babai, Komisioni, në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ka vlerësuar se babai i subjektit të rivlerësimit është person tjetër i lidhur me subjektin dhe, në këto kushte, ka kryer verifikimin e

mundësisë financiare të tij, për të justifikuar ndërtimin e objektit në Kodër - Kamëz, Tiranë.

22.1 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e datës 07.10.2021, të pyetësorit nr. 1, ndër të tjera, deklaroi: [...] *Unë nuk kam dijeni për koston totale të shpenzimeve [...], përveç materialeve ndërtuese, në ndërtimin e saj (si krah pune, punëtorë dhe ustallarë), kemi ndihmuar të gjithë, jo vetëm unë dhe familja jonë, por edhe kushërinjtë tanë, pa pagesë [...]. Burimi i të ardhurave për ndërtimin e kësaj banese nga babai im i ndjerë kanë qenë kursimet gjatë jetës së tij dhe të nënës sime, të ardhurat nga puna, të ardhurat nga toka bujqësore, pemëtaria, blegtoria, bletaria, si dhe një pjesë nga trashëgimia e lënë pas vdekjes nga familja e tij.* Për të provuar sa sipër, subjekti i rivlerësimit ka depozituar bashkëlidhur përgjigjeve të këtij pyetësi aktet: (i) *Deklaratë noteriale nr. {***}/{***} rep./kol., datë 07.03.2020*, në të cilën H. Sh., nëna e subjektit të rivlerësimit, deklaroi ndër të tjera se, përveç punës zyrtare në shtet, ajo dhe bashkëshorti janë marrë me bujqësi dhe blegtori, dhe nga të ardhurat e kursyera gjatë jetës, nga puna në shtet dhe disa të ardhura të trashëguara nga prindërit e bashkëshortit, ndërtuan në vite banesën në Kodër - Kamëz. (ii) *Vërtetim nr. {***} prot., datë 19.10.2021*, me të cilin DRSSH-ja²⁵ Tiranë vërteton se znj. H. Sh. trajtohet me pension pleqërie prej datës 03.07.1994 e në vazhdim. Të ardhurat e përfituara nga pensioni, për periudhën 03.07.1994 – 31.10.2021, janë në vlerën 2.014.575 lekë. Me vërtetim, datë 15.06.1994, Komuna Shëngjergj vërteton se znj. H. Sh., si bujk privat, për periudhën 01.01.1993 – 10.06.1994, ka paguar kontribute të sigurimeve shoqërore. (iii) *Vërtetim nr. {***} prot., datë 19.10.2021*, me të cilin DRSSH-ja Tiranë vërteton se babai i subjektit të rivlerësimit, z. S. Sh., trajtohet me pension pleqërie, duke filluar nga data 07.09.1989 deri më 30.11.2016, dhe të ardhurat e përfituara nga sigurimet shoqërore për këtë periudhë, kanë qenë në vlerën 2.427.296 lekë.

22.2 Rezultatet e analizës financiare të Komisionit, duke përllogaritur vlerën e ndërtimit të kësaj banese, bazuar në kosto mesatare për sipërfaqe ndërtimi, sipas të dhënave të Entit Kombëtar të Banesave (në vijim “EKB”)²⁶, kanë treguar se babai i subjektit të rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën (-) 1.155.496 lekë, për ndërtimin e katit përdhe të godinës trekatëshe, në vitin 1996, si dhe mungesë në vlerën (-) 3.392.373 lekë, për ndërtimin e katit të parë + papafingo, në vitin 1999. Për shkak të pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të konstatuar për ndërtimin e objektit në Kodër - Kamëz, Tiranë, në vlerën totale (-) 4.547.869 lekë, dhe faktit që subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait të tij për ndërtimin e këtij objekti, Komisioni i ka kaluar barrën e provës.

22.3 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka dhënë të njëjtat shpjegime, si edhe gjatë hetimit administrativ, duke shtuar se për ndërtimin e kësaj banese kanë ndihmuar edhe familjarë të babait dhe nënës së tij²⁷. Subjekti ka kërkuar rishikimin e të ardhurave nga pensioni i babait, të

²⁵ Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore.

²⁶ Referuar vendimit nr. 815, datë 09.12.1996, “Për miratimin e vlefave mesatare vjetore të apartamenteve tip në tregun e lirë të banesave dhe të vlefës së koeficientit ‘K’”, të Këshillit të Ministrave, pika 2. Për vitet 1996 – 1997, vlefia e koeficientit “K” për secilin rreth, të llogaritura në bazë të të dhënave të INSTAT-it për vlefat mesatare të apartamenteve tip të tregut të lirë dhe të koston së ndërtimit të Entit Kombëtar të Banesave, të jenë sipas tabelës që i bashkëngjitet këtij vendimi. Në referim të tabelës, “Kosto mesatare e ndërtimit për vitin 1996, për Entin Kombëtar të Banesave”, “Për sipërfaqe ndërtimi lekë/m²”, për qytetin e Tiranës, ka qenë 16.567 lekë/m², ndërsa për vitin 1999, ka qenë 20.033 lekë/m².

²⁷ Në shpjegime për rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka depozituar, në cilësinë e provës, këto akte: -- Deklaratë noteriale nr. {***}/{***} rep./kol., datë 05.06.2022, të shtetasve Xh. dhe A. A., të cilët deklarojnë që, në vitin 1990, daja

ardhurat e realizuara nga motrat, si dhe ka paraqitur raport vlerësimi mbi të ardhurat e përfituara nga toka bujqësore dhe blegtoria. Në lidhje me shpenzimet e jetesës për periudhën 1989 – 2004, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar që ato duhet të përllogariten të paktën në masën 50% të pagave, duke marrë në konsideratë edhe faktin që kishin në shfrytëzim tokën bujqësore.

22.4 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e vëna në dispozicion prej tij, vlerësoi se ato nuk janë bindëse sa i përket burimit të ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e banesës²⁸. Nga analiza financiare e rikryer pas prapësimeve për rezultatet e hetimit, edhe pse konsideroi vlerën 50% të shpenzimeve jetike për periudhën 1992 – 1999 dhe kostot e ndërtimit sipas EKB-së, duke reduktuar më pas 25% të kësaj vlere, në referim të vendimit nr. 15/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, përsëri Komisionit i ka rezultuar se prindërit e subjektit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për ndërtimin e katit përdhe, në shumën (-) 977.222 lekë dhe për ndërtimin e katit të parë + papafingo, në shumën (-) 3.296.390 lekë.

22.5 Në përfundim, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: [...] 56. (ii) *Subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e kësaj pasurie, në shumën 4.273.612 lekë.*

22.5.1 Subjekti i rivlerësimit, në shkaqet e ankimit, ngre këto pretendime: (i) Pavarësisht se kati i dytë i ndërtesës dhe papafingoja janë legalizuar në emrin e tij, vetë subjekti nuk ka kontribut në ndërtimin e kësaj banese, dhe është ngarkuar me një barrë prove që nuk i takon, pasi ajo është ndërtuar nga babai, shumë vite më përpara se ai të emërohej në detyrën e prokurorit. (ii) Subjekti i rivlerësimit nuk është përfutës i të ardhurave të realizuara nga shitja e katit të dytë dhe të papafingos, dhe për rrjedhojë, ligjshmëria e krijimit të tyre, nuk është objekt verifikimi në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. (iii) Komisioni ka analizuar teorikisht në vendim faktin e krijimit të kësaj pasurie përpara fillimit të detyrës. Analiza juridike e kryer nga Komisioni në këtë pikë, nuk është as relevante

*i tyre, S. Sh., ka nisur të ndërtojë një shtëpi dhe ata kanë kontribuar si punëtorë; -- Deklaratë noteriale nr. {***/***/} rep./kol., datë 06.06.2022, të shtetasve M. dhe S. D., të cilët deklarojnë që në vitin 1990, tezja e tyre, H. Sh., bashkë me bashkëshortin, S. Sh., kanë ndërtuar një shtëpi dhe ata kanë kontribuar si ustallarë; -- Shkresë nr. {***/} prot., datë 31.05.2022, e Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor; -- Shkresë kthim përgjigje nr. {***/} prot., datë 30.05.2022, e ISSh-së, për punësimin e motrave të subjektit; -- Vërtetim nr. {***/}, datë 12.05.2022, i Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë; -- Shkresë kthim përgjigje nr. {***/} prot., datë 10.05.2022, e Njësisë Administrative Shëngjergj; -- Shkresë nr. {***/} prot., datë 30.05.2022, e ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Veri; -- Raport vlerësimi për llogaritjen e të ardhurave nga toka bujqësore, datë 10.06.2022; -- Raport i vlerësimit teknik, sipas të cilit kati përdhe i banesës tre kate është ndërtuar në vitin 1990, me vlerë 22.174 lekë, dhe kati i parë plus papafingo, të ndërtuar në vitet 1997 – 1998, me vlerë 2.101.784,31 lekë; -- Raport vlerësimi financiar; -- Dosje e vendimit të Gjykatës për vërtetimin e faktit të banesës, depozituar në seancë gjyqësore; -- Raport vlerësimi për llogaritjen e të ardhurave nga parcela nr. {***/}; -- Deklaratë noteriale nr. {***/}{***/} rep./kol., datë 21.06.2022, e shtetasit N. S.; -- Deklaratë noteriale nr. {***/}{***/} rep./kol., datë 22.06.2022, e shtetasit F. B.; -- Deklaratë noteriale nr. {***/}{***/} rep./kol., datë 24.06.2022, e shtetasit S. Rr.*

²⁸ Komisioni, në përfundim, ka vlerësuar të mos i përfshijë në analizë financiare të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit me burim blegtorinë dhe tokën bujqësore, si dhe të ardhurat nga trashëgimia. Në lidhje me Aktekspertimin mbi të ardhurat e përfituara nga toka bujqësore, vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka vlerësuar se ai është bazuar në dokumentacionin e depozituar prej tij dhe, për këtë arsye, mbetet i karakterit deklarativ. Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat e pretenduara nga motrat e subjektit, pasi ato nuk i përkasin periudhës 1995 e në vijim. Kostot e ndërtimit, Komisioni nuk i ka llogaritur në përputhje me jurisprudencën aktuale të Kolegjit, konkretisht vendimin nr. 7/2022 (JR), në të cilin vlera e reduktuar është 8.83%, por, për të mos rënduar pozitën e subjektit, ka llogaritur vlerën e banesës, sikundër i është dërguar në rezultatet e hetimit. Po ashtu, Komisioni, vlerën e pensioneve të babait e ka përllogaritur bazuar në dokumentacionin justifikues të administruar.

dhe as e drejtë. (iv) Komisioni duhet të kishte përfshirë në analizën financiare si burim të ardhurat e përfituara nga familja e subjektit nga puna e tyre para dhe pas vitit 1990, të ardhurat nga pagat e motrave të subjektit, nga toka bujqësore e përfitur nga babai i subjektit, me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (në vijim “AMTP”) nr. {***}, datë 11.06.1992, si tokë e mbjellë çdo vit me kultura bujqësore, nga të cilat janë siguruar të ardhura që nga viti 1993, rrethana të cilat do të bënin që analiza të dilte me rezultat pozitiv. (v) Sa i përket kostos së ndërtimit të banesës, subjekti ka pretenduar se nuk duhet të përlllogariten referuar çmimit për njësi (m²) të EKB-së të viteve 1996 dhe 1999, për shkak se banesa është ndërtuar në vitin 1990, dhe kostot e materialeve kanë pasur vlerë shumë të ulët. Përveç materialeve ndërtuese, për ndërtimin e saj kanë ndihmuar dhe familjarët. Për ndërtesën e ndërtuar në vitin 1990, edhe pa kryer fare analizë financiare, Komisioni duhej të kishte konkluduar se babai i subjektit të rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme.

22.6 Në analizë të provave shkresore në fashikullin e Komisionit, të administruara për efekt të këtij gjykimi dhe sa pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe në shkaqet e ankimit e parashtrimet në Kolegj, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson se:

22.6.1 Trupi gjykues, paraprakisht çmon të nevojshme kryerjen e një analize juridike lidhur me kufijtë e kontrollit të pasurisë dhe pretendimin e subjektit, se është ngarkuar nga Komisioni me një barrë prove përtej asaj që i takon. Në përgjigje të këtij pretendimi, trupi gjykues konstaton se pasuria objekt vlerësimi, është pasuri e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe, si e tillë, bazuar në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, i nënshtrohet kontrollit, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, ose nuk i ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe ato të personave të lidhur. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratat periodike vjetore, këtë pasuri e ka deklaruar si të dhuruar nga babai i tij.

22.6.2 Në përgjigjet e datës 07.10.2021, subjekti i rivlerësimit deklaroi se si burim për ndërtimin e kësaj banese kanë shërbyer: (i) *kursimet e babait gjatë jetës së tij dhe të nënës nga të ardhurat nga puna*; (ii) *të ardhurat nga toka bujqësore, për të cilat nëna ka paguar dhe kontributet e sigurimeve shoqërore si bujk privat, nga pemëtaria, blegtoria, bletaria, si dhe* (iii) *një pjesë nga trashëgimia e lënë pas vdekjes nga familja e tij*. Sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar që babai i subjektit të rivlerësimit është person tjetër i lidhur, në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke pasqyruar dhe detyrimin për të provuar mundësinë financiare të tij, për të justifikuar ndërtimin e kësaj banese me të ardhura të ligjshme.

22.6.3 Trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për këtë çështje, pasi *së pari*, ky përcaktim merr rëndësi për shkak të statusit ligjor dhe regjimit të të drejtave pasurore që subjekti i rivlerësimit ka fituar me legalizimin e kësaj pasurie. Objekti është përfitur fillimisht nga subjekti i rivlerësimit me kontratë dhurimi të vitit 1997, në vijim është poseduar e është aplikuar për legalizimin e tij në vitin 2005, dhe është regjistruar si pasuri vetëm në emër të subjektit të rivlerësimit në vitin 2015, duke rezultuar në pronësi të tij edhe në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*. *Së dyti*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjatë hetimit në Komision që *e vërteta absolute është se e gjithë shtëpia (pra, jo vetëm kati i parë), është ndërtuar nga babai i tij. Së treti*, ekzistenca e vetëdeklarimit të subjektit pranë ALUIZNI-t tregon në kuptim formal deri në provimin e së kundërtës, se të drejtat mbi këtë pasuri i përkasin pikërisht subjektit të rivlerësimit, prandaj në ekzistencën e rrethanave të ndryshme nga sa rezultuar, sikurse i pretendon, subjekti kishte detyrimin t’i qartësonte ato. Në këtë

kuptim, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit, në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, kishte detyrimin të provonte burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e banesës së dhuruar, poseduar e më pas legalizuar dhe regjistruar vetëm në emër të subjektit të rivlerësimit, detyrim ky që gjen zbatim në legjislacionin e posaçëm të procesit të rivlerësimit.

22.6.4 Në përgjigje të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, *se në kushtet kur nuk është përfitues i të ardhurave të realizuara nga shitja e katit të dytë dhe papafingos, si rrjedhojë, ligjshmëria e tyre nuk është objekt verifikimi*, trupi gjykues analizoi aktet e administruara në fashikullin e Komisionit, nga të cilat rezultoi se subjekti, me kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme nr. {***}/{***} rep./kol., datë 16.06.2017, në cilësinë e shitësit, i shet blerësit I. L., banesën në Kodër - Kamëz, Tiranë, kundrejt çmimit total 150.000 euro, i paguar në këtë mënyrë: (i) 50.000 euro²⁹ janë likuiduar me marrëveshje verbale, në 2 (dy) këste, dhe (ii) diferenca prej 100.000 euro do të likuidohet nëpërmjet rrugëve bankare, 25.000 euro do të kalonin në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe 75.000 euro, në llogari të H. Sh., nënës së subjektit, të përshkruar në këtë kontratë *si person që ka një pjesë të pronës*.

22.6.5 Ndryshe nga sa parashikuar në këtë kontratë, aktet në dosje provojnë se pronar i vetëm i kësaj pasurie, me tagra të plota mbi të, është vetëm subjekti i rivlerësimit. Pavarësisht përshkrimit të dhënë nënës së subjektit në kontratën e shitjes, të hartuar rreth 5 (pesë) muaj pas plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, si dhe përcaktimit për destinimin e shumës 75.000 euro, në llogarinë e saj bankare, mbetet i pacenuar detyrimi kushtetues i subjektit të rivlerësimit, i përcaktuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës, për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të deklaruara, si burim për krijimin e pasurive në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting*. Për sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e mësipërm të subjektit. Parashikimi në kontratën e shitjes të znj. H. Sh., *si person që ka një pjesë të pronës*, mbetet cilësim deklarativ, i pambështetur në dokumentacion provues dhe pa efekt në këtë proces.

22.6.6 Në përgjigje të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, *se Komisioni ka analizuar teorikisht faktin e krijimit të kësaj pasurie para fillimit të detyrës dhe është shkarkuar nga detyra për një shtëpi të ndërtuar nga babai i tij në vitin 1990*, trupi gjykues vlerëson se, në çfarëdo qëndrimi garantist për subjektin e rivlerësimit, edhe në konsideratë të faktit që kati i parë i banesës së dhuruar me 4 (katër) dhoma ka qenë i ndërtuar në vitin 1990 dhe për të, të mos kryhet verifikim i burimit, sërish subjekti i rivlerësimit dështoi të provonte burimin e ligjshëm të zhvillimit më tej të kësaj pasurie, e cila nga banesë njëkatëshe me 4 (katër) dhoma në momentin e vërtetimit të faktit nga vendimi gjyqësor në vitin 1996, rezulton në një pasuri 2 (dy) kate + papafingo, me sipërfaqe totale 364 m², në deklaratën e pasurisë *vetting*. Kjo pasuri ndodhet në pronësi ligjore të subjektit të rivlerësimit deri në datën e plotësimit të kësaj deklarate. Në këto rrethana, pa relevancë gjenden edhe referimet që subjekti ka bërë në jurisprudencën e Kolegjit³⁰, për trajtimin e pasurisë si të krijuar para fillimit të detyrës, për sa kohë detyrimi ligjor i subjektit të rivlerësimit për të justifikuar burimin e pasurisë të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, në pronësi të tij, buron nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 32 i ligjit nr. 84/2016.

²⁹ Nga të cilat 20.000 euro në vitin 2014 dhe 30.000 euro në vitin 2015, deklaruar si të ardhura paradhënie dhe në deklaratat periodike vjetore respektive.

³⁰ Subjekti në ankimin e tij referon vendimin nr. 14/2022 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit A. Z.

22.6.7 Në përgjigje të pretendimit, *se kostoja e banesës nuk duhet të përlogaritet referuar çmimit për njësi m² të EKB-së të viteve 1996*, në vijim të sa arsyetuar më lart në këtë vendim, duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion provues lidhur me vlerën e shpenzuar për ndërtimin e banesës, trupi gjykues gjen të drejtë referimin e Komisionit në të dhënat e vendimeve të Këshillit të Ministrave për kostot e ndërtimit.

22.6.8 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, *se në analizën financiare duhet të përfshihen dhe të ardhurat nga motrat*, trupi gjykues, sikurse Komisioni në vendimin e ankimuar, konstaton se ato i përkasin periudhës përpara vitit 1995, por edhe në konsideratë të tyre, nga kontrolli i analizës financiare të kryer nëpërmjet Njesisë, prindërit e subjektit të rivlerësimit rezultuan me pamjaftueshmëri financiare për të justifikuar ndërtimin e banesës në Kodër - Kamëz, Tiranë.

22.6.9 Lidhur me shkakun e ngritur në ankim nga subjekti i rivlerësimit, *se për ndërtimin e banesës kanë ndihmuar edhe familjarë të tjerë*, trupi gjykues çmon se fakti i përfshirjes në ndërtim të familjarëve të subjektit, nuk përbën provë në drejtim të vlerësimit të kostove të krahut të punës, konkluzion ky në linjë me jurisprudencën e Kolegjit³¹ për raste të ngjashme, në situata ndërtimesh informale.

22.6.10 Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, *se si burim kanë shërbyer edhe të ardhurat e nënës së tij nga toka bujqësore*, trupi gjykues vlerëson se subjekti provoi përfitimin nga babai i tij të tokës me AMTP-në nr. {***}, me sipërfaqe prej 5240 m², por nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor realizimin e këtyre të ardhurave, duke mbetur kështu këto pretendime në nivel tërësisht deklarativ dhe, si të tilla, nuk duhen përfshirë në analizën financiare. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, të ardhurat e pretenduara nga shitja e produkteve bujqësore i ka shkak të veçantë ankimi dhe i pretendon si burim jo vetëm të banesës në Kodër - Kamëz, Tiranë, por edhe të pasurive të tjera të tij dhe të prindërve, trupi gjykues vlerëson t'i trajtojë në shkakun ankimor vijues së bashku me konkluzionin e Komisionit, mbi mosdeklarimin nga ana e subjektit të posedimit të 1/5 pjesë takuese, të tokës bujqësore të përfituar me AMTP-në nr. {***}.

22.6.11 Për sa vlerësuar më sipër, trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrolloi analizën financiare, në të cilën u konsideruan të ardhurat e provuara me dokumentacion justifikues ligjor dhe provohet pagesa e detyrimeve tatimore për to. Nga kjo analizë mbetet e konfirmuar diferenca negative e konstatuar nga Komisioni në vlerën 4.273.612 lekë³².

22.7 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se *për pasurinë shtëpi banimi 2 (dy) kate plus papafingo, me sipërfaqe 364 m² dhe 500 m² truall, ndodhur në Kodër - Kamëz, Tiranë*, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie dhe blerjen truallit, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

³¹ Shih arsyetimin e Kolegjit në vendimet nr. 34/2021(JR) dhe nr. 40/2022 (JR), paragrafi 36. [...] Trupi gjykues e vlerësoi të pabazuar në fakte edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit të parashtruar në paragrafin 33.2, në drejtim të moszbritjes nga vlera e përlogaritur, të kostove të pretenduara nga subjekti si të pazbatueshme në kontekstin e një ndërtimi informal, sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk provoi që kostoja e punëtorisë në ndërtimin e pasurisë objekt kontrolli ka qenë zero lekë. Fakti i përfshirjes në ndërtim të familjarëve të subjektit të rivlerësimit, nuk përbën provë të vlerësimit me kosto zero lekë të komponentit të punëtorisë. Ky konkluzion vjen në linjë të vendimmarrjeve më të fundit të Kolegjit, në drejtim të pretendimeve të ngjashme në situata ndërtimesh informale. [...].

³² Shih paragrafin 56, faqe 13 e vendimit nr. 546, datë 30.06.2022, të Komisionit.

Për pasurinë “tokë bujqësore me sipërfaqe 5240 m²”, në fshatin Shëngjergj, Tiranë dhe të ardhurat e krijuara prej saj

23. Komisioni, në lidhje me tokën bujqësore dhe të ardhurat e krijuara prej saj, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, referuar parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, të ardhurat nga toka bujqësore, nuk janë përfshirë në analizën financiare.

23.1 Subjekti, në shkaqet e ankimit ka pretenduar se mosdeklarimi specifikisht i 1/5 së pronësisë mbi sipërfaqen 5240 m², në fshatin Shëngjergj, është thjesht një pasaktësi e karakterit formal dhe nuk përbën shkak për marrjen e masës disiplinore, për sa kohë ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga përdorimi dhe gëzimi i kësaj toke në deklaratat periodike vjetore. Po ashtu, subjekti në shkaqet e ankimit ka pretenduar se konkluzioni i Komisionit për mospërfshirjen e të ardhurave nga toka bujqësore në analizën financiare, është tërësisht i gabuar, në kundërshtim me legjislacionin tatimor dhe në kundërshtim me jurisprudencën e trupave të rivlerësimit, dhe tregon njëanshmërinë e Komisionit e qëndrimin paragjykses të tij. Subjekti argumenton se ka paguar taksën mbi përdorimin e tokës bujqësore, e cila është i vetmi detyrim i parashikuar në legjislacionin në fuqi, për përdorimin e saj.

23.2 Në vijim, trupi gjykues, nga aktet në fashikull, pretendimet e subjektit të rivlerësimit në shkaqet e ankimit dhe parashtrimet në Kolegj, konstaton dhe vlerëson se:

23.2.1 Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Të ardhura nga shfrytëzimi ndër vite i banesës në Kodër - Kamëz dhe të tokës bujqësore në emër të babait, në fshatin Shëngjin të Nj. Adm. Shëngjergj, në shumën “4.220.000 lekë”*. Subjekti nuk i ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting* dokumentacion provues lidhur me këtë deklaram. Këto të ardhura janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit edhe në deklaramet periodike vjetore nga viti 2005 deri në vitin 2016³³, si likuiditet nga shfrytëzimi i tokës bujqësore në emër të babait, përfituar sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, me nr. akti {***}, Shëngjergj, Tiranë.

23.2.2 Në procesverbalin e datës 25.01.2016,³⁴ “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, subjekti ka deklaruar se: *[...] Në Shëngjergj është toka e përfituar nga ligji nr. 7501, në emër të babait. [...] Toka shfrytëzohet nga unë, familja ime dhe babai, gjatë gjithë këtyre viteve. Kultivojmë rrush, kumbulla, misër, jonxhë dhe një pjesë perime. Këto prodhime i shesim në treg të lirë, në Tiranë, unë dhe prindërit pa dokument, vetëm me pagesën e taksës së vendit ku tregtohen. [...] Referuar Certifikatës familjare të datës 16.02.2016³⁵, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë e trungut familjar të babait të tij, S. Sh., në datën 01.08.1991, duke përfituar rrjedhimisht pjesë takuese nga kjo pasuri. Nuk rezulton që subjekti ta ketë deklaruar pjesën takuese të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting*.*

23.2.3 Në pyetësin e datës 07.10.2021, i pyetur nga Komisioni, pse nuk e ka deklaruar këtë pasuri, ndër të tjera, subjekti ka sqaruar se: *[...] Për shkak se toka nuk është e regjistruar akoma pranë ASHK*

³³ Konkretisht: DV/2005 – 300.000 lekë; DV/2006 – 100.000 lekë; DV/2007 – 200.000 lekë; DV/2008 – 370.000 lekë; DV/2009 – 350.000 lekë; DV/2010 – 470.000 lekë; DV/2011 – 530.000 lekë; DV/2012 – 670.000 lekë; DV/2013 – 540.000 lekë; DV/2014 – 450.000 lekë; DV/2015 – 240.000 lekë; DV/2016 – 200.000 lekë.

³⁴ Kthim Përgjigje ILDKPKI nr. {***} prot., datë 28.06.2021.

³⁵ Bashkëlidhur procesverbalit të ILDKPKI-së të datës 25.01.2016.

dhe nuk është bërë ndarja e pjesëve takuese, ai e ka deklaruar atë çdo vit (si përdorues) si pronë të babait të tij të ndjerë, duke qenë se ai ishte kryefamiljar i familjes bujqësore në kohën kur u përftua ajo sipërfaqe toke. [...] Subjekti për të provuar të ardhurat nga toka bujqësore, ndër të tjera,³⁶ ka vënë në dispozicion të Komisionit këto akte:

(i) Procesverbal, datë 18.10.2021, i Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Tiranë (AREB), në të cilin përcaktohet se, në sipërfaqen 5.240 m² të tokës bujqësore të subjektit, janë mbjellë kultura bujqësore, duke specifikuar llojin dhe sasinë.

(ii) Shkresë nr. {***} prot., datë 20.10.2021, e Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Tiranë, në të cilën jepet një vlerësim për prodhimet bujqësore të subjektit, duke iu referuar tokës bujqësore si fermë. Sipas kësaj shkrese, totali i fitimit të fermës së subjektit është 988.728 lekë.

(iii) Dëftesa tatimore (8 tetë), të viteve 2018 – 2021, të subjekteve të ndryshme tregtare, të cilëve subjekti i rivlerësimi iu ka shitur produkte bujqësore.

23.2.4 Njësia Administrative Shëngjergj, me shkresën nr. {***} prot., datë 19.10.2021, ka informuar Komisionin se familja e z. Sharra ka përfituar tokë nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1992, me nr. Akti {***}, datë 11.06.1992, lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës në masën 5240 m². Bashkëlidhur shkresës ka përcjellë: (1) Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi, nr. {***}, datë 11.06.1992, sipas së cilit z. S. Sh., në cilësinë e kryefamiljarit,³⁷ ka përfituar 5240 m², tokë bujqësore; (2) Mandatet e arkëtimet për pagesën e taksës së tokës + banese, arkëtuar nga subjekti³⁸; (3) Vërtetim për likuidimin e detyrimeve vendore nr. {***} prot., datë 15.10.2021, të Bashkisë Tiranë, sipas së cilit vërtetohet se subjekti ka likuiduar detyrimet vendore për periudhën 01.01.2016 – 31.12.2021, për pronën “Tokë arë”, me sipërfaqe 5240 m².

³⁶ Subjekti, për të mbështetur deklaratimet e tij gjatë hetimit administrativ, po ashtu, ka paraqitur në Komision: (1) Vërtetim të Njesisë Administrative Shëngjergj nr. {***} prot., datë 28.01.2020, ku deklarohet se: “z. S. Sh. ka përfituar me ligjin nr.7501 një sipërfaqe toke prej 5.240 m², për të cilën është pajisur nga Njësia Administrative Shëngjergj, Tiranë me aktin e marrjes së tokës në pronësi nr. {***}, datë 11.08.1992. Nga viti 2005 e në vijim, kjo sipërfaqe është përdorur nga djali i tij, Arben Sharra, ku ai ka likuiduar të gjitha detyrimet, konfirmuar kjo me vërtetimin nr. {***} prot., datë 28.01.2020, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë; (2) Vërtetim nr. {***} prot., datë 28.01.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, ku deklarohet se “Subjekti ka likuiduar detyrimet vendore për vitin 2019, për pronën tokë arë, me sip. 5.240 m,² në adresën Njësia Administrative Shëngjergj, fshati Shëngjin; (3) Vërtetim nr. {***} prot., datë 30.01.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, ku deklarohet se subjekti ka likuiduar detyrimet vendore, nga data e regjistrimit 01.01.2016 deri më datë 31.12.2019, për pronën tokë arë, me sipërfaqe 5.240 m,² në adresën Njësia Administrative Shëngjergj, fshati Shëngjin.

³⁷ AMTP-ja është lëshuar për 5 frymë.

³⁸ Nga viti 1992 – 2007, toka bujqësore nuk ka qenë objekt i tatueshëm nga ish-Komuna; Për vitin 2007 – 2009, me mandatarkëtim nr. {***}, datë 24.09.2009, subjekti ka likuiduar të gjitha detyrimet për taksën bujqësore dhe taksën mbi ndërtesën, në shumën 2.916 lekë, pranë ish-Komunës Shëngjergj. Për vitin 2010 – 2011, me mandatarkëtim nr. {***}, datë 03.09.2011, subjekti ka likuiduar të gjitha detyrimet për taksën bujqësore dhe taksën mbi ndërtesën, në shumën 2.700 lekë, pranë ish-Komunës Shëngjergj. Për vitin 2012, me mandatarkëtim nr. {***}, datë 12.10.2012, subjekti ka likuiduar të gjitha detyrimet për taksën bujqësore dhe taksën mbi ndërtesën, në shumën 1.227 lekë, pranë ish-Komunës Shëngjergj. Për vitin 2013 – 2014, me mandatarkëtim nr. {***}, datë 20.10.2014, subjekti ka likuiduar të gjitha detyrimet për taksën bujqësore dhe taksën mbi ndërtesën, në shumën 3.041 lekë, pranë ish-Komunës Shëngjergj. Për vitin 2015, me mandatarkëtim nr. {***}, datë 13.11.2015, subjekti ka likuiduar të gjitha detyrimet për taksën bujqësore dhe taksën mbi ndërtesën, në shumën 1.229 lekë, pranë ish-Komunës Shëngjergj. Për vitin 2016 e në vijim, në mbështetje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. {***}, datë 30.12.2015 dhe {***}, datë 26.12.2019, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Qytetin e Tiranës”, ka bërë të gjitha likuidimet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, sipas vërtetimit nr. {***}, datë 28.01.2020, si dhe vërtetimit {***}, datë 15.10.2021.

23.2.5 Bashkia Tiranë, me shkresën nr. {***} prot., datë 20.10.2021, ka informuar se subjekti Arben Sharra rezulton i regjistruar në programin e tyre informatik me kodin vendor {***}, për llojin e pasurisë “arë me sipërfaqe 5240 m²”. Prona është në pronësi të z. S. Sh., por nisur nga fakti që detyrimet vendore të pronës janë likuiduar dhe vazhdojnë të likuidohen nga z. Arben Sharra, është kryer regjistrimi i kësaj prone në emër të tij në programin e tyre informatik.

23.2.6 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. {***} prot., datë 27.01.2020, referon se pas verifikimeve të bëra në regjistrin kombëtar, as subjekti i rivlerësimit dhe as familjarët e tij nuk figurojnë të regjistruar në organet tatimore, për ushtrimin e ndonjë aktiviteti privat. Po ashtu, QKB-ja³⁹ informon se familjarët e subjektit apo vetë subjekti nuk figurojnë të regjistruar në regjistrin tregtar.

23.2.7 Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor (në vijim “AREB”), me shkresën nr. {***} prot., datë 22.02.2022, ka informuar Komisionin se subjekti nuk është i pajisur me kartën e fermerit. Të dhënat me treguesit agroteknikë janë përlllogaritur nga kontot, që përpilohen për çdo kulturë dhe vlere i referohet vitit bujqësor 2020 – 2021. Lidhur me prodhimtarinë e produkteve bujqësore dhe fitimit të mundshëm të z. Arben Sharra, për periudhën 2005 – 2016, AREB shprehet se nuk mund të bëjnë vlerësim *jo thjesht për faktin se z. Arben Sharra nuk është pajisur me kartë, por AREB në praktikën e punës së saj, në të gjitha llojet e vlerësimit, kryen vlerësim vetëm për vitin bujqësor në momentin kur paraqitet kërkesa e të interesuarit*. Po ashtu, në këtë shkresë, AREB shprehet lidhur me shpenzimet agroteknike. Nga hetimi në Komision ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të ketë në pronësi mjete motorike për punimin e tokës, si dhe nuk ka kontratë me OShEE-në për furnizim me energji elektrike në tokën bujqësore. Duke marrë në konsideratë faktin që prindërit e subjektit kanë qenë në pamundësi për të punuar tokën, bazuar në shkresën e AREB-it, në vlerësim të Komisionit, subjekti e ka pasur të pamundur të kryente i vetëm të gjitha shërbimet e tokës bujqësore⁴⁰.

23.2.8 Komisioni i është drejtuar me kërkesë për informacion Drejtorisë Rajonale Tatimore (në vijim “DRT”), Tiranë lidhur me faktin: “A konsiderohet shitja e produkteve bujqësore, veprimtari tregtare?” - “A ka qenë i detyruar subjekti të regjistrohet në organet tatimore, duke qenë se ka kryer shitje të produkteve bujqësore në treg, për të cilat ka përfituar të ardhura në shumën 4.200.000 lekë, për periudhën 2005 – 2016?” - si dhe “A ka qenë i detyruar subjekti të paguajë detyrime tatimore për shitjen e produkteve bujqësore, për sa kohë nuk ka pasur statusin e fermerit?”⁴¹

³⁹ Kthim përgjigje nga QKB, nr. {***} prot., datë 04.02.2020.

⁴⁰ Vetëm për rrënjët e rrushit, që janë 457 copë, për një rrënjë, bazuar në shërbimin agroteknik të pjergullës së vënë në dispozicion nga AREB, duhet spërkatje me pompë krah 4 herë, ujitje 5 herë, plehërim 2 herë dhe krasitje 2 herë.

⁴¹ DRT Tiranë, me shkresën nr. {***} prot., datë 17.03.2022, ndër të tjera, ka informuar se: [...] Bazuar në ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 4, citohet se: Veprimtari ekonomike është çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra ose shërbime, përfshirë veprimtarinë nxjerrëse, bujqësore dhe aktivitetet profesionale. Veprimtari ekonomike konsiderohet gjithashtu shfrytëzimi i pasurisë së trupëzuar ose të patrupëzuar, me qëllim realizimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm. - Bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 4.1: Në administratën tatimore regjistrohen personat juridikë, fizikë dhe individët e mëposhtëm: germa dh) fermeri... - Duke u nisur nga të dhënat e dërguara mbi qarkullimin në shumën 4.200.000 lekë, për periudhën 2005 – 2016, detyrimet tatimore që duhet të paguajë subjekti janë sipas kërkesave të ligjit nr. 9632, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003, “Për Mbledhjen e Kontributeve të Detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. - Bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat

23.2.9 Komisioni, në vijim të përgjigjes së DRT Tiranë, ka arsyetuar se subjekti ka kryer veprimtari ekonomike, për të cilat duhet të paguante detyrime tatimore, si vijon: (1) Bazuar në nenin 9, pika 1 e ligjit nr. 9632/2006, “Për sistemin e taksave vendore”, subjekti kishte detyrimin për të paguar taksën vendore për biznesin e vogël, e cila, me ndryshimet e bërë në këtë ligj, në vitin 2013, është emërtuar si tatim i thjeshtuar mbi biznesin e vogël. Ky detyrim është i ndryshëm nga detyrimi i parashikuar nga pika 3 e nenit 9 të po këtij ligji, që lidhet me detyrimet për taksat për pasuritë e paluajtshme, ku përfshihet edhe toka bujqësore. (2) Bazuar në nenin 9 të ligjit nr. 9136/2013, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, subjekti, si i vetëpunësuar, kishte detyrimin për të paguar kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

23.2.10 Në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, pasi rezultoi që: (1) Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën vetting posedimin e pasurisë “tokë bujqësore me sipërfaqe 5240 m²”, si dhe bashkëpronësinë e tij me 1/5 pjesë takuese mbi këtë pasuri. (2) Subjekti nuk ka provuar me dokumentacion provues të ardhurat e përfutur nga toka bujqësore, si dhe pagimin e detyrimeve tatimore përkatëse për këto të ardhura. (3) Duket e paqartë se si subjekti ka mundur të kryejë i vetëm të gjitha shërbimet e tokës, duke marrë në konsideratë faktin se, në të njëjtën kohë, ka qenë i punësuar si prokuror në Dibër e më pas në Durrës. Për rrjedhojë, Komisioni të ardhurat e deklaruar nga subjekti si të përfutura nga shitja e produkteve bujqësore, nuk i ka përfshirë në analizën financiare.

23.2.11 Subjekti i rivlerësimit, si në prapësimet, ashtu edhe në shkaqet e ankimit, pretendon se ai e ka deklaruar përdorimin e tokës bujqësore, sepse në çdo deklaratë periodike vjetore, duke filluar nga viti 2005, por edhe në deklaratën e pasurisë vetting, ka deklaruar të ardhura nga shfrytëzimi i tokës bujqësore në emër/pronësi të babait.

23.2.12 Në përgjigje të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me mosdeklarimin e pjesës takuese të tokës bujqësore, trupi gjykues verën se nga hetimi administrativ në Komision, rezultoi e provuar që babai i subjektit, S. Sh., ka përfutur tokë nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1992, me nr. Akti {***}, datë 11.06.1992, lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës, në masën 5240 m². Në certifikatën familjare të familjes bujqësore, me kryefamiljar z. S. Sh., datë 01.08.1991, evidentohet edhe emri i subjektit. Sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, ligjvënësi e njohu bashkëpronësinë mbi tokën bujqësore për të gjithë ata anëtarë të familjeve shqiptare të cilët banonin dhe jetonin në fshat apo në ferma bujqësore, por që ishin në përbërje të familjes bujqësore. Bashkëpronësia në tërësi e familjes bujqësore, për sa kohë nuk është pjesëtuar sipas rregullave të nenit 207 të Kodit Civil, tërheq të drejta dhe detyrime ndaj asaj pasurie, për secilin prej tyre. Në këto rrethana faktike, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 4, germa “a” e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, ka detyrimin të deklarojë të gjitha të drejtat reale mbi pasuritë e paluajtshme sipas Kodit Civil.

23.2.13 Subjekti i rivlerësimit në ankimin e tij ka pretenduar se nuk e ka deklaruar pjesën takuese të tokës, për shkak se toka nuk është e regjistruar akoma pranë AShK-së dhe nuk është bërë ndarja e pjesëve takuese. Trupi gjykues, referuar shkresës nr. {***} prot., datë 11.02.2022, të AShK-së, Drejtoria Vendore Tirana Rurale, e administruar në dosjen gjyqësore të Komisionit, konstaton se të afishuara në emër të familjes bujqësore S. H. Sh., rezultojnë të regjistruara pasuritë e llojit “arë”, me

tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 5, parashikohet se: **Mosregjistrimi nuk e çliron një person nga pagesa e detyrimit tatimor ose përmbushja e detyrimeve të tjera tatimore.**

sipërfaqe 520 m² dhe 810 m² përkatësisht, të ndodhura në Shëngjin⁴², Tiranë, të përfituara me aktin nr. {***}, datë regjistrimi 04.03.1999.

23.2.14 Në analizë të shkaqeve të ankimit, trupi gjykues vëren se të njëjtin prapësim mbi mosregjistrimin e pronës si rezultat i ndryshimeve ligjore, subjekti i rivlerësimit e ka pretenduar edhe për pasurinë e dhuruar nga babai në vitin 1997, ndodhur në Kodër - Kamëz, Tiranë, ndërkohë që nga aktet rezultoi që kjo pasuri ishte regjistruar mbi bazën e kontratës së dhurimit, që në vitin 1999. Këto situata të përsëritura në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, duken si qasje e tij për të krijuar tablo të paqartë, me të dhëna kontradiktore, të ndryshme nga ato që rezultojnë nga aktet në dosjen gjyqësore.

23.2.15 Në përfundim, lidhur me pasurinë “tokë bujqësore me sipërfaqe 5240 m²”, në fshatin Shëngjergj, Tiranë, përfituar nga babai i subjektit me AMTP-në nr. {***}, datë 11.08.1992, trupi gjykues ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe ato periodike vjetore, pjesën takuese mbi këtë pasuri, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

23.2.16 Lidhur me të ardhurat e realizuara nga shfrytëzimi i tokës bujqësore, subjekti i rivlerësimit në shkaqet e ankimit pretendon se këto të ardhura, të deklaruara në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën *vetting*, janë të ardhura të ligjshme dhe Komisioni duhej t’i kishte përfshirë në analizën financiare. Shërbimet e nevojshme për shfrytëzimin e tokës bujqësore nuk janë kryer vetëm prej tij, por edhe me ndihmën e familjarëve, bashkëshortes, fëmijëve dhe të afërmëve. Subjekti ka paraqitur edhe fotografi të prindërve, të bëra në vitet 1995 – 2000, në të cilat pretendon që duket qartë se gjatë kësaj periudhe, ata janë marrë me bujqësi dhe blegtori. Referuar legjislacionit tatimor, të ardhurat e përfituara nga shitja e produkteve bujqësore apo blegtorale nga individët fizikë (fermerët, të cilët nuk janë të regjistruar dhe nuk janë të detyruar të regjistrohen në organin tatimor) janë të ardhura, të cilat nuk i nënshtrohen pagesës së detyrimeve tatimore, bazuar në parashikimet e pikës 11, të nenit 8/1, “Të ardhura të përjashtuara”, të ligjit nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”. Për të provuar sa sipër, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion të Komisionit: (1) “Raportin e Vlerësimit”, datë 10.06.2022, të ekspertes L. B., për llogaritjen e të ardhurave nga shfrytëzimi i tokës dhe blegtoria. Referuar këtij raporti, vlera e fitimit neto të realizuar nga prodhimet e tokës bujqësore dhe tregtimi i tyre, që nga vitit 1993 deri në vitin 2004, sipas këtij raporti, përllogaritet në 7.497.744 lekë, ndërsa për të gjithë periudhën nga viti 2005 e në vazhdim, në vlerën 11.426.064 lekë. Sipas subjektit, në këtë vlerë janë përfshirë të ardhurat e realizuara nga shitja e frutave të prodhuara nga drurët frutorë në pronësi, shumica e të cilëve nuk kanë fare nevojë për shërbime bujqësore, rriten sikurse bimët e egra në pyll, dhe (2) Vërtetim nr. {***} prot., datë 09.06.2022, të Njesisë Administrative Shëngjergj, me të cilin vërtetohet se z. S. Sh. dhe familja e tij janë marrë kryesisht me aktivitet bujqësor dhe blegtoral, prodhimin e shitjen e produkteve të ndryshme bujqësore e blegtorale, si dhe me mbarëshkrimin e bagëtive.

23.2.17 Në përgjigje të pretendimeve të mësipërme të subjektit, trupi gjykues vlerëson se vetëm deklarimi i këtyre të ardhurave në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe deklaratat periodike vjetore, nuk është i mjaftueshëm që ato të konsiderohen si të ardhura të ligjshme për efekt të këtij procesi. Lidhur me realizimin e të ardhurave nga shfrytëzimi i tokës bujqësore, nisur nga fakti që këto të ardhura janë

⁴² Këtu citohet vendndodhja sipas aktit të administruar në fashikullin gjyqësor në Komision. Vendndodhja e saktë e kësaj toke bujqësore është fshati Shëngjin, Njësia Administrative Shëngjergj, Tiranë.

trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit,⁴³ trupi gjykues vlerëson të analizojë në vijim faktet dhe rrethanat e çështjes, në dy aspekte: (i) atë të realizimit të sasisë së të ardhurave të deklaruara në vite, si të krijuara nga shfrytëzimi i tokës bujqësore, dhe (ii) në funksion të ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

23.2.18 Në arsyetim të pikës (i) të paragrafit më sipër, trupi gjykues arsyeton se shfrytëzimi i tokës bujqësore nga subjekti dhe familjarët e tij, në kushtet e gjenerimit të sasisë së të ardhurave të pretenduara nga subjekti, kërkon një organizim të zakonshëm tregtar dhe që, më së paku, disa familjarë/individë të jenë në mënyrë të vazhdueshme të lidhur me ushtrimin e këtij aktiviteti. Nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor të Komisionit, nuk rezultoi e provuar me dokumentacion mbështetës ligjor, organizimi i zakonshëm tregtar apo familjar për ushtrimin e këtij aktiviteti, sasia e të ardhurave të pretenduara nga shitja apo përpunimi i këtyre produkteve⁴⁴, si dhe regjistrimi apo pagesa e detyrimeve tatimore lidhur me to. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se për shfrytëzimin e tokës bujqësore dhe të mbjellat janë kujdesur edhe familjarët e tij, ndërkohë që nga dokumentacioni i administruar, nuk rezulton e dokumentuar që ndonjëri prej tyre të ketë jetuar vazhdimisht në fshat pas vitit 2005 apo që produktet e prodhuara të jenë shitur në treg dhe të kenë siguruar të ardhura. Fotografitë e paraqitura nga subjekti, në të cilat pretendon se duket qartë që gjatë viteve 1995 – 2000, prindërit e tij janë marrë me bujqësi dhe blegtori, në vlerësim të trupit gjykues, ato janë akte të cilat nuk mund të konsiderohen me vlerë në drejtim të provueshmërisë së realizimit të sasisë së të ardhurave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

23.2.19 Shkresa e AREB-it me nr. {***} prot., datë 20.10.2021, e vënë në dispozicion të Komisionit nga subjekti i rivlerësimit, sipas së cilës totali i fitimit të fermës së subjektit të rivlerësimit është në vlerën 988.728 lekë, nuk dokumenton të ardhurat e deklaruara prej tij, për vitet 2005 – 2016. Për më tepër, ky institucion, në vijim, në përgjigje të kërkesës së Komisionit për të saktësuar mënyrën e llogaritjes të kësaj vlere, është shprehur se: *nuk mund të bëjnë vlerësim, jo thjesht për faktin se z. Arben Sharra nuk është pajisur me kartë, por AREB në praktikën e punës së saj, në të gjitha llojet e vlerësimit, kryen vlerësim vetëm për vitin bujqësor, në momentin ku paraqitet kërkesa e të interesuarit.*

23.2.20 Në vlerësim të trupit gjykues, raporti i vënë në dispozicion Komisionit nga subjekti i rivlerësimit referon një numër shumë të madh të llojeve të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, të cilat eksperti i ka konsideruar sipas akteve të vëna në dispozicion nga vetë subjekti, situatë e cila krijon bindjen se është realizuar në funksion të rezultateve të pritshme prej tij. Raporti vjen në kundërshtim me deklaratimet e subjektit, për këto arsye: (i) Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja, në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit nuk ka përmendur të ardhura të realizuara nga blegtoria, ndërkohë në raportin e ekspertit janë listuar edhe të ardhurat nga tregtimi i krerëve të bagëtisë, shitja peshë e gjallë në tregun e lirë, si dhe të ardhura nga prodhimi i qumështit prej këtyre krerëve gjatë viteve, duke u bazuar kryesisht në deklaratën noteriale të znj. H. Sh., datë 07.03.2020, e cila ka deklaruar se kanë pasur bagëti të ndryshme.⁴⁵ (ii) Në tabelën përmbledhëse të të ardhurave nga

⁴³ Shih vendimin nr. 18/2021(JR); nr. 12/2023 (JR) etj.

⁴⁴ Neni 2 i ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, përcakton se tregtari është personi fizik, sipas kuptimit të Kodit Civil, i cili ushtron veprimtari ekonomike të pavarur, që kërkon një organizim tregtar të zakonshëm. Neni 3 i këtij ligji përcakton se personi fizik, i cili ushtron veprimtari bujqësore, blegtorale, pyjore e të ngjashme, vlerësohet tregtar, nëse veprimtaria e tij përqendrohet kryesisht në përpunimin dhe shitjen e produkteve bujqësore, blegtorale, pyjore (agrobiznes).

⁴⁵ Konkretisht 3 lopë, 10 dele dhe 8 dhi.

bujqësia, për vitet 1993 – 2004 të këtij raporti, eksperti iu referohet 6 (gjashtë) zërave të produkteve të kultivuara, ndërsa për vitet 2005 – 2021, iu referohet rreth 14 (katërmëdhjetë) zërave të produkteve të kultivuara. Ndërkohë, në procesverbalin e ILDKPKI-së të vitit 2016, subjekti ka deklaruar se merren vetëm me kultivimin e disa prodhimeve të ndryshme nga zërat e raportit. Në vlerësim të trupit gjykues, ky raport është mbështetur mbi hipoteza, si për mundësinë e prodhimit të produkteve bujqësore, ashtu edhe atyre blegtorale, pa provuar llojshmërinë dhe/apo sasinë faktike të prodhimit të produkteve ndër vite. Në raport, vlerësimi i fitimit është bërë pa konsideruar faktorët atmosferikë dhe efektet e tyre, duke i konsideruar si variabël konstant, pa ndikim në prodhimin bujqësor apo atë blegtoral, për pasojë ky akt ekspertimi, i parë në harmoni me aktet e tjera, nuk u gjet me vlerë provuese nga ana e trupit gjykues, për të legjitimuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi të ardhurat nga shfrytëzimi i tokës bujqësore, deklaruar ndër vite.

23.2.21 Në përfundim, edhe pse rezultoi që subjekti i rivlerësimit ka paguar rregullisht taksën e tokës, ai nuk arriti të provojë me dokumente ligjore, nga ato të parashikuara nga neni 49 i ligjit nr. 86/2016, realizimin e të ardhurave nga shfrytëzimi i tokës bujqësore të deklaruara në deklaratat periodike 2005 – 2016, duke mbetur kështu pretendimet e tij në nivel deklarativ. Për këto arsye, nga ana e trupit gjykues, vlerësohet i drejtë konkluzioni i Komisionit për të mos i përfshirë këto të ardhura në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

23.2.22 Pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se legjislacioni nuk ka parashikuar detyrim tatimor për këto të ardhura, trupi gjykues nuk e sheh me relevancë për ta trajtuar, për sa kohë të ardhurat e pretenduara nga ana e tij, si të krijuara nga shfrytëzimi i tokës bujqësore, mbetën në nivel deklarativ dhe nuk u provuan. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi të mos i përfshijë në analizën financiare këto të ardhura.

23.2.23 Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se qëndrimi i Komisionit lidhur me të ardhurat nga shfrytëzimi i tokës bujqësore tregon njëanshmëri dhe qëndrimin paragjykses të tij, trupi gjykues vlerëson se vendimi i Komisionit është bazuar në një proces hetimi të plotë, në analizën e saktë dhe shteruese të provave të mbledhura dhe në zbatim të parimeve të procesit të rregullt ligjor. Me këtë arsyetim, për sa analizuar më lart, edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit gjendet nga trupi gjykues, i pabazuar.

Për pasurinë “banesë e ndodhur në parcelën me sipërfaqe 370.15 m,²” pretenduar të ndërtuar nga z. I. L., në Kodër - Kamëz, Tiranë

- 24.** Nga shqyrtimi i ortofotove digjitale të ASIG-ut⁴⁶, të cilat i përkasin periudhës 2007 – 2018, Komisioni ka konstatuar se në parcelën pranë godinës 2 (dy) kate + papafingo, në Kodër - Kamëz, Tiranë, ndodhet edhe një ndërtim, i cili është përfshirë në procedurat e legalizimit në emër të babait të subjektit të rivlerësimit. Komisioni, pasi ka dyshuar për pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, ka vlerësuar se ndodhet në pamundësi objektive për të kontrolluar pronësinë dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit të saj. Në këto rrethana ka çmuar se deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

24.1 Subjekti i rivlerësimit, në shkaqet e ankimit ka ngritur të njëjtat pretendime me ato të paraqitura prej tij gjatë hetimit administrativ në Komision.

⁴⁶ Shih shkresën “Kthim përgjigje të ASIG-ut”, nr. {***} prot., datë 23.02.2022.

24.2 Trupi gjykues, pas shqyrtimit të akteve në fashikullin gjyqësor dhe të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim e parashtime, të depozituara në Kolegj, konstaton dhe vlerëson si vijon:

24.2.1 AShK, Drejtoria Vendore Tirana Veri, me shkresën nr. {***} prot., datë 17.11.2021, ka informuar Komisionin se z. S. Sh., babai i subjektit të rivlerësimit, rezulton të ketë qenë subjekt deklarues pranë këtij institucioni, për një ndërtim, të ngritur në vitin 2011, me adresë në Kodër - Kamëz, Tiranë, Njësia Administrative nr. {***}. Në datën 10.09.2015, ka plotësuar “Deklaratë për përfshirje në procedura legalizimi të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesë në ndërtim me leje”⁴⁷, në të cilën është shënuar si numër kontakti, telefoni celular: {***}, një ndër numrat e kontaktit të subjektit të rivlerësimit, deklaruar në deklaraten e pasurisë *vetting*. Ky ndërtim ndodhet në parcelën me nr. pasurie {***}, z. k. {***}, me sipërfaqe totale 370.15 m², e cila, bazuar në urdhrin nr. {***}, datë 03.08.2015, të regjistruarit të ZVRPP-së Tiranë është në pronësi shtet⁴⁸, parcelë e ndryshme nga ajo në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, në dokumentin “Skicë fushore”, të datës 17.02.2016⁴⁹, përcjellë në Komision bashkëlidhur kësaj shkrese, rezulton i shënuar i njëjti numër telefoni, me të sipërcituarin. Në këtë dokument është e skicuar dhe specifikohet se banesa për të cilën ka aplikuar z. S. Sh. për legalizim, kufizohet me banesën 2 (dy) kate + papafingo, në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

24.2.2 Në përgjigjet e datës 13.01.2022, të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *[...] Deri në vitin 2014, kur unë dhe babai im kemi bërë marrëveshjen verbale me z. I. L. për shitjen e banesës dhe ia kemi dorëzuar fizikisht z. I. L., në parcelën ndërtimore dhe brenda murit rrethues të saj, nuk ka patur asnjë ndërtim tjetër. Kjo gjë është lehtësisht e verifikueshme me anë të ortofotove digjitale të vitit 2014. Në lidhje me banesën të cilës ju i referoheni, unë nuk kam pasur asnjë dijeni për ndërtimin e saj. [...]. Pasi e pyeta në lidhje me nisjen e procedurës së legalizimit të kësaj banese në emër të babait, ai më është përgjigjur se, për shkak se ndërtimi ndodhej brenda parcelës e murit rrethues të banesës ekzistuese dhe mund të kishte ndonjë problem për legalizimin e saj, ai kishte biseduar me babain dhe i kishte kërkuar që kjo procedurë të niste në emër të tij.* Bashkëlidhur, subjekti ka paraqitur deklaraten noteriale nr. {***}/{***} rep./kol., datë 29.01.2022, në të cilën z. I. L., konfirmon sa ka deklaruar subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ. Në lidhje me vitin e ndërtimit të banesës (2011), të shprehur në kërkesën për legalizim të bërë nga ana e z. S. Sh. për këtë objekt, z. L. deklaroi se është një lapsus i bërë nga z. Sh., pasi ndërtimin e ka bërë pas vitit 2014, fakt i cili provohet edhe me ortofot digjitale.

24.2.3 Me shkresën nr. {***} prot., datë 28.02.2022, Njësia Administrative nr. {***} vërteton se babai i subjektit të rivlerësimit është trajtuar me pagesën e *statusit të verbërisë*, duke pasur si kujdestare nënën e tij, dhe është pajisur me librezë verbërie nga data 14.10.2011, si i verbër i grupit të parë, me afat të përhershëm. Pra, në kohën e aplikimit për legalizim, babai i subjektit të rivlerësimit ka pasur statusin e *të verbrit*.

24.2.4 Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës për pasuri të fshehur, bazuar në konstatimet: (i) Parcela ku është ndërtuar shtëpia për të cilin ka aplikuar për legalizim babai i subjektit të rivlerësimit nuk është e njëjta parcelë, e cila i është shitur z. I. L., me kontratë shitje nr. {***}/{***} rep./kol., datë 16.06.2017. (ii) Nuk rezulton asnjë dokumentacion

⁴⁷ Protokolluar me nr. {***} prot., datë 14.09.2015.

⁴⁸ Referuar akteve bashkëlidhur përgjigjes së AShK-së Tirana Veri, nr. {***} prot., datë 24.02.2020.

⁴⁹ Skica fushore duket se mban numrin e protokollit {***}, datë 14.09.2015.

provues që ky ndërtim të jetë kryer nga z. I. L. apo që të përdoret nga ana e tij. (iii) Aplikimi për legalizimin e kësaj pasurie është bërë nga babai i subjektit të rivlerësimit, i cili në momentin e aplikimit ka qenë i verbër, duke qenë i paqartë nënshkrimi i tij në formularin e vetëdeklarimit të disponuar pranë ALUIZNI-t. (iv) Në formularin e vetëdeklarimit pranë ALUIZNI-t, është vendosur numri i telefonit të subjektit të rivlerësimit. Ky numër telefoni është vendosur edhe në dokumentin skicë fushore të datës 17.02.2016. (v) Ndërtimi rezultoi i kryer pas vitit 2015, e për rrjedhojë, z. L. nuk kishte asnjë arsye për të kontaktuar babain e subjektit të rivlerësimit, në vitin 2015, dhe për t'i kërkuar atij të kryente aplikimin pranë ALUIZNI-t, për sa kohë ndërtimi nuk ekzistonte. (vi) Subjekti i rivlerësimit, deri në momentin e aplikimit pranë ALUIZNI-t të bërë nga babai i tij për këtë ndërtim, ka qenë pronar dhe posedues i banesës trekatëshe, pasi ai vetëm në vitin 2017, ka kryer shitjen e saj, duke e deklaruar si pakësim në deklaratën e interesave private periodike të këtij viti. (vii) Subjekti nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit asnjë dokumentacion provues që z. L. ka komunikuar me babain e tij në vitin 2015. (viii) Subjekti nuk ka provuar me dokumentacion provues që banesa është marrë në posedim nga z. L. në vitin 2014. (ix) Si rrjedhojë e trashëgimisë ligjore⁵⁰ (e cila, sipas deklarimeve të subjektit, nuk është çelur ende), subjekti i rivlerësimit gëzon aktualisht të drejta mbi këtë aplikim.

24.2.5 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, vlerësoi se ato nuk janë bindëse dhe nuk janë mbështetur në prova, por vetëm në deklaratat noteriale, vlera provuese e të cilave është e kufizuar, për sa kohë nuk shoqërohen me dokumentacion provues.

24.2.6 Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në shkaqet e ankimit se: (i) Nuk ka pasur asnjë dijeni për ndërtimin e kësaj banese. Deklarata për përfshirjen e kësaj banese në procedurat e legalizimit është plotësuar në emër të babait të tij, pa dijeninë e subjektit. Subjekti ka theksuar se numri i telefonit është shënuar nga babai dhe z. L., pa e vënë atë në dijeni. (ii) Komisioni arrin në konkluzionin e rëndë se “krijohet bindja se kjo është pasuri e fshehur e vetë subjektit”, bazuar vetëm në faktin se në dokumente është shënuar numri i telefonit të subjektit të rivlerësimit. (iii) Në kohën kur babai i subjektit ka aplikuar pranë ALUIZNI-t, për legalizimin e banesës njëkatëshe të ndërtuar nga z. L., familja Sh. nuk e ka pasur në posedim banesën dykatëshe. Deklarimi i pakësimit të kësaj ndërtese është kryer në vitin 2017, për shkak se juridikisht shitja u krye në këtë vit.

24.2.7 Sa i përket pretendimit të subjektit, se asgjë tjetër nuk e lidh konkluzionin e Komisionit përveç numrit të telefonit, në analizë të vendimit të Komisionit dhe akteve të administruara, trupi gjykues vëren se Komisioni nuk ka vlerësuar vetëm ekzistencën e numrit të telefonit në formularin e aplikimit, por të gjitha të dhënat e rezultuara sipas dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, me të cilat subjekti i rivlerësimit është njohur në çdo fazë të tij, dhe mbi bazën e të cilave i ka kaluar subjektit barrën e provës.

24.2.8 Lidhur me pretendimin e subjektit, se në kohën kur babai i tij ka aplikuar pranë ALUIZNI-t, për legalizimin e banesës njëkatëshe, të ndërtuar nga z. L., familja Sh. nuk ka pasur në posedim banesën dykatëshe, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë vetting, ka deklaruar se ka bërë marrëveshje verbale për shitjen e shtëpisë në Kodër - Kamëz, Tiranë, me shtetasin I. L., në vitin 2014, për të cilën ka marrë paradhënie, shumën 20.000 euro, në vitin 2014, si dhe shumën 30.000 euro, në vitin 2015, të deklaruara në deklaratat periodike të interesave private në vitet

⁵⁰ Nga shkresa nr. {***} prot., datë 15.03.2022, e Bashkisë Tiranë, Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative nr. {***}, rezultoi se babai i subjektit ka ndërruar jetë më datë 17.11.2016.

respektive. Subjekti i rivlerësimit, ashtu sikurse ka deklaruar në deklaratat e interesave privatë të viteve 2014 dhe 2015, shumat e pretenduara të marra paradhënie për shitjen e banesës në Kodër - Kamëz,⁵¹ kishte detyrimin ligjor të deklaronte se banesa dy kate + papafingo në Kodër - Kamëz, Tiranë, nuk posedohej më nga vetë ai. Për të provuar posedimin e banesës nga I. L. në vitin 2014, bashkëlidhur prapësimeve për rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka depozituar vërtetime lëshuar nga Njësia Administrative nr. {***} dhe ndërlidhësi me komunitetin, të cilët shprehen mbi largimin e familjes *Sh.* në vitin 2013, nga banesa në Kodër - Kamëz, Tiranë, dhe vendosjen e I. L. në të, si dhe fotografi të familjes *L.*, deklarata noteriale dhe aktverifikim për përcaktimin e kohës së ndërtimit të banesës, për të cilat subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk janë analizuar nga ana e Komisionit, duke e bërë kështu të pavlefshëm vendimmarrjen e tij, pasi arsyetimi i vendimit është aspekt i nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

24.2.9 Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, në analizë të vendimit të ankimuar, vëren se në poshtëshënimin nr. 25, paragrafi 61 të tij, Komisioni ka cituar aktet që subjekti i rivlerësimit ka depozituar në përgjigje të barrës së provës, konkretisht: (i) Deklaratë noteriale nr. {***}/{***} rep./kol., datë 06.06.2022, të shtetasit I. L., në të cilën deklaroi se: *bashkë me familjen ka filluar të banojë në banesën e blerë me kontratën e shitblerjes nr. {***}/{***} rep./kol., datë 16.06.2017, nga z. S. dhe z. Arben Sharra, që në muajin tetor të vitit 2014, menjëherë pas dhënies së shumës së parë paradhënie, prej 20.000 euro, për blerjen e kësaj banese në datën 01.10.2014. Për të vërtetuar thëniet e mia se unë bashkë me familjen time kemi banuar në këtë banesë që prej muajit tetor të vitit 2014, po i bashkëlidh kësaj deklarate disa foto të mia familjare, të shkrepura në data të ndryshme të muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2014.* (ii) Aktverifikim për përcaktimin e kohës së ndërtimit të banesës, që mban datën 06.06.2022, të ekspertit gjeodet dhe vlerësues A. S., në të cilin specifikohet që ndërtesa është ndërtuar në nëntor 2015. (iii) Deklaratë noteriale nr. {***}/{***} rep./kol., datë 20.06.2022 e z. Q. L., në të cilën deklaroi se ka lidhje familjare me z. I. L. që ka blerë shtëpinë e z. Arben Sharra dhe jeton aty prej vitit 2014. Për nevoja të tij, z. L. ka ndërtuar një tjetër banesë në pjesën lindore të shtëpisë. (iv) Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. {***}/{***} rep./kol., datë 22.06.2022, sipas së cilit subjekti i rivlerësimit së bashku me familjarët e tij përfitojnë 1/6 pjesë takuese të pasurisë trashëgimore. (v) Deklaratë noteriale nr. {***}/{***} rep./kol., datë 23.06.2022, në të cilën subjekti dhe familjarët e tij deklarojnë se nuk kanë pretendime pronësie mbi banesën njëkatëshe dhe *tërhiqen nga legalizimi i kësaj banese në emrin e tyre*. Procesi i legalizimit të kësaj banese të vazhdojë në emër të shtetasit I. L., si pronar i kësaj pasurie të ndërtuar në vitin 2015.

⁵¹ Komisioni, në vendimin e tij ka vlerësuar se të ardhurat e deklaruara nga subjekti të marra paradhënie, 49. [...] të përfshihen në analizë financiare, pavarësisht faktit se mbetet e dyshimtë se si është marrë një shumë e konsiderueshme të hollash, pa një dokument provues. Ky vlerësim i Komisionit mbështetet në faktin se subjekti provoi me dokumentacion të kohës, se i ka deklaruar këto të ardhura si burim në transaksionet pranë institucioneve bankare, si dhe përfshirja e shumës 50.000 euro nuk ndikon në rezultatin përfundimtar të analizës financiare të subjektit. Trupi gjykues, në konsideratë të faktit se subjekti e ka shkak ankimor, duke e lidhur vetëm me paragjykimin e çështjes dhe nuk ka argumente të tjera për të shtuar, vlerëson se arsyetimi i mësipërm i Komisionit, nuk duket se ka nuanca paragjykimi të çështjes dhe vjen në zbatim të nenit 45, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Komisioni, në vlerësim të deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit, ka shqyrtuar të gjithë skenarët e mundshëm të situatës financiare të tij, nga të cilët i ka rezultuar se, në çdo rast, përfshirja e shumës 50.000 euro, nuk ndikon në rezultatin përfundimtar të analizës financiare të subjektit. Ky qëndrim është në përputhje edhe me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit për të aplikuar çdo skenar të mundshëm garantist, me qëllimin përmbushjen e detyrimit ligjor për të vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e kontrollit të pasurive. Në përgjigje të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vlerëson se alternativa e konsideruar nga Komisioni, në të cilën paralelisht ka arsyetuar edhe mbi rezervat e tij në raport me marrjen në konsideratë të kësaj shume, nuk çmohet se bie ndesh me ndonjë parashikim kushtetues apo ligjor në fuqi, dhe nuk demonstroi as paragjykim të trupit gjykues të Komisionit apo paracaktim të vendimit.

24.2.10 Trupi gjykues, në analizë të vendimit, ndryshe nga sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, konstaton se Komisioni ka arsyetuar dhe ka mbajtur qëndrim mbi aktet e sjella nga subjekti, duke e çmuar vlerën e tyre provuese të kufizuar, për sa kohë nuk shoqërohen me dokumentacion justifikues. Komisioni ka arsyetuar gjithashtu se veprimet e subjektit të rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, duke bërë një deklaratë për t'u tërhequr nga legalizimi i banesës, tregojnë se subjekti ka pasur ligjërisht të drejta reale mbi këtë banesë, si në momentin e deklarimit në deklaratën *vetting*, ashtu edhe gjatë procesit të rivlerësimit, të cilat i ka mohuar duke pretenduar se banesa ishte ndërtuar nga z. I. L. Për sa konstatuar më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se Komisioni, ndonëse nuk i ka referuar në mënyrë analitike aktet, i ka analizuar dhe vlerësuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe ka mbajtur qëndrim në raport me to. Bazuar edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, deklaratat noteriale të sjella nga subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore, janë akte të cilat merren me rezervë në këtë proces, pasi të krijojnë bindjen se janë konceptuar në favor të deklarimeve të vetë subjektit të rivlerësimit.

24.2.11 Nga aktet në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues nuk konstaton asnjë dokument që provon se ky ndërtim është kryer nga z. I. L. apo që përdoret prej tij ose familjarët e tij. Parcela në të cilën është ndërtuar shtëpia e vetëdeklaruar për legalizim nga babai i subjektit të rivlerësimit nuk është e njëjta parcelë, me atë shitur z. I. L., me kontratën nr. {***}/{***} rep./kol., datë 16.06.2017. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratën e interesave privatë 2014, që banesa 2 (dy) kate + papafingo në Kodër - Kamëz, Tiranë është marrë në posedim nga z. L. që në këtë vit. Në kohën që pretendohet se banesa njëkatëshe në Kodër - Kamëz posedohej nga z. L. që në vitin 2014, ky i fundit nuk kishte asnjë arsye të kontaktonte babain e subjektit për t'i kërkuar të kryente aplikimin për legalizimin e kësaj pasurie në vitin 2015, i cili ka qenë i verbër në atë kohë, dhe për më tepër të shënonte në formular numrin e kontaktit të subjektit të rivlerësimit. Për gjithë sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues nuk i gjen bindëse dhe të provuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit për këtë pasuri.

24.2.12 Për rrjedhojë, lidhur me pasurinë “banesë me sipërfaqe 370.15 m²” të pretenduar të ndërtuar nga z. I. L., në Kodër - Kamëz, Tiranë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit e ka fshehur këtë pasuri, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

Për pasuritë “apartament banimi me sipërfaqe 128.1 m²” dhe “garazh me sipërfaqe 45 m²”, në rrugën “{*}”, Tiranë**

25. Në lidhje me pasurinë “apartament”, Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 221.845,46 lekë për të paguar këstin e apartamentit prej 5.000 euro, në shumën 170.173,87 lekë për të krijuar gjendjen *cash* në vitin 2006, dhe në shumën 179.415,75 lekë për vitin 2008; në shumën 349.589,62 lekë për shlyerjen pjesore të kredisë në vitin 2008; në shumën 817.949,56 lekë për shlyerjen pjesore të kredisë në vitin 2011.

Në lidhje me pasurinë “garazh”, Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën (-) 918.844,04 lekë, si dhe nuk provoi burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve për dhënien e shumës 4.000 euro.

Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këto pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

25.1. Kundër konkluzioneve të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka ngritur këto pretendime: Subjekti i rivlerësimit në shkaqet e ankimit kundërshton konkluzionet e Komisionit në vendim për këto pasuri, duke pretenduar se⁵²: (i) Detyrimi prej 13.127 euro ndaj shoqërisë “{***}” ShPK ka mbetur pa u shlyer jo për shkaqe që lidhen me aftësinë paguese të kësaj shume, por për shkaqe ligjore dhe objektive që nuk varen prej tij. Konkluzioni i Komisionit në paragrafin 79 të vendimit është i gabuar, pasi nuk i ka kaluar barra e provës. (ii) Komisioni nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat nga toka bujqësore, mospërfshirja e të cilave në analizë ka ndikuar në pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar nga Komisioni në vitet 2006, 2008. Nëse në analizë përfshihen të ardhurat nga toka bujqësore, subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e gjendjes *cash*. (iii) Në analizën financiare për shlyerjen e kështit të kredisë 7.256 euro, në vitin 2011, duhet të përfshihen të ardhurat nga tokat bujqësore, deklaruar në deklaratën periodike të këtij viti, në shumën 530.000 lekë. Analiza financiare duhet të bëhet për të gjithë vitin 2011 dhe jo në datat e pagesës, pasi subjekti ka pasur gjendje *cash* në fund të vitit 2010, duke i përdorur në momentin e kryerjes së transaksionit, dhe me të ardhurat nga pagat e prodhimet bujqësore i ka zëvendësuar deri në fund të vitit. Diferenca negative e rezultuar, nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk përbën shkak për marrjen e masës disiplinore. (iv) Analiza financiare për blerjen e garazhit duhet të bëhet për të gjithë vitin 2013 dhe jo në datën e blerjes së tij, sepse subjekti ka pasur gjendje të likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2012, duke i përdorur në momentin e blerjes së garazhit, dhe i ka zëvendësuar deri në fund të vitit me të ardhurat nga pagat dhe prodhimet bujqësore, duke mos pasur kështu ndryshim në gjendjen *cash* për vitin 2013. Në analizën financiare duhen marrë në konsideratë të ardhurat e huas nga babai, në shumën 4.000 euro.

25.2. Nga analizimi i akteve në fashikullin gjyqësor të Komisionit lidhur me pasuritë më sipër, trupi gjykues konstaton sa vijon:

25.2.1 Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar këto dy pasuri si në vijim:

*(1) Apartament banimi me sipërfaqe 128.1 m², lidhur kontratë sipërmarrje nr. {***}/{***} rep./kol., datë 23.06.2008, me firmën “{***}” ShPK, rruga “{***}”, Tiranë. Vlera 94.830 euro. Pjesa takuese 50%. Si burimi të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit deklaron: (i) kredi në NBG Bank, 46.000 euro, më datë 29.07.2008, dhe (ii) të ardhurat ndër vite përfshirë edhe marrjen paradhënie të shumës 50,000 euro, për shitjen e banesës në Kodër - Kamëz. Kredia shlyer përfundimisht më datë 07.11.2014, me të ardhurat ndër vite dhe një pjesë nga shuma e sipërcituar e marrë paradhënie për shitjen e banesës në Kodër - Kamëz. Deklaron gjithashtu: “Detyrim i palikuiduar ndaj firmës ‘{***}’, në vlerën 13.915 euro”.*

Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit deklaroi lidhjen e kontratës së sipërmarrjes dhe kredisë e marrë, si më sipër. Në seksionin “Detyrimet financiare [...]” të kësaj deklarate shkruan: *1) [...] detyrimi i mbetur ndaj NBG Albania ShA, 45.684 euro. 2) Detyrim i mbetur për blerje apartamenti ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, më 31.12.2008, në shumën 48,830 euro.*

⁵² Subjekti i rivlerësimit ngre në ankim pretendime lidhur me saktësimin e sipërfaqes së apartamentit dhe verandës objekt shqyrtimi. Trupi gjykues, në analizë të vendimit të ankimuar, konstaton se Komisioni ka vlerësuar se subjekti arriti të provojë me dokumentacion justifikues, konkretisht me shkresën nr. {***} prot., datë 30.05.2022, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Veri, se sipërfaqja 120.4 m² përfshin edhe sipërfaqen e verandës. Në këto rrethana, trupi gjykues vlerëson të ndalet në vazhdim mbi shkaqet e tjera të ankimit.

(2) *Garazh me sipërfaqe 45 m², lidhur me kontratë premtim shitje nr. {***/{***} rep./kol., datë 13.04.2013, në rrugën “{***}”, me shtetasin A. R. Vlera 11.000 euro. Pjesa takuese 50%. Burimi i krijimit: (i) të ardhurat ndër vite, dhe (ii) marrë hua babait 4.000 euro. Detyrim i palikuiduar në vlerën 1.000 euro.*

Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri si më sipër. Shumën e shlyer e deklaroi në vlerën 10.000 euro. Mbetur pa u shlyer: 1.000 euro.

(1) Lidhur me pasurinë “apartament banimi⁵³ me sipërfaqe 128.1 m²”, në rrugën “{*}”, Tiranë**

25.3 Referuar kontratës së sipërmarrjes nr. {***/{***} rep./kol., datë 23.06.2008,⁵⁴ lidhur mes shoqërisë “{***}” ShPK dhe subjektit të rivlerësimit, me objekt porositjen e një apartamenti me sipërfaqe totale 128.1 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, kundrejt çmimit 94.830 euro, pagesa parashikohet të kryhej si më poshtë: (1) *Kësti i parë, 50.000 euro, do të shlyhet nga porositësi brenda muajit korrik 2008.* (2) *Kësti i dytë, 20.000 euro, do të shlyhet brenda muajit nëntor 2008.* (3) *Kësti i tretë, 15.000 euro, do të shlyhet brenda muajit mars 2009.* (4) *Kësti i katërt, 9.830 euro, do të shlyhet në momentin e dorëzimit faktik të apartamentit.*

25.4 Me shkresën e datës 14.07.2017, shoqëria “{***}” ShPK ka informuar ILDKPKI-në⁵⁵ mbi pagesat që subjekti i rivlerësimit ka kryer për likuidimin e çmimit të apartamentit me kontratën e sipërmarrjes, nga e cila rezulton se, deri në plotësimin e deklaratës së pasurisë *vetting*, subjekti ka likuiduar shumën 80.883 euro. Në deklaratën e interesave privatë 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka shlyer edhe shumën 788 euro. Pra, nga sa sipër, rezulton që subjekti të ketë shlyer deri në fund të vitit 2017, vlerën 81.621 euro nga çmimi 94.830 euro i apartamentit.

25.5 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka mbetur pa shlyer detyrimi prej 13.127 euro ndaj shoqërisë sipërmarrëse, konfirmuar edhe me vërtetimin e datës 28.01.2020, lëshuar nga shoqëria “{***}” ShPK. Ky detyrim ka mbetur i pashlyer edhe pas regjistrimit të kësaj banese në AShK, më datë 27.10.2020,⁵⁶ situatë e cila konfirmohet në vijim me vërtetimin e datës 31.01.2022, të lëshuar nga administratori i shoqërisë, depozituar nga subjekti me përgjigjet e datës 13.01.2022, të pyetësorit nr. 2.

⁵³ Subjekti ka depozituar: (i) Kontratë sipërmarrje nr. {***/{***} rep./kol., datë 23.06.2008; (ii) Kontratë kredie nr. {***/{***} rep./kol., datë 29.07.2008; (iii) Vërtetim lëshuar nga NBG Bank ShA, datë 22.01.2015; (iv) Deklaratë e thjeshtë dore (olografë), datë 01.10.2014, mes shtetasit I. L. dhe Arben Sharra, për shumën e dhënë 20.000 euro, si paradhënie për blerjen e banesës në Kodër - Kamëz, Tiranë; (v) Deklaratë e thjeshtë ndërmjet I. L. dhe Arben Sharra, për shumën e dhënë 30.000 euro, si paradhënie për blerjen e banesës në Kodër - Kamëz, Tiranë; (vi) Vërtetim, i datës 24.01.2017, i shoqërisë “{***}” ShPK.

⁵⁴ Kontrata e sipërmarrjes është depozituar nga subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur deklaratës *vetting*.

⁵⁵ Shkresë bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*. Në datën 01.08.2008, në NBG Bank ShA është paguar shuma 46.000 euro. Subjekti rezulton të ketë deklaruar shlyerjen e kësaj shume në deklaratën e interesave privatë 2008. Në datën 19.10.2012, me mandat arkëtimi pa numër, është paguar shuma 5.000 euro. Subjekti rezulton të ketë deklaruar shlyerjen e kësaj shume në deklaratën periodike të vitit 2012. Në datën 31.05.2013, me mandatin nr. {***}, është paguar shuma 4.285 euro. Subjekti rezulton të ketë deklaruar shlyerjen e kësaj shume në deklaratën periodike të vitit 2013. Në datën 19.06.2015, nëpërmjet sistemit bankar, në Union Bank, është paguar shuma 24.400 euro, në të cilën si burim i saj është deklaruar marrë paradhënie nga marrëveshja verbale për shitjen e banesës në Kodër - Kamëz, Tiranë. Në datën 13.11.2015, me mandatin nr. {***}, është paguar shuma 230 euro. Në datën 30.12.2015, në Intesa Sanpaolo Bank ShA është paguar shuma 5.000 euro. Subjekti rezulton të ketë deklaruar shlyerjen e 29.630 euro në deklaratën periodike të vitit 2015, nëpërmjet shumës së marrë paradhënie për shitjen e banesës në Kodër - Kamëz, Tiranë.

⁵⁶ Referuar shkresës së AShK-së, nr. {***} prot., datë 18.10.2021.

25.6 Në rrethanat e konstatuara më sipër, Komisioni nuk e ka pasur të qartë se pse ka mbetur i pashlyer akoma ky detyrim, për sa kohë apartamenti ka qenë i regjistruar në AShK në emër të subjektit dhe ligjërisht nuk duhet të kishte asnjë detyrim ndaj shoqërisë “{***}” ShPK për këtë pasuri, për më tepër që kontrata e sipërmarrjes është lidhur në vitin 2008, dhe ende, pas gati 14 vitesh, subjekti nuk e ka shlyer vlerën e plotë të apartamentit.

25.7 Në kuadër të verifikimit të mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për të paguar me të ardhura të ligjshme këstet për blerjen e apartamentit, Komisioni kreu analizën financiare pa konsideruar të ardhurat e pretenduara nga shfrytëzimi i tokës bujqësore. Rezultatet e kësaj analize treguan mungesë burimesh financiare të ligjshme të subjektit për të krijuar gjendjen *cash*, përkatësisht për vitin 2006 në vlerën 208.566,87 lekë dhe për vitin 2008 në vlerën 251.717,75 lekë, mungesë në shumën 460.444,62 lekë për shlyerjen pjesore të kredisë në vitin 2008, mungesë në shumën 817.949,56 lekë për shlyerjen pjesore të kredisë në vitin 2011, si dhe mungesë në vlerën 231.470,46 lekë për të paguar këstin e apartamentit në vlerën 5.000 euro, në vitin 2012. Ndërkohë që Komisioni e ka vlerësuar të paqartë situatën pse subjekti ka mbetur pa shlyer shumën 13.127 euro ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, për sa kohë legalizimi dhe regjistrimi i pasurisë është kryer në emër të tij dhe jo të shoqërisë. Në përfundim të hetimit në lidhje me këtë pasuri, për sa më sipër, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës.

25.8 Në shpjegimet e dhëna mbi këto rezultate, subjekti i rivlerësimit⁵⁷ ka prapësuar se Komisioni ka kryer analizën financiare duke përfshirë në kursim vetëm *cash*, të krijuar nga të ardhura të tjera, të ndryshme nga të ardhurat bujqësore. Nëse në analizën financiare përfshihen të ardhurat nga toka bujqësore, të cilat janë reale, të provuara dhe të deklaruara rregullisht në DPV-të vjetore, rezulton qartësisht se ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e gjendjes *cash*, duke ndryshuar pozitivisht edhe balancat për vitet 2006 dhe 2008. Analiza financiare sipas subjekti, për pagesat e kryera për shlyerjen e kredisë në vitin 2011, në shumën 7.256 euro, duhet të bëhet për të gjithë vitin 2011 dhe jo në datat e pagesës, sepse ka pasur gjendje të likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2010, duke i përdorur në momentin e kryerjes se transaksionit, dhe me të ardhurat nga pagat e prodhimet bujqësore i ka zëvendësuar deri në fund të vitit. Sipas subjektit të rivlerësimit, në fund të vitit 2011, rezulton një bilanc negativ në shumën 305.641 lekë, si pasojë e një pasaktësie në deklarin e ndryshimit të gjendjes së likuiditeteve *cash* në fund të këtij viti. Subjekti ka parashtruar në vijim, se detyrimi 13.127 euro ndaj shoqërisë “{***}” ShPK ka mbetur pa shlyer jo për shkaqe që lidhen me aftësinë e tij paguese, por për shkaqe ligjore dhe objektive, që nuk varen prej tij. Llogaritë bankare të shoqërisë “{***}” ShPK janë të bllokuara, pasi kjo shoqëri ndodhet në një proces gjyqësor civil në Gjykatën e Lartë dhe, si rrjedhojë e këtij fakti, shoqëria i ka kërkuar të mos e kryejë shlyerjen e detyrimit të mbetur deri në përfundimin e gjykimit të kësaj çështjeje dhe çlirimin e llogarive bankare të shoqërisë, nga çdo lloj barre.

25.9 Në analizë të fakteve dhe rrethanave të pretenduara nga subjekti, Komisioni korrigjoi analizën financiare në lidhje me: (1) pagat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, duke iu referuar pagave të përfituara nga nxjerrja e llogarisë dhe jo nga vërtetimet e depozituara nga vetë subjekti; (2) nuk mori në konsideratë të ardhurat nga toka bujqësore; (3) nuk mori në konsideratë

⁵⁷ Subjekti ka depozituar: Raport vlerësimi 10.06.2022, për llogaritjen e të ardhurave nga prodhimi i pemëve të mbjella, si dhe të ardhurat nga blegtoria; Deklaratë noteriale nr. {***}/{***} rep./kol., datë 30.05.2022, në të cilën shpjegon arsyet e moslikuidimit të shumës së mbetur, të shtetasit Dh. T.; Deklaratë noteriale nr. {***}/{***} rep./kol., datë 30.05.2022, të shtetasit Dh. T., ku deklaron saktësimin e sipërfaqeve.

pretendimin mbi pakësimin e gjendjes *cash* në vitin 2011, për sa kohë nuk është deklaruar në deklaratën e interesave privatë 2011, si dhe (4) nuk mori në konsideratë pretendimin e subjektit për kryerjen e analizës financiare për të gjithë vitin 2011. Komisioni, edhe pas korrigjimit të analizës financiare, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

25.10 Trupi gjykues, në analizë të shkaqeve të ankimit, konstaton dhe vlerëson si vijon:

25.10.1 Pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi konsiderimin e të ardhurave nga produktet bujqësore dhe mbulimin e shpenzimeve jetike nga këto të ardhura, trupi gjykues i ka trajtuar dhe ka mbajtur qëndrim për to në paragrafin 23.2.21 të këtij vendimi, në analizë të shkakut ankimor lidhur me pasurinë “banesë 2 (dy) kate + papafingo”, në Kodër - Kamëz, Tiranë. Për sa arsyetuar gjerësisht në këtë vendim, trupi gjykues e çmon të drejtë qëndrimin e Komisionit për mospërfshirjen e të ardhurave të pretenduara nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral, në analizën financiare.

25.10.2 Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit sa i përket balancave negative të rezultuara nga analiza financiare e Komisionit në vendim, për vitin 2006 në shumën 170.173,87 lekë dhe për vitin 2008 në shumën 179.415,75 lekë, trupi gjykues kontrollon, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, analizën financiare për këto vite, rezultatet e së cilës konfirmuan balancat negative të konstatuara nga Komisioni. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me të ardhura të ligjshme, shpenzimet e kryera dhe gjendjen *cash* të deklaruar në këto vite, duke rezultuar kështu në pamundësi financiare edhe për likuidimin pjesor të kredisë në NBG Bank ShA, në vitin 2009⁵⁸, me burim këto kursime.

25.10.3 Lidhur me pretendimet e subjektit, *se bilanci negativ, në fund të vitit 2011, rezulton si pasojë e një pasaktësie në pakësimin e gjendjes cash, në fund të këtij viti*, në dritën edhe të jurisprudencës orientuese të Kolegjit,⁵⁹ trupi gjykues vlerëson të mos prezumojë përdorimin nga subjekti i rivlerësimit të gjendjes *cash*, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit, në deklaratat periodike. Në kushtet kur shpjegimet mbi gjendjen e likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar, bien ndesh me deklaratimet e vetë subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave privatë, të cilat konsiderohen provë në procesin e rivlerësimit⁶⁰ dhe, së bashku me deklaratën e pasurisë *vetting*, përbëjnë të vetmen mënyrë verifikimi të ekzistencës së kësaj pasurie në funksion të këtij procesi, pretendimet e subjektit, sa i përket dinamikës së përdorimit të tyre, mbetën në nivel deklarativ.

25.10.4 Për pretendimin e subjektit, *se analiza financiare për burimin e të ardhurave, për pagesat për shlyerjen e kredisë, duhet të bëhet për të gjithë vitin 2011 dhe jo në datat e pagesës*, trupi gjykues, në konsideratë të jurisprudencës⁶¹ së Kolegjit dhe legjislacionit të zbatueshëm, vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Në zbatim të shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016 dhe udhëzimit nr. {40/95 prot.}, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, subjektet kanë detyrimin e provimit të burimit të krijimit të pasurive në momentin që ato krijohen. Me këtë logjikë, verifikimi i mundësisë financiare për shlyerjen e kësteve të kredisë për vitin 2011, është bërë në datat e likuidimit të tyre, pasi të ardhurat

⁵⁸ Nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë së kredisë në NBG Albania ShA, rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë bërë shlyerje pjesore të kredisë më datë 28.05.2009, në shumën 15.000 euro, me burim pakësime në vlerën 2.000.000 lekë nga kursimet e bëra deri më datë 31.12.2008, sipas deklaratimit të tij, në deklaratën e interesave privatë të vitit 2009.

⁵⁹ Shih vendimin orientues nr. 7/2019 (JR) të Kolegjit, që i përket subjektit të rivlerësimit E. S.

⁶⁰ Në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

⁶¹ Vendim nr. 2/2023 (JR), datë 02.02.2023.

e realizuara pas datës së pagesës, nuk mund të kenë shërbyer si burim për të apo mbulimin e shpenzimeve të tjera të kryera deri në datat e pagesave.

25.10.5 Në vijim të arsyetimit më sipër, trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrollon analizën financiare të Komisionit, sa i përket verifikimit të mundësisë financiare të subjektit, për të justifikuar me të ardhura të ligjshme, pagesën e kredisë në shumën 7.256 euro në vitin 2011⁶², rezultatet e të cilës konfirmuan balancën negative të konstatuar nga Komisioni në vendim për këtë vit. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me të ardhura të ligjshme, likuidimin e kredisë në NBG Bank ShA, në vitin 2011.

25.10.6 Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, që Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove për konkluzionin në vendimin e tij, se *mospagimi i shumës 13.127 euro për shkak të bllokimit të llogarisë bankare të shoqërisë “{***}” ShPK, duhet të jetë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave [...], pasi subjekti duket se, së paku në mënyrë indirekte, mund të ketë ndihmuar këtë shoqëri për të mos deklaruar të ardhurat e saj reale, duke u bërë pengesë për mosekzekutimin e veprimeve përmbartimore [...]*, trupi gjykues, në analizë të rezultateve të hetimit dhe vendimit të Komisionit, vëren se përfundimi më sipër është arritur pasi subjekti i ka kaluar barra e provës mbi këtë rrethanë, në vlerësim përfundimtar të prapësimeve të paraqitura nga subjekti kundër barrës së provës. Për këto arsye, edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit vlerësohet nga trupi gjykues, i pabazuar.

25.10.7 Në përfundim, trupit gjykues i rezulton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë “apartament”, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

(2) Për pasurinë “garazh me sipërfaqe 45 m²”, ndodhur në rrugën “{*}”, Tiranë**

25.11 Në kontratë premtim shitje nr. {***}/{***} rep./kol., datë 13.04.2013⁶³, mes palës premtuese të shitjes, A. R. dhe palës premtuese të blerjes, Arben Sharra, me objekt: *Transferimin nëpërmjet shitjes të garazhit në katin (-) 1, me sipërfaqe 45 m², të ndërtuar nga shoqëria “{***}” ShPK, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, në nenin 3 të saj, çmimi i shitjes përcaktohet në vlerën 11.000 euro, ndërsa për mënyrën e likuidimit parashikohet: Pala premtuese ka likuiduar më parë shumën 10.000 euro, jashtë zyrës noteriale, dhe pjesa e mbetur, në shumën 1.000 euro, do të likuidohet me regjistrimin e garazhit në ZVRPP, nga pala shitëse.*

25.11.1 Në përgjigjet e datës 07.10.2021 të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se, në vitin 2013, ka marrë hua shumën 4.000 euro nga babai dhe në vitin 2017 ka marrë hua shumën 2.000 euro nga nëna. Huat janë marrë dorazi, pa akt noterial, bazuar në marrëdhënien prind - fëmijë. Burimi i të ardhurave për këto hua kanë qenë kursimet e prindërve. Për të provuar sa deklaron, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur me përgjigjet e pyetësorit nr. 1, deklaratën noteriale nr. {***}/{***} rep./kol., datë 20.10.2021, në të cilën H. Sh., nëna e subjektit, ndër të tjera, deklaron: *Djali i saj, Arben Sharra, i ka kërkuar b/shortit në vitin 2013 dhe në vitin 2017, shuma parash në formë huaje, për shkak se ishte në pamundësi financiare në atë periudhë, të cilat do t'i kthente sipas mundësive në vitet më vonë. Në vitin 2013, b/shorti i ka dhënë shumën 4.000 euro [...], ndërsa në vitin 2017, pas vdekjes së b/shortit, i kam dhënë edhe një shumë tjetër, prej 2.000 eurosh. Këto shuma ia kemi dhënë pa ndonjë*

⁶² Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të të ardhurave të përdorura për shlyerjen e kredisë në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë 2011.

⁶³ Kontratë premtim shitje është depozituar nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur deklaratës vetting.

dokument, për shkak të marrëdhënies prind – fëmijë, duke mos e parë të nevojshme për arsye besimi⁶⁴. [...]. Për huan e marrë prej b/shortit në vitin 2013, në shumën 4.000 euro, pas vdekjes së b/shortit, edhe pse Arbeni ka insistuar disa herë për të ma kthyer atë shumë, [...], ajo nuk e ka pranuar.

25.11.2 Nga analiza financiare, lidhur me burimet e deklaruara për këtë pasuri, Komisionit i ka rezultuar se babai i subjektit nuk kishte mundësi për dhënien hua të shumës 4.000 euro, në vitin 2013 dhe, për rrjedhojë, kjo shumë nuk është përfshirë në analizën financiare. Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në kushtet kur nga analiza financiare rezultoi me mungesë të të ardhurave financiare të ligjshme në shumën 918.844,04 lekë, për të blerë pasurinë “garazh”.

25.11.3 Në shpjegimet e dhëna për këto rezultate hetimi, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se: (i) Komisioni, në analizën financiare ka konsideruar vetëm të ardhurat e tre muajve të parë të vitit 2013 nga pensionet e prindërve të tij, duke mos marrë në analizë asnjë periudhë tjetër të mëparshme. Nga viti 2007, në të cilin është bërë shpenzimi i fundit i tyre për blerjen e një pasurie deri në vitin 2013, kur është dhënë kjo hua, ata rezultojnë me një bilanc pozitiv në vlerën 781.008 lekë, rreth 223.000 lekë më e lartë se shuma 4.000 euro e dhënë hua. (ii) Referuar informacionit të përcjellë në Komision nga Raiffeisen Bank ShA, me shkresën nr. {***} prot., datë 21.01.2020, rezulton që babai i subjektit të rivlerësimit të ketë depozituar, në datën 22.08.2007, vlerën 100.000 USD, e cila është tërhequr pas rreth 1 (një) viti, në vitin 2008. Në momentin e maturimit të depozitës, babai ka përfituar interesa në vlerën totale 4.981 USD, e cila, e konvertuar me kursin e vitit 2013, rezulton në shumën 3.835 euro. (iii) Subjekti pretendon se analiza financiare për verifikimin e ligjshmërisë së burimeve për blerjen e garazhit, duhet të bëhet për të gjithë vitin 2013 dhe jo në datën e blerjes së garazhit, pasi ka pasur gjendje të likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2012, të cilat i ka përdorur në momentin e blerjes së garazhit dhe i ka zëvendësuar deri në fund të vitit, duke mos pasur kështu ndryshim në gjendjen e likuiditeteve *cash*, në fund të vitit 2013.

25.11.4 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, vlerësoi se ato nuk janë bindëse, pasi: (i) *Në lidhje me huan në shumën 4.000 euro, subjekti nuk ka provuar me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve të tij. Komisioni konstaton se, edhe sikur kjo shumë të përfshihet në analizë financiare, ajo nuk e ndryshon rezultatin negativ.* (ii) *Në lidhje me të ardhurat nga toka bujqësore, sikundër arsyetuar në vendim, ato nuk do të përfshihen në analizën financiare. Për sa i përket pretendimit të subjektit që të merret i gjithë viti kalendarik, Komisioni konstaton se, në këtë rast, pozita e tij do të rëndohej me rezultat negativ në vlerën 1.191.401,07 lekë.* Në përfundim, në lidhje me pasurinë “garazh”, Komisionit i ka rezultuar se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme dhe nuk provoi të kundërtën e barrës së provës.

25.11.5 Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se analiza financiare për burimin e të ardhurave për blerjen e garazhit, duhet të bëhet për të gjithë vitin 2013 dhe jo në datën e blerjes së garazhit, trupi gjykues, sikurse ka arsyetuar edhe më lart në këtë vendim, vlerëson se Kolegji ka jurisprudencë të konsoliduar në vlerësim të pretendimeve të palëve, lidhur me metodologjinë e përdorur në kryerjen e analizës ekonomiko-financiare për subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur, të shqyrtimit të provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në drejtim të përcaktimit të të ardhurave, shpenzimeve dhe investimeve të tyre, në datën që ato janë kryer, pasi në atë datë janë

⁶⁴ *Huan në shumën 2.000 euro [...] ma ka kthyer të gjithën në dy kështe. Në vitin 2018, më ka kthyer shumën 500 euro dhe në vitin 2019, më ka kthyer edhe pjesën e mbetur prej 1.500 eurosh.*

ekzekutuar transaksionet financiare, me efekt në gjendjen e likuiditeteve.

25.11.6 Lidhur me pretendimin e subjektit, *se në analizën financiare duhen marrë në konsideratë të ardhurat nga huaja në shumën 4.000 euro*, trupi gjykues konstaton se Komisioni, me të drejtë, ka përfshirë në analizë vetëm ato të ardhura, të cilat janë vërtetuar me dokumentacion provues dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, qëndrim i mbajtur ky edhe në jurisprudencën e Kolegjit. Trupi gjykues vlerëson se, bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk provoi mundësinë e babait për të dhënë huan në shumën 4.000 euro me burim kursimet e tij ndër vite⁶⁵ apo si interesa të pretenduara nga depozita prej 100.000 USD, në emër të babait të tij. Për sa kohë nuk u dokumentua përfitimi i shumës 100.000 USD nga burime të ligjshme, sikurse do trajtohet në vijim në këtë vendim, për rrjedhojë, edhe interesat e përfituar nga investimi i kësaj shume në depozitë, më datë 22.08.2007, të pretenduara si burim për huan e dhënë subjektit, nuk u konsideruan të ligjshme dhe, për këtë arsye, nuk u përfshinë në analizën financiare të vitit 2013. Në këto kushte, nuk gjendet i bazuar as pretendimi i subjektit se huaja e ka burimin nga interesat e depozitës.

25.11.7 Për sa vlerësuar më sipër, trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrollloi analizën financiare të kryer në Komision, nga rezultatet e të cilës mbetet e konfirmuar diferenca negative e konstatuar nga Komisioni në vendim. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me të ardhura të ligjshme krijimin e pasurisë “garazh”, në datën 13.04.2013.

25.11.8 Në rrethanat faktike si më sipër, për pasuritë e paluajtshme “apartament banimi me sipërfaqe 128.1 m²” dhe “garazh me sipërfaqe 45 m²”, në rrugën “{***}”, Tiranë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Për pasurinë “banesë në emër të prindërve”, në fshatin Shëngjergj

26. Komisioni në vendim për këtë pasuri ka konkluduar se subjekti ka kryer fshehje të pasurisë, në kuptim të nenit 33/5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.
27. Subjekti i rivlerësimit kundërshton në ankim dhe parashtrime konkluzionin më sipër, duke ngritur pretendimin se nuk ka kryer fshehje të pasurisë dhe se konkluzioni i Komisionit në vendim është tërësisht abuziv, tregon paragjykim të çështjes dhe, si rrjedhojë, është i pabazuar.
28. Në përgjigje të këtyre pretendimeve, pas analizimit të akteve në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.

28.1 Njësia Administrative Shëngjergj, me shkresën nr. {***} prot., datë 19.10.2021, ka informuar Komisionin se subjekti i rivlerësimit ka paguar taksën vendore për tokën bujqësore, si dhe taksën për një ndërtesë, për të cilën OShEE-ja konfirmon kontratën e furnizimit me energji elektrike në emër të babait të subjektit të rivlerësimit.

28.2 Në përgjigjet e datës 13.01.2022, të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se banesa për të cilën ka paguar taksë pranë kësaj njësie, është banesa e vjetër e gjyshërve dhe e prindërve të tij. Këtë taksë, subjekti ka qenë i detyruar për ta paguar, pasi si taksa e tokës bujqësore në përdorim të

⁶⁵ Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, në analizën financiare të audituesit ligjor, për mundësinë e blerjes së këtij apartamenti dhe dhënies se huas në shumën 4.000 euro, ka deklaruar ndër të tjera edhe të ardhurat nga interesat bankarë në vitin 2007, të cilat janë tërhequr në vitin 2010.

tij, ashtu edhe taksa e ndërtesës bëheshin në të njëjtin mandat. Banesa është ndërtuar rreth vitit 1964, nga gjyshërit, xhaxhai dhe babai i tij. Ajo është një shtëpi dykatëshe, e ndarë në dy pjesë, ku gjysma e saj i është dhënë xhaxhait, të ndjerit R. Sh., dhe pjesa tjetër babait të tij, të ndjerit S. Sh. Kjo banesë nuk është poseduar prej tij dhe, ashtu siç ka shpjeguar në përgjigje të pyetësorit nr. 1, në tokën bujqësore që ka në posedim, nuk ka ndërtim. Shtëpia e vjetër është jashtë gjurmës së tokës bujqësore, pasi është ndërtuar shumë vite përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7501/1991 dhe ndarjes së tokës bujqësore sipas këtij ligji.

28.3 Për të provuar sa pretendon, subjekti ka depozituar në Komision këto akte: (1) Deklaratë noteriale nr. {***}/{***} rep./kol., datë 31.01.2022 të znj. H. Sh., e cila deklaron se: [...] *Në vitin 1964, vjehrra ime, F. Sh., vendosi që të ngrinin një shtëpi të re [...] Gjysmën e shtëpisë ia la bashkëshortit tim, S. dhe gjysmën tjetër ia la kunatit tim, R. Edhe sot e kësaj dite, në këtë banesë, në të njëjtin kullm si dikur, jeton djali i R., I., së bashku me familjen e tij. Banesa, aktualisht, është po e njëjta shtëpi e dikurshme dykatëshe, por e riparuar ndër vite si nga I., ashtu edhe nga unë.* (2) Vërtetim të Njesisë Administrative Shëngjergj nr. {***} prot., datë 31.01.2022, me të cilin vërtetohet se babai i subjektit të rivlerësimit ka një banesë ekzistuese në fshatin Shëngjin i Madh të Njesisë Administrative Shëngjergj, të ndërtuar para vitit 1990, të ndodhur në ZK {***}, me numër pasurie {***}. [...]. (3) Vërtetim të Bashkisë Tiranë nr. {***} prot., datë 26.01.2022, sipas së cilit subjekti i rivlerësimit është regjistruar vetëm për pronën “tokë arë” me sipërfaqe 5240 m². (4) Fotografi të kësaj banese, nga të cilat konstatohet se ajo është e rikonstruktuar.

28.4 Nga verifikimi i ortofotove digjitale në portalin ASIG të kësaj banese dhe në *Google maps*, Komisionit i ka rezultuar se banesa ndodhet në parcelën numër {***}, z. k. {***}, ngjitur me tokën bujqësore në posedim të subjektit të rivlerësimit. Nga të dhënat e administruara nga sistemi i AShK-së ka rezultuar që parcela me nr. {***} është e regjistruar si *pemëtore* me sipërfaqe 1356 m², ndërsa pasuria me numër {***}, është regjistruar si *truall* me sipërfaqe 300 m². Nga pamjet në *Google maps* duket se, përveç banesës në truallin me sipërfaqe 300 m², ndodhen edhe disa ndërtime të tjera. Toka bujqësore dhe ndërtimet rreth banesës duket se kanë pësuar ndryshime me kalimin e viteve, pasi në vitin 2015 ka ndryshim të sipërfaqes së ndërtimit dhe të tokës bujqësore. Në vitin 2015 është hapur edhe rruga, e cila në vitin 2007, nuk ka qenë. Në vitin 2022, evidentohen sërish ndryshime në të gjithë sipërfaqen e pasurisë.

28.5 I pyetur nga Komisioni për këto konstatime, në përgjigje të pyetësorit të datës 24.03.2022, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se objektet në krahun e poshtëm, të majtë të banesës, pjesë e sipërfaqes takuese të xhaxhait të tij të ndjerë, janë objekte ekzistuese të hershme, të cilat kanë pësuar ndryshime në formë për shkak të rinovimeve të tyre. Çdo ndryshim i dukshëm në fotografi ka të bëjë me sistemime oborri, riparime të mureve të gurit, si dhe rinovime të çatisë dhe soletës së vjetër. Të gjitha punimet janë bërë në periudha të ndryshme, në vitin 2017 e në vijim, dhe për të cilat nëna e tij, për riparimet dhe sistemimet në pjesën takuese të babait të ndjerë, ka bërë njoftimin e Njesisë Administrative Shëngjergj për kryerje punimesh që nuk kërkojnë leje ndërtimi. [...] Nuk ka dijeni se sa ka qenë kostoja totale e tyre dhe as nëna e tij nuk ka ruajtur dokumentacion provues (fatura) për koston e punimeve, pasi janë bërë në periudha të ndryshme kohore në vazhdimësi. Burimi i ligjshëm i të ardhurave për kryerjen këtyre punimeve të jashtme nga nëna e tij, në banesën e vjetër të babait, ka qenë një pjesë e shumës së marrë nga shitja e banesës në Kodër - Kamëz.

28.6 Nisur nga faktet që: 1) toka bujqësore posedohet dhe shfrytëzohet nga subjekti i rivlerësimit; 2) banesa, së bashku me ndërtimet e tjera dhe tokën bujqësore në posedim të subjektit, duket se përbën

një pasuri të vetme, në të cilën është investuar vazhdimisht; 3) nga verifikimi i bërë në sistemin e ASHK-së *online* duket se një pjesë e tokës bujqësore të pretenduar nga subjekti në posedim të tij, është e regjistruar në emër të shtetasve I. Sh., R. S. dhe Sh. T.; 4) subjekti ka refuzuar të paraqesë fotografi të plota të kësaj pasurie dhe referuar pamjeve të ASIG-ut, duket se në krahun e banesës së pretenduar në pronësi të nënës së subjektit ka ndërtime në pjesën anësore dhe ballore të saj; 5) bazuar në historikun e pagesave të energjisë elektrike konstatohet se kjo banesë është përdorur, pasi rezulton konsum i energjisë elektrike, ndërkohë që OShEE-ja ka konfirmuar se për këtë banesë kontrata është e lidhur në emër të z. S. Sh.; 6) subjekti nuk ka depozituar dokumentacion nga ASHK-ja për të provuar bashkëpronësinë e babait të tij me shtetasin I. Sh.; 7) detyrimet vendore për këtë banesë deri në vitin 2015 janë paguar nga subjekti i rivlerësimit; 8) banesa rezulton e rikonstruktuar me materiale izoluese të kohës; 9) bazuar si në deklaratimet e subjektit, ashtu edhe në dokumentacionin e administruar, rezulton që kjo banesë është në funksion të tokës bujqësore të poseduar nga vetë subjekti; 10) burimi i përdorur për rikonstruksionin e kësaj banese ka qenë shuma 75.000 euro, e përfituar nga shitja e banesës së subjektit të rivlerësimit; 11) mosha e thyer e prindërve të subjektit dhe mungesa e burimeve të ligjshme të të ardhurave për mbulimin e shpenzimeve të rikonstruksionit; 12) mosdeklarimi në deklaratën *vetting* të posedimit të tokës bujqësore, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, me dyshimin se duket se kjo banesë, së bashku me ndërtimet e tjera dhe tokën bujqësore kanë qenë në posedim të subjektit të rivlerësimit, i cili ka kryer edhe investime të vazhdueshme, e për rrjedhojë, duket se subjekti ka kryer fshehje të pasurisë, duke mos deklaruar posedimin e banesës dhe të tokës bujqësore, një pjesë e së cilës nuk përfshihet në AMTP, si dhe të investimeve të kryera ndër vite për këto pasuri.

28.7 Në shpjegimet e tij, pas kalimit të barrës së provës,⁶⁶ subjekti i rivlerësimit paraqiti kryesisht të njëjtat shpjegime me ato dhënë prej tij gjatë hetimit administrativ, duke shtuar se edhe djali i xhaxhait të tij, I. Sh., ka një kontratë aktive energjie në këtë banesë, që provon faktin se ½ i përket atij, dhe jeton gjatë gjithë kohës atje. Punimet për rinovime janë kryer nga bashkëshorti i motrës së subjektit. Subjekti i rivlerësimit ka theksuar se banesa objekt vlerësimi, e ndodhur në Njësinë Administrative Shëngjergj, nuk është në posedimin e tij.

28.8 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e depozituar nga subjekti, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni ka vlerësuar se banesa, së bashku me ndërtimet e tjera dhe tokën bujqësore në posedim të subjektit, përbën një pasuri të vetme, në të cilën është investuar vazhdimisht. Kjo banesë është brenda murit rrethues të tokës bujqësore të subjektit të rivlerësimit dhe, rrjedhimisht, pjesë përbërëse e saj. Në këto kushte, duke marrë në konsideratë: (i) faktin që kjo pasuri është rikonstruktuar me të ardhurat e përfituara nga shitja e banesës së subjektit në Kodër - Kamëz; (ii) moshën e thyer dhe pamundësinë e nënës së subjektit; (iii) refuzimin e subjektit për të dhënë shpjegime të qarta dhe të plota në lidhje me të gjitha ndërtimet e ndodhura në

⁶⁶ Subjekti ka depozituar: Aktverifikimin, sipas të cilit objekti shtrihet në z. k. {***} dhe ka numër pasurie {***}; Shkresë "Kthim përgjigje" nr. {***} prot., datë 30.05.2020, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Rurale I; Vërtetim debiti nr. {***} prot., datë 31.05.2022, të FShU-së, në lidhje me kontratën e energjisë elektrike, për banesën në Shëngjergj; Vërtetim debie nr. {***} prot., datë 31.05.2022, të FShU-së, sipas së cilës shtetasi I. Sh. ka një kontratë të hapur në Njësinë Administrative Shëngjergj, Tiranë; Shkresë "Kthim përgjigje" nr. {***} prot., datë 08.06.2022, e Njësisë Administrative Shëngjergj, sipas së cilës shtetasi I. Sh. është banor i fshatit Shëngjin të Njësisë Administrative Shëngjergj dhe së bashku me familjen e tij ka një shtëpi që ndodhet në z. k. {***}, e cila ka kulm të përbashkët me shtëpinë e shtetasit S. Sh., mure ndarëse të përbashkëta dhe ndodhet në të njëjtin truall; Shkresë "Kthim përgjigje" nr. {***} prot., datë 08.06.2022, e Njësisë Administrative Shëngjergj; Shkresë "Kthim përgjigje" nr. {***} prot., datë 08.06.2022, e Njësisë Administrative Shëngjergj; Fotografia, të cilat nuk pasqyrojnë një panoramë të qartë të kësaj pasurie.

truallin ku ndodhet kjo banesë; (iv) refuzimin e subjektit për të deklaruar vlerën e investimeve të kryera nga nëna e tij dhe për të depozituar dokumentacionin përkatës, duke qenë se koha e kryerjes së tyre është viti 2021, si dhe (v) faktin se ai është sjellë si pronar i kësaj banese, duke paguar detyrimet deri në vitin 2015, rrethuar tokën bujqësore së bashku me këtë banesë, si dhe duke hapur rrugën, Komisioni krijon bindje se kjo pasuri është në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

29. Në analizë të shkaqeve të ankimit, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit, si dhe kontrolloi arsyetimin e Komisionit në vendim, në drejtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, konstaton dhe vlerëson si vijon.

29.1 Në shkaqet e ankimit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ndërtesa për të cilën subjekti ka paguar taksë, është shtëpia e vjetër e gjyshërve dhe e prindërve të tij. Ai, padyshim, si gjithë motrat dhe vëllezërit, është pjesë e historisë së kësaj banese, ku është lindur dhe rritur. Ndryshe nga sa thotë Komisioni, subjekti pretendon se ka dërguar me fotografi të gjitha ndërtimet dhe ka fotografuar të gjitha pozicionet e mundshme të të gjithë sipërfaqes që i përket pjesës takuese të banesës në pronësi të tij. Komisioni nuk ka pasur asnjë pengesë të shkonte të bënte këqyrje në vend.

29.2 Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e datës 30.03.2022, të pyetësorit nr. 3, ka deklaruar: [...]. *Tokat bujqësore në emër të babait sipas AMTP nr. {***}, që unë i kam në posedim, ndodhen të shpërndara pjesërisht përreth banesës në fjalë dhe pjesa tjetër në një largësi më të madhe prej banesës, ashtu siç është bërë ndarja e tyre me ligjin nr. 7501/1991. Në tokën bujqësore që unë kam në posedim nga babai, investimi i vetëm i bërë është zgjerimi i rrugës që ka qenë ekzistuese më parë, sipas shpjegimeve që kam bërë në fotot e mësipërme. [...]. Për shpenzimet përkatëse për kryerjen e këtyre sistemimeve të jashtme nuk jam në dijeni dhe nuk disponoj fatura shoqëruese, pasi janë kryer nga mamaja ime. [...].* Rrethanat e konstatuara për këtë pasuri dhe tokën bujqësore rreth saj, përtej situatës së cilësuar prej tij si pjesë e historisë, në kushtet kur rezultoi e provuar se vetëm subjekti i rivlerësimit, dhe jo familjarë të tjerë të tij, ka paguar taksën e tokës bujqësore dhe taksën mbi ndërtesën deri në vitin 2015⁶⁷, tregojnë se subjekti i rivlerësimit gëzon të drejta reale mbi tokën bujqësore, në të cilën ndodhet kjo ndërtesë.

29.3 Për pretendimin e subjektit të rivlerësimit, *se Komisioni nuk ka patur asnjë pengesë të shkonte të bënte këqyrjen në vend*, trupi gjykues vlerëson se në procesin e rivlerësimit, me natyrë administrative, barra e provës parashikohet si detyrim ligjor i subjektit të rivlerësimit dhe vendimmarrja bazohet në hetimin kryesisht të Komisionit, si dhe shpjegimet e provat e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit. Përgjigjet e depozituara nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, nuk kanë qenë shteruese dhe provat nuk pasqyrojnë të plotë pozicionimin dhe pamjen e kësaj ndërtese, duke u bërë kështu pengesë për një vlerësim të gjendjes faktike të banesës dhe të tokës bujqësore përreth saj, në posedim të subjektit. Kjo sjellje e subjektit duket se e vendos atë në kushtet e një mungese bashkëpunimi dhe krijon perceptimin e një papërgjegjësie të tij në raport me detyrimet që ky proces imponon për subjektet e rivlerësimit, sjellje e cila, po ashtu, u mbajt në vëmendje të vlerësimit së trupit gjykues, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

29.4 Subjekti i rivlerësimit ngre në ankim pretendimin se *si burim i të ardhurave për rikonstruksionin e kësaj banese nga nëna e subjektit janë përdorur të ardhurat nga shitja e banesës në Kodër - Kamëz, të cilat janë burim i ligjshëm, dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.*

⁶⁷ Vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Shëngjergj, nr. {***} prot., datë 31.01.2022.

Banesa është rikonstruktuar nga nëna dhe ajo ka pasur mundësi të plotë financiare për të investuar në këtë banesë. Mosha e prindërve të subjektit të rivlerësimit nuk pengon kryerjen e rregullimeve në banesën në Njësinë Administrative Shëngjergj, sepse edhe nëse ata do të ishin të rinj, rikonstruksioni nuk do të kryhej prej tyre. Komisioni nuk ka analizuar fuqinë provuese të provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për këtë çështje, me qëllim kundërshtimin e barrës së provës në këtë pikë.

29.5 Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues vlerëson se në kushtet kur, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, u konfirmua mungesa e burimeve financiare të ligjshme të prindërve të subjektit të rivlerësimit, për ndërtimin e banesës dy kate + papafingo, në Kodër - Kamëz, Tiranë, në vlerën (-) 4.273.611 lekë, kjo mungesë afekton edhe ligjshmërinë e të ardhurave nga shitja e kësaj banese, të pretenduara si burim për rikonstruksionin e godinës në Shëngjergj, nga nëna e subjektit, me konsideratë efektin zinxhir të paligjshmërisë në veprimet financiare të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur apo të tjerë të lidhur me të.⁶⁸ Për sa sipër, në vlerësimin e trupit gjykues, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar.

29.6 Pretendimi i ngritur në ankim, *se mosha e prindërve të subjektit nuk pengon kryerjen e rregullimeve*, në vlerësimin e trupit gjykues duket i drejtë si arsyetim, për sa kohë punimet mund të realizoheshin edhe nga të tretë, por vendimi i Komisionit për këtë çështje nuk është marrë vetëm mbi këtë konstatim, por është analizuar i ndërthurur dhe me rrethana të tjera të rezultuara gjatë hetimit administrativ, në raport me besueshmërinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, për krijimin e pasurive në posedim apo në përdorim të tij apo/dhe familjarëve të tij.

29.7 Për pretendimin e subjektit të rivlerësimit, *se Komisioni nuk ka analizuar fuqinë provuese të provave të paraqitura nga subjekti, për të kundërshtuar barrën e provës në këtë pikë*, trupi gjykues vëren se ky pretendim i subjektit nuk qëndron, pasi në rastin objekt gjykimi, Komisioni lidhur me këtë pasuri ka konkluduar pasi ka analizuar dhe vlerësuar të gjitha aktet e disponuara në raport me rrethanat specifike si më sipër trajtuar, përfshirë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe provat e paraqitura prej tij gjatë hetimit administrativ dhe në përgjigje të rezultateve të hetimit⁶⁹.

29.8 Sa i përket pretendimit *se subjekti nuk ka kryer fshehje të pasurisë dhe, për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit tregon paragjykim të çështjes e është i pabazuar*, trupi gjykues vlerëson se konkluzionet e arritura nga Komisioni në vendimin e ankimuar janë bazuar në një proces hetimi të plotë, gjithëpërfshirës, në analizën e saktë dhe shteruese të provave të mbledhura, në zbatim të parimeve të procesit të rregullt ligjor. Konkluzioni i Komisionit në vendimin nr. 546, datë 30.06.2022, lidhur me këtë pasuri, nuk dëshmon paragjykim të trupit gjykues të Komisionit, ashtu sikurse pretendon subjekti.

29.9 Në përfundim të sa më sipër arsyetuar, bazuar në rrethana të tilla, si: (1) Mosdeklarimi në deklaratën *vetting*, të tokës bujqësore në posedim; (2) Mosdeklarimi në mënyrë të saktë dhe të plotë të pasurisë “tokë bujqësore” gjatë hetimit administrativ; (3) Mosha e thyer e prindërve të subjektit për të ndërmarrë kryerjen e rikonstruksionit të banesës në Shëngjergj, si dhe mungesa e burimeve financiare të ligjshme të të ardhurave të tyre; (4) Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë në ndonjë mënyrë lidhjen e familjarëve të tjerë me këtë pasuri; (5) Subjekti i rivlerësimit është posedues i saj, si dhe ka paguar detyrimet e parashikuara nga ligji për këtë pasuri; (6) Rrethanat e tjera të konstatuara

⁶⁸ Shih vendimin nr. 21/2023 (JR) të Kolegjit, paragrafi 25.9, që i përket subjektit të rivlerësimit R. A.

⁶⁹ Aktet e paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit janë listuar nga Komisioni në poshtëshënimin nr. 63, të vendimit.

gjatë kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të kësaj pasurie, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

Për pasurinë “tokë bujqësore me sipërfaqe 5336 m²”, në fshatin Shëngjergj, Tiranë

30. Komisioni, në përfundimin për këtë pasuri, ka vlerësuar se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën *vetting*, në kuptim të nenit 33/5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, e cila mund të konsiderohet edhe si fshehje pasurie, në kuptim të nenit 33/5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti nuk ka deklaruar posedimin e një toke bujqësore me sip. 5336 m², për të cilën nuk ka asnjë të dhënë zyrtare nga organet shtetërore se, në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*, ka qenë në posedim të subjektit, duke bërë të pamundur evidentimin e kësaj pasurie nga Komisioni me dërgimin e shkresave institucioneve shtetërore. Për më tepër, kjo pasuri rezulton edhe aktualisht me pronësi shtet. Subjekti ka kryer veprime që bien ndesh me standardet e etikës dhe rregullave të sjelljes së magjistratit, për sa kohë ka poseduar pa asnjë akt ligjor një tokë bujqësore në pronësi të shtetit, për të cilën nuk ka bërë as deklaramin përkatës në deklaratën *vetting*. Komisioni do ta konsiderojë këtë vlerësim si pjesë të vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

30.1 Subjekti i rivlerësimit i kundërshton në ankim këto konkluzione, duke pretenduar se: (1) Nuk e ka deklaruar pasurinë “tokë bujqësore me sipërfaqe 5336 m²”, pasi nuk disponon dokumentacion mbi pronësinë. (2) Pavarësisht se prona figuron në AShK me pronar shtet, nga organet lokale është pronë e trashëguar e familjes *Sh.* dhe nuk ka kryer asnjë veprim që bie ndesh me standardet e etikës dhe rregullave të sjelljes së magjistratit, për sa kohë kjo pronë ka ekzistuar më parë në pronësi të familjes së tij dhe njihet në zonë me toponimin “{***}”. Sipas vendimit nr. 1/2009 të Gjykatës së Lartë, pronar të një pasurie nuk të bën regjistrimi, por titulli i pronësisë.

30.2 Në analizë të pretendimeve më sipër, pas verifikimit të akteve në dosjen gjyqësore të Komisionit, si dhe kontrollit të arsytimit të tij në vendim, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.

30.3 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e datës 07.10.2021, të pyetësorit nr. 1, ka deklaruar se ka në posedim që nga viti 2005, edhe një sipërfaqe tokë bujqësore prej 5336 m², në tagrin e përdoruesit, e cila figuron e regjistruar si *tokë shtet* në zyrat e Kadastrës. Sipas ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit deklaron se ka aplikuar për regjistrimin e kësaj sipërfaqeje toke në emrin tij dhe sqaron se nuk e ka deklaruar posedimin e saj, pasi nuk ka pasur dokumentacion pronësie dhe, duke qenë se figuron *tokë shtet* në hartën kadastrale, i është referuar vetëm sipërfaqes së përfshirë në AMTP. Subjekti ka depozituar plan-rilevimet përkatëse⁷⁰, në të cilat ai rezulton si përdorues.

30.4 Për sa sipër, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi: (i) duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe as në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë që ka në posedim tokë bujqësore me sipërfaqe 5336 m² në pronësi të shtetit; (ii)

⁷⁰ Plan-rilevimin e pasurisë nr. {***}, z. k. {***}, me sipërfaqe 1294 m², fshati Shëngjin i Madh, Njësia Administrative Shëngjergj; Plan-rilevimin e pasurisë nr. {***}, z. k. {***}, me sipërfaqe 1286 m², fshati Shëngjin i Madh, Njësia Administrative Shëngjergj; Plan-rilevimin e pasurisë nr. {***}, z. k. {***}, me sipërfaqe 2142 m², fshati Shëngjin i Madh, Njësia Administrative Shëngjergj; Plan-rilevimin e pasurisë nr. {***}, z. k. {***}, me sipërfaqe 614 m²; fshati Shëngjin i Madh, Njësia Administrative Shëngjergj.

duket se subjekti ka kryer veprime të cilat bien ndesh me standardet e etikës dhe rregullave të sjelljes së magjistratit, për sa kohë ka poseduar pa asnjë akt ligjor një tokë bujqësore në pronësi të shtetit⁷¹.

30.5 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti deklaroi se gjyshi dhe paraardhësit e tij kanë jetuar në Shëngjergj dhe kanë pasur në pronësi shumë sipërfaqe toke, e cila kaloi në pronësi të shtetit dhe në administrim të kooperativave bujqësore. Pas vitit 1990, toka bujqësore u nda në bazë të parashikimeve të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”, por në disa fshatra, përfshirë Shëngjergjin, banorët morën në posedim edhe ato toka të cilat i kishin pasur në pronësi paraardhësit e tyre, para vitit 1944⁷².

30.6 Komisioni, pasi analizoi provat dhe shpjegimet e subjektit, vëren se ai ka pasur në posedim një pasuri me sip. 5336 m², për të cilën kishte detyrimin ligjor që, në zbatim të Aneksit D të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, ta deklaronte në deklaratën *vetting*. Subjekti nuk rezulton ta ketë deklaruar këtë pasuri dhe të ketë depozituar dokumentacionin përkatës. Për herë të parë, kjo pasuri është deklaruar nga subjekti vetëm pas dërgimit të pyetësorit nga Komisioni. Nga hetimi, por edhe nga dokumentacioni i administruar, rezulton se kjo pasuri në posedim të subjektit ka si pronar shtetin, pavarësisht pretendimeve të subjektit, të cilat janë në nivel deklarativ, për sa kohë nuk ka një vendim të organeve kompetente për njohjen dhe kthimin e kësaj pasurie trashëgimtarëve të shtetasi H. Sh. Për rrjedhojë rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit posedon një pasuri shtetërore prej 5336 m², jo në përputhje me legjislacionin në fuqi, veprim i cili vjen në kundërshtim me standardet e etikës dhe rregullave të sjelljes së magjistratit. Për të mos rënduar pozitën e subjektit, Komisioni nuk do të konsiderojë se ai posedon një sipërfaqe prej 58973 m², sikundër është pretenduar prej tij pas kalimit të barrës së provës, por vetëm sipërfaqen prej 5336 m², për të cilën i ka kaluar edhe barrën e provës.

30.7 Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, *se nuk ka deklaruar pasurinë tokë bujqësore me sipërfaqe 5336 m², pasi nuk disponon dokumentacion mbi pronësinë*, trupi gjykues i vlerëson këto pretendime të pabazuara. Në kuadër të procesit të rivlerësimit, neni D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës parashikon se subjektet e rivlerësimit dorëzojnë një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin, dhe ky deklarim, në kuptim të pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë një deklarim i bërë saktësisht dhe plotësisht i pasurive në pronësi e përdorim të tij, dhe personave të lidhur me të. Deklarata e pasurisë *vetting*, sipas shtojcës 2, është miratuar me ligjin nr. 84/2016, parashikuar në

⁷¹ Kodi Penal, në nenin 200 të tij, pushtimin e tokës e klasifikon si kundërvajtje penale. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit kryen detyrën e prokurorit, duke marrë në konsideratë faktin që ai posedon një pasuri shtetërore prej 5336 m², jo në përputhje me legjislacionin në fuqi, duket se ky veprim vjen në kundërshtim me standardet e etikës dhe rregullave të sjelljes së magjistratit, parashikuar nga neni 4, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

⁷² Subjekti ka depozituar: Shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 05.04.2022, të Këshillit të Qarkut Tiranë, sipas së cilës pasuria nr. {***}, me emërtimin popullor “{***}”, z. k. {***}, {***} dhe {***}, me sipërfaqe 58.973 m², mbivendoset në parcelën pa numër, e cila figuron e regjistruar në zërin kadastral “pemëtore”, gjendja deri më 01.08.1991. Sipas plan-rilevimit bashkëlidhur shkresës rezulton se përdorues dhe pretendues është shtetasi S. Sh. Shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 08.04.2022, e Këshillit të Qarkut Tiranë, sipas së cilës nga kërkimi dhe verifikimi i kryer në dokumentacionin e vjetër të para vitit 1946, në arkivin e DAMT-së, në librin nr. {***}, faqe {***}, rreshti nr. {***}, rezulton i regjistruar subjekti me emër H. Sh. në katundin Shëngjin i Madh, me të dhëna pronësie: tokë e punuar 9 dynmë dhe livadhe 2 dynmë, gjithsej 11 dynmë. Shkresë kthim përgjigjeje nr. {***} prot., datë 10.05.2022, e Njësisë Administrative Shëngjergj, sipas së cilës pasuria nr. {***}, z. k. {***}, {***} dhe {***}, me emërtim popullor “{***}”, sipas inventarit të miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendim nr. {***}, datë 01.09.2010, është e llojit “pemëtore”. Sipas gjendjes faktike të vitit 1991, kjo pasuri rezulton “pemëtore” e mbjellë me varietetin kumbull tropojane dhe, nga 1991 e në vijim, është poseduar dhe përdorur nga shtetasi S. Sh. e familja e tij, me pretendimin si pronë e vjetër e trashëguar. Kjo pasuri nuk është ndarë me ligjin nr. 7501/1991, “Për tokën”.

nenin 31, pika 1 të këtij ligji, dhe në të është përcaktuar deklarimi i pasurive në pronësi, në posedim apo në përdorim. Trupi gjykues, mbështetur në sa më sipër, vlerëson se subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte sipërfaqen e tokës objekt shqyrtimi, si një pasuri në përdorim.

30.8 Në referim të përcaktimeve të pikave 8 dhe 14 të Udhëzimit nr. 4095/2016 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së⁷³, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit duhej ta deklaronte marrëdhënien me këtë send në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke dhënë edhe shpjegimet përkatëse mbi llojin, burimin dhe statusin e së drejtës që ushtronte ndaj këtij sendi. Konkretisht, në rubrikën “Deklarimi i pasurive”, për sa i përket objektit të deklarimit dhe mënyrës së deklarimit, formulari dikton përkatësisht si vijon: “[...] Të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite deri në ditën e dorëzimit të pasurisë [...], burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to [...] të cilat ndodhen në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit [...]” – dhe: “Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit [...], pjesën takuese që zotëroni dhe burimin e krijimit të çdo lloji pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë”.

30.9 Nisur nga rrethanat e konstatuara, në të cilat subjekti i rivlerësimit ka pasur në posedim të vazhdueshëm tokën bujqësore që nga viti 2005, si dhe pritshmërinë për ta regjistruar këtë pasuri në emër të tij në referim të kuadrit ligjor të zbatueshëm, në vlerësim të trupit gjykues, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ligjor për deklarimin e marrëdhënies së tij me këtë pasuri në deklaratën e pasurisë *vetting*. Subjekti i rivlerësimit, më së paku, duhet të kishte dhënë shpjegimet e nevojshme për rastin, qoftë edhe sipas pretendimit se tokën në posedim nuk e kishte në pronësi të tij. Nëse ky deklarim do të ishte kryer, do të vlerësohej nga trupi gjykues si një vullnet i qartë i subjektit për të deklaruar në përputhje me ligjin, duke prezantuar plotësisht të gjitha rrethanat që përcaktojnë situatën.

30.10 Në përfundim, lidhur me pasurinë “tokë bujqësore me sipërfaqe 5336 m²”, të ndodhur në fshatin Shëngjergj, Tiranë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016. Ndërsa i përket pretendimit të subjektit, se nuk ka kryer asnjë veprim që bie ndesh me standardet e etikës dhe rregullave të sjelljes së magjistratit, trupi gjykues do ta mbajë në konsideratë atë në kuadër të vlerësimit tërësor të çështjes, sipas parashikimit të nenit 4, pika 2, e ligjit nr. 84/2016.

Për pasurinë automjet “Mercedes - Benz”, blerë në datën 02.03.2017

31. Komisioni në vendim, për këtë pasuri, ka konkluduar se: (i) Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e tij, në kuptim të nenit 33/5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. (ii) Nuk ka kryer deklarim të saktë dhe në përputhje me ligjin, në kuptim të nenit 33/5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. (iii) Ka kryer fshehje të pasurisë “automjet”, në kuptim të nenit 33/5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016. [...].

⁷³ Pika 8 e Udhëzimit, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj.”, nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcakton: “Deklarimi i pasurive të paluajtshme, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor, kontratë shitblerje, kontratë sipërmarrje, aktmarrëveshje, kontratë paraprake, kontratë porositje etj., dhe certifikatën e pronësisë në rastet kur prona është e regjistruar në ZVRPP”. – Dhe pika 14: “Deklarimi i pasurive të paluajtshme, të luajtshme, likuiditeteve etj., në posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit dhe/ose personave të lidhur, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor për këto marrëdhënie juridike, si dhe dokumentacionin justifikues të pronësisë të personit tjetër të lidhur (pronarit)”.

31.1 Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit më sipër si të pabazuara, duke ngritur në ankim dhe parashtirime këto pretendime: (1) Në analizën financiare, Komisioni përlllogarit gjendjen *cash* në vlerën totale 862.310 lekë, e cila rezulton nga gjendja *cash* e vitit 2015, plus gjendjen *cash* të vitit 2016. Mjafton vetëm kjo vlerë, e cila është e përafërt me vlerën e automjetit të blerë në mars të vitit 2017, për të pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti. (2) Mosdeklarimi i shitjes së automjetit “Mercedes-Benz” në vitin 2016, në vlerën 3.800 euro, në DPV-2016, është harresë gjatë plotësimit të deklaratës, por kjo e ardhur është deklaruar në deklaratën *vetting*, dorëzuar në të njëjtin vit. (3) Burimi i të ardhurave për blerjen e këtij automjeti kanë qenë të ardhurat nga të gjitha kursimet e subjektit, përfshirë edhe shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, 3.800 euro. (4) Në deklaratën *vetting*, të plotësuar më datë 26.01.2017, subjekti ka harruar të deklarojë gjendjen e *cash*-it në fund të vitit 2016, e cila rezulton e provuar edhe nga analiza financiare e kryer nga vetë Komisioni. (5) Analiza financiare për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2017 rezulton pozitive, edhe pse kjo periudhë nuk është objekt verifikimi nga Komisioni. Kjo pasuri ka kaluar në pronësi të subjektit vetëm 35 ditë pas plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting* dhe është deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2017. Gjendja *cash*, në fund të vitit 2016, nuk është 56.000 lekë, por 862.310 lekë, dhe kjo ka shërbyer për blerjen e automjetit dhe si rrjedhojë duhet të përfshihet në analizën financiare. (6) Çmimi i blerjes së automjetit është i përcaktuar në kontratë dhe tashmë Kolegji ka konsoliduar jurisprudencën në këtë drejtim, duke theksuar se vlera e shitjes së sendeve, e pasqyruar në akt noterial, përbën vlerë të plotë provuese, duke qenë se çmimi është element i kontratës që vendoset nga palët në kontratë.

31.2 Në analizë të këtyre pretendimeve, pas shqyrtimit të akteve në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.

31.3 Në deklaratën e pasurisë *vetting*, rubrika “Përshkrimi i të ardhurave”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Të ardhura nga shitja e automjetit tip Benz, me targë {***} MF, me kontratën nr. {***}/{***} rep./kol., datë 15/03/2016*”, në vlerën 3.800 euro.

31.4 Në deklaratën e interesave privatë 2016, subjekti ka deklaruar: “*Gjendje cash krijuar për vitin 2016*”, në shumën 58.000 lekë, pjesa takuese 50%, pa deklaruar burimin e krijimit të kësaj shume. Nga analizimi i deklaratës së interesave privatë 2016, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar pakësimin e pasurisë së luajtshme automjet “Mercedes-Benz” apo të ardhurat e realizuara nga shitja e këtij automjeti. Në deklaratën e interesave privatë 2017, subjekti ka deklaruar: “*Blerje automjeti me kontratë shitblerje nr. {***}/{***} rep./kol., datë 02.03.2017, në vlerën 7.000 euro, pjesa takuese 100%*”, por nuk deklaron burimin e krijimit të kësaj pasurie.

31.5 Referuar kontratë shitblerje automjeti nr. {***}/{***} rep./kol., datë 02.03.2017,⁷⁴ rezulton se këtë automjet, subjekti i rivlerësimit e ka blerë nga B. D., vëllai i bashkëshortes, kundrejt çmimit 7.000 euro, i cili nga ana e tij e ka përfituar këtë mjet me kontratë shitblerje automjeti nr. {***}/{***} rep./kol., datë 15.06.2016, nga K. B., në çmimin 13.000 euro. Sipas deklaratës doganore datë 02.06.2016, import, TVSh-ja për zhdoganim mjeti ka qenë në vlerën 367.850 lekë dhe shërbime të tjera, në vlerën 3.043 lekë.

31.6 Nga të dhënat e AMF-së, administruar në dosjen gjyqësore të Komisionit, rezulton se për këtë automjet është prerë policë sigurimi në emër të E. Sh., djalit të subjektit, në cilësinë e përdoruesit, për periudhën 17.06.2016 – 16.06.2017, dy ditë pas nënshkrimit të kontratës së blerjes, të datës

⁷⁴ Përcjellë në Komision nga DPShTRr-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 14.01.2020.

15.06.2017. Nga analizimi i të dhënave të sistemit TIMS rezulton që djali i subjektit të rivlerësimit ka dalë nga kufiri me këtë mjet, në datat 02.07.2016, 03.07.2016 dhe 21.01.2017.

31.7 Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, në vijim të përgjigjeve të datës 07.10.2021, të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *në vitin 2016 kam deklaruar gjendje cash shumë 58.000 lekë dhe të ardhura nga toka bujqësore në vlerën 200.000 lekë. Shitja e automjetit "Mercedes – Benz" në vitin 2016, në vlerën 3.800 euro, e mospasqyruar nga ana ime në DPV - 2016 është një harresë gjatë plotësimit të deklaratës, por kjo shitje është deklaruar në deklaratën vetting, në të njëjtin vit. Burimi i blerjes së këtij automjeti, siç edhe kam shpjeguar në pyetësorin standard, kanë qenë të ardhurat nga shitja e automjetit tip "Mercedes - Benz" (3.800 euro), të ardhurat nga kursimet (nga paga + të ardhurat nga toka bujqësore 2016 – 2017), dhe huaja e marrë nga nëna, 2.000 euro, në vitin 2017.*

31.8 Në kuadër të verifikimit të mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për të blerë me të ardhura të ligjshme automjetin objekt vlerësimi, në datën 02.03.2017, Komisioni ka kryer analizën financiare pa e përfshirë të ardhurën 3.800 euro nga shitja e automjetit "Mercedes - Benz", me kontratën nr. {***}/{***} rep./kol., datë 15.03.2016, për sa kohë subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* apo në deklaratën periodike të vitit 2016, këtë shumë si burim krijimi të pasurisë së luajtshme apo si gjendje *cash*, *cash* i kursyer në fund të vitit 2016. Në deklaratën e interesave privatë 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* 58.000 lekë dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, të dorëzuar më datë 26.01.2017, nuk deklaroi gjendje *cash*, që tregon se subjekti i rivlerësimit ka përdorur gjendjen ekzistuese prej 58.000 lekësh deri në datën e dorëzimit të kësaj deklarate.

31.9 Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi ka konstatuar se: (i) Subjekti i rivlerësimit ka pranuar përdorimin e mjetit gjatë vitit 2016. (ii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur automjet gjatë vitit 2016, pasi e ka shitur mjetin e tij në mars të vitit 2016. (iii) Polica e sigurimit është lëshuar në emër të djalit të subjektit, E. Sh., menjëherë pas blerjes së këtij automjeti. (iv) Subjekti ka dalë jashtë shtetit me këtë automjet gjatë viteve 2016 – 2017. (v) Ky automjet është blerë nga individ B. D., vëllai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, në një vlerë shumë më të ulët se vlera reale e blerjes së tij. (vi) Subjekti nuk ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti në deklaratën e pasurisë *vetting* në përgjigje të pyetësorit standard. (vii) Në vitin 2017, gati një muaj pas plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, subjekti e ka blerë këtë automjet. (viii) Subjekti ka mungesë të të ardhurave nga burime financiare të ligjshme për të blerë këtë automjet në vitin 2016, në vlerën (-) 321,512.64 lekë. Për rrjedhojë, duket se automjeti ka qenë në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

31.10 Në prapësime për rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit dha të njëjtat shpjegime si gjatë hetimit administrativ, duke shtuar se në DPV-në e vitit 2016 ka deklaruar gjendje *cash* për vitin 2016 në vlerën 56.000 lekë, në analizën financiare të kryer nga Komisioni, ndryshimi i likuiditetit është konsideruar vetëm pakësimi i gjendjes *cash* prej 56.000 lekësh. Kjo shumë është gjendje *cash* e shtuar vetëm gjatë vitit 2016 dhe gjendja *cash* në fund të vitit 2016 nuk është 56.000 lekë, por 862.310 lekë, e cila ka shërbyer për blerjen e automjetit dhe, si rrjedhojë, në analizën financiare duhet të përfshihet si ndryshim likuiditeti - 862.310 lekë dhe jo - 56.000 lekë. Automjeti ka kaluar në pronësinë e tij vetëm 35 ditë pas plotësimit të deklaratës *vetting* dhe është deklaruar në DPV-në e vitit 2017. Vlera më e ulët e blerjes së automjetit nga kunati, B. D., lidhet me defektin që ka pësuar ky automjet gjatë

ardhjes nga Gjermania, siç edhe e ka deklaruar në përgjigjet e tij të mëparshme⁷⁵.

31.11 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e depozituar nga subjekti, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Lidhur me deklaratat noteriale të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni mbështetur edhe në jurisprudencën e Kolegjit ka vlerësuar se, megjithëse nuk janë të pavlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, ato nuk kanë fuqi provuese në këtë proces, pasi të krijojnë bindjen se janë konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe se nuk mbështeten nga provat e tjera të administruara. Komisioni, në konsideratë të fakteve të tilla, si: (i) ky automjet, vetëm pak ditë pas plotësimit të deklaratës *vetting* nga subjekti, ka kaluar në pronësi të tij, vlera e ulët e blerjes së këtij automjeti nga subjekti, pasi, sikundër rezulton edhe në rastin hipotetik që ky automjet të jetë blerë nga z. D., në shumën 7.000 euro, ai ka kryer shpenzime të konsiderueshme për riparimin e tij; (ii) subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e automjetit në vitin 2016, në vlerën e tij reale prej 2.153.360 lekësh; (iii) subjekti nuk ka pasur automjet gjatë vitit 2016; (iv) blerjes së këtij automjeti pas shitjes së automjetit të subjektit; (v) mosdeklarimit të përdorimit të këtij automjeti në pyetësin standard dhe në deklaratën *vetting*, krijon bindje se ky automjet ka qenë në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

31.12 Sa i përket mungesës së burimeve financiare të ligjshme për blerjen e këtij automjeti në vitin 2017, Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse, pasi në deklaratën periodike të vitit 2016 ka deklaruar ekzaktësisht gjendje *cash* krijuar gjatë vitit 2016, në vlerën 58.000 lekë, ndërkohë, në deklaratën *vetting*, nuk ka deklaruar gjendje *cash*. Pra, të ardhurat nga shitja e automjetit të subjektit në vitin 2016, nuk mund të përfshihen si kursime *cash* dhe, rrjedhimisht, nuk mund të jenë pjesë e burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit në vitin 2017.

31.13 Trupi gjykues, sa i përket shkakut ankimor, *se subjekti ka harruar të deklarojë gjendjen e cash-it në deklaratën vetting dhe se gabimi në analizën financiare të kryer nga Komisioni është vetëm fakti se Komisioni, në ndryshimin e likuiditetit, ka konsideruar vetëm pakësimin e gjendjes së cash-it në shumën 56.000 lekë*, sjell në vëmendje qëndrimin e Kolegjit⁷⁶ në jurisprudencën e tij, se deklaratimet për burimet e krijimit të pasurive duhet të gjejnë pasqyrim në përputhje me ligjin, në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe ato periodike, përndryshe subjektet vihen në kushtet e pamundësisë për të vërtetuar me deklaratime të mëpasshme ekzistencën e tyre, në funksion të procesit të rivlerësimit. Në këto rrethana, trupi gjykues e gjen të drejtë kryerjen e analizës financiare nga Komisioni, bazuar në deklaratimet e vetë subjektit të rivlerësimit, të cilat përbëjnë provë në këtë proces. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit mbeten në nivel deklarativ, në kushtet kur ekzistenca dhe gjendja e saktë e burimit të pretenduar nuk ka lënë gjurmë për t'u identifikuar në deklaratën e pasurisë *vetting* apo në deklaratat e interesave privatë.

31.14 Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, *se vlera më e ulët e blerjes së automjetit nga kunati lidhet me defektin që ka pësuar kjo makinë gjatë ardhjes së saj nga Gjermania dhe çmimi është*

⁷⁵ Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit dy deklarata noteriale: (i) Deklaratë noteriale nr. {***}/{***} rep./kol., datë 04.06.2022, e R. D.-së, pronar i subjektit privat me aktivitet "Shitblerje të makinave të përdorura", i cili deklaroi se në servisën e tij, në vitin 2016, është paraqitur kunati i subjektit, me një automjet me targa gjermane, dhe pas kontrollit në servis konfirmoi që makina kishte pësuar defekt. Pasi ka lënë makinën në servis për dy ditë, B. D. ka konfirmuar rregullimin e automjetit pavarësisht kostos, pasi ishte dakordësuar me shitësin mbi çmimin. (ii) Deklaratë noteriale nr. {***}/{***} rep./kol., datë 11.06.2022, e shitësit K. D., të këtij automjeti, i cili deklaroi se këtë automjet ia ka shitur B. D.-së, me çmimin 7.000 euro, me kushtin që ky i fundit të merrte përsipër të gjitha shpenzimet e rregullimit të tij.

⁷⁶ Shih vendimin nr. 4/2024 (JR) të Kolegjit, paragrafi 10.5.c, që i përket subjektit të rivlerësimit M. Sh.

i përcaktuar në kontratë, dhe tashmë Kolegji ka konsoliduar jurisprudencën në këtë drejtim mbi vlerën provuese të aktit noterial⁷⁷, trupi gjykues vëren se Komisioni në vendimin e tij nuk ka vënë në diskutim vlerën provuese të kontratës së shitblerjes si akt noterial, por ka trajtuar rrethanat e dala nga hetimi administrativ në funksion të arritjes së konkluzionit përfundimtar mbi vërtetësinë dhe saktësinë e deklaramit të kësaj pasurie.

31.15 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, *se konkluzioni i Komisionit nuk është i bazuar, pasi automjeti ka kaluar në pronësi vetëm 35 (tridhjetë e pesë) ditë pas plotësimit të deklaratës vetting dhe është akoma sot në pronësi të tij*, pas analizimit të dokumentacionit të administruar në dosjen e Komisionit, trupi gjykues konstaton se: (1) Ky automjet është përdorur nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij për dalje jashtë territorit të Shqipërisë gjatë viteve 2016 – 2017. (2) Referuar policave të sigurimit të detyrueshëm për qarkullim brenda territorit të vendit, që i përkasin këtij mjeti, figuron si përdorues djali i subjektit të rivlerësimit, dy ditë pas nënshkrimit të kontratës së blerjes, së datës 15.06.2017, nga kunati i subjektit. (3) Nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar përdorimin e këtij automjeti në deklaratën e pasurisë *vetting*. Ndërkohë, i pyetur nga Komisioni për mjetet në përdorim, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se, për raste familjare, ka përdorur vetëm makinën e nënës së tij.

31.16 Sa i përket pretendimit të subjektit, *se ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e automjetit në vitin 2017, edhe pse kjo periudhë nuk është objekt verifikimi nga Komisioni*, trupi gjykues, në kushtet që subjekti pretendon se si burim për krijimin e këtij mjeti janë përdorur kursimet *cash* të deklaruara gjatë periudhës së rivlerësimit, si dhe gjatë hetimit administrativ rezultoi e provuar se subjekti dhe personat e lidhur me të e kanë përdorur këtë pasuri para plotësimit të deklaratës *vetting*, vlerëson se pretendimi i subjektit, që analiza për verifikimin e pasurisë “automjet” nuk është objekt verifikimi, gjendet e pabazuar. Trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrollon analizën financiare të kryer në Komision për verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të kësaj pasurie, rezultatet e të cilës konfirmuan balancën negative të Komisionit dhe treguan se subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë “automjet”, tip “Mercedes-Benz”, në datën 02.03.2017, si dhe shpenzimet e kryera dhe kursimet e realizuara në këtë vit.

31.17 Në përfundim të analizës së kryer më lart, trupi gjykues, lidhur me pasurinë “automjet Mercedes-Benz”, blerë nga kunati, në vlerën 7.000 euro, përdorur dhe të padeklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe djali i tij në deklaratën *vetting*, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të kësaj pasurie, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me analizën financiare për periudhën e rivlerësimit 2004 – 2016

- 32.** Komisioni ka kryer analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për periudhën para vitit 2003 dhe prej fillimit të detyrës deri në deklaratën *vetting*, nga e cila ka konkluduar se: *i. Subjekti, prej fillimit të detyrës deri në deklaratën vetting, është në pamundësi kumulative financiare në vlerën (-) 3.100.202,95 lekë. ii. Subjekti është në pamundësi kumulative financiare para vitit 2003, në vlerën (-) 4.273.611,68 lekë. Në total, subjekti rezulton me vlerë negative (-) 7.373.814,63 lekë.*

⁷⁷ Subjekti referon vendimin nr. 11/2019 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit E. I., dhe nr. 5/2019 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit A. C. Në vlerësim të Njesisë, jurisprudenca e referuar nuk lidhet me rrethanat e rastit konkret.

32.1 Subjekti i rivlerësimit, në shkaqet e ankimit dhe në parashtrime, ngre këto pretendime: (i) *Konkluzioni i Komisionit është tërësisht i gabuar, tregon në mënyrë të hapur njëanshmëri dhe paragjykim të çështjes.* (ii) *Subjekti i rivlerësimit, prej fillimit të detyrës deri në deklaratën vetting, nuk ka pamundësi financiare. Në analizën financiare duhet të përfshihen të ardhurat nga toka bujqësore, të vërtetuara faktikisht dhe juridikisht si të ardhura të ligjshme në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës.* (iii) *As subjekti dhe as babai i tij nuk janë në pamundësi financiare para vitit 2003.* (iv) *Prindërit e subjektit kanë patur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive të tyre, fakt i provuar plotësisht me dokumentacionin e paraqitur. Komisioni ka kaluar kompetencën për verifikimin e ligjshmërisë së disa pasurive të prindërve të tij.* (v) *Në konkluzion përfundimtar, bazuar në argumentet dhe provat e administruara gjatë hetimit dhe provat e dorëzuara me prapësimet për rezultatet e hetimit, subjekti vlerëson se kalon bindshëm testin e standardit kushtues të provimit të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, sipas përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.*

32.2 Trupi gjykues, pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në shkaqet e ankimit, mbi kalimin e barrës së provës nga Komisioni në tejkalim të parashikimeve ligjore, i ka trajtuar më lart në këtë vendim në përgjigje të shkaqeve respektive për pasuritë e ankimuara. Në analizën financiare janë përfshirë të ardhurat të cilat provohen me dokumentacion mbështetës dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Nuk janë përfshirë të ardhurat nga toka bujqësore, për sa trajtuar më lart në këtë vendim, si dhe janë konsideruar të ardhurat e deklaruara të marra paradhënie nga shitja e shtëpisë në Kodër - Kamëz, të cilat subjekti i ka shkak ankimi vetëm sa i përket qëndrimit të Komisionit për marrjen më rezervë të tyre.

32.3 Rezultatet e kontrollit të analizës financiare të kryer në Komision, nga Njësia e Shërbimit Ligjor, tregojnë se subjekti i rivlerësimit, në kuadër të detyrimit për të justifikuar ligjshmërinë e krijimit të pasurisë “banesë dy kate + papafingo”, deri në fund të vitit 1999, rezulton me pamjaftueshmëri financiare në vlerën (-) 5.064.044 lekë dhe me mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën (-) 3.163.508 lekë, prej fillimit të detyrës deri në deklaratën vetting. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues, në përputhje edhe me jurisprudencën e Kolegjit,⁷⁸ vlerëson se diferenca e pajustificuar me burime të ligjshme, ngelet në vlerën e llogaritur në analizën financiare të kryer në Komision, prej (-) 7.373.814 lekësh.

32.4 Trupi gjykues, në përfundim, lidhur me analizën financiare për periudhën e rivlerësimit 2004 – 2016, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara, shpenzimet e kryera dhe kursimet e realizuara gjatë kësaj periudhe, duke u ndodhur në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të prindërve të subjektit të rivlerësimit

A. Për pasurinë “automjet Volkswagen”, në emër të nënës së subjektit të rivlerësimit

33. Në përfundim, Komisioni për këtë pasuri krijon bindjen se ka qenë në pronësi të fshehur të subjektit për t’u përdorur nga djali i tij, sikundër është deklaruar nga subjekti. Ky automjet, së bashku me pasuritë e prindërve të subjektit, do të jenë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

⁷⁸ Vendimi nr. 33/2022 (JR), i Kolegjit, paragrafi 20.3, që i përket A. Xh.; vendimi nr. 25/2020 (JR), i Kolegjit, që i përket subjektit të rivlerësimit L. D.

33.1 Subjekti i rivlerësimit, në shkaqet e ankimit dhe në parashtrime, kundërshton konkluzionet më sipër, me pretendimet se: (1) Analiza e këtyre pasurive nga Komisioni është kryer tej objektit të hetimit dhe kompetencës së Komisionit. (2) Dyshimet për pasuri të fshehura janë të pabazuara. Argumentet e analizuara nga Komisioni nuk qëndrojnë dhe nga analiza e tyre, jo vetëm që nuk rezulton se automjeti është pasuri e fshehur e subjektit, por rezulton se ky automjet është pasuri e nënës së subjektit.

33.2 Në shqyrtim të pretendimeve më sipër, pas analizimit të akteve në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.

33.3 Me shkresën nr. {***} prot., datë 28.01.2020, DPShTRr-ja ka informuar Komisionin se në pronësi të shtetasës H. Sh., figuron i regjistruar automjeti me targë: {***}. Referuar deklaratës doganore, import {***}, datë 28.07.2017, rezulton se nëna e subjektit ka blerë në Gjermani, automjetin tip Volkswagen, për shumën 5.750 euro dhe ka paguar detyrime doganore, në shumën 188.187 lekë. Në përgjigje të pyetësorit standard të datës 31.01.2020, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti për raste familjare. Nga verifikimi i të dhënave *online* të AMF-së,⁷⁹ rezulton se për periudhën 23.08.2017 – 22.08.2018, policat e sigurimit janë prerë edhe në emër të djalit të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e përdoruesit.

33.4 Në përgjigjet e datës 07.10.2021, të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit deklaroi lidhur me këtë automjet se: *[...] mamaja ime nuk disponon leje drejtimi. [...]. Nisur nga mosha e thyer, aktualisht 82 vjeç, ajo nuk mund të lëvizte më e vetme për nevojat e saj personale, shëndetësore apo për të vizituar të afërmit e saj, prandaj vendosi të blinte një makinë të vogël, me të cilën i kërkoi djalit tim që ta mbante në përdorim dhe, sa herë të kishte nevojë ajo, t'i gjendej pranë për t'i plotësuar nevojat e saj. Burimi i ligjshëm i të ardhurave të nënës sime për blerjen e këtij automjeti ka qenë një pjesë e parave të fituara nga kontrata e shitjes së banesës në Kodër - Kamëz, të cilat kanë qenë të depozituara në bankë [...]. Automjetin e kam përdorur në ndonjë rast për nevoja të ndryshme në varësi të lëvizjeve të djalit tim, kur ai nuk ishte i disponueshëm [...]. Gjatë kohës kur nëna ime e ka pasur në pronësi këtë automjet, djali im e ka parkuar atë në garazhin tim [...]. Për arsye se nëna ime nuk ka pasur ndonjëherë leje drejtimi, automjetin e drejtonte djali im në çdo lëvizje që ajo bënte, kështu që e kishte të domosdoshme sipas legjislacionit në fuqi që të pajisej me policë sigurimi, si drejtues mjeti [...], ky automjet është përdorur nga djali im E., që nga momenti që është blerë nga nëna ime deri në shitjen e automjetit nga ana e saj. [...].*

33.5 Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi: (1) Ky automjet është blerë me të ardhurat e përfituara nga shitja e banesës së subjektit të rivlerësimit. (2) Ky automjet është përdorur nga djali i subjektit të rivlerësimit, por edhe nga vetë subjekti. (3) Duket se nëna e subjektit të rivlerësimit nuk është në gjendje të përdorë këtë makinë personalisht, e për rrjedhojë, duket se ky automjet ka qenë në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

33.6 Pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit prapësoi në lidhje me pasuritë e hetuara nga Komisioni, se prindërit e tij nuk mund të konsiderohen persona të lidhur me të dhe, për këtë arsye, analiza e këtyre pasurive, në vlerësimin e tij, është kryer nga Komisioni tej objektit të hetimit. Periudha kur është blerë ky automjet, nuk është objekt i hetimit të organeve të rivlerësimit. Automjeti është përdorur nga djali i subjektit që nga momenti në të cilin nëna e bleu deri në shitjen e tij prej saj.

⁷⁹ AMF – akronim për Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Shitja që i është bërë këtij automjeti në vitin 2021 dhe depozitimi i shumës nga blerësi, nëpërmjet transfertës bankare në llogarinë e nënës së subjektit, në Raiffeisen Bank ShA, në të cilën ndodhen edhe aktualisht, provon edhe njëherë faktin që ky automjet ka qenë pasuri e nënës dhe jo e subjektit të rivlerësimit.⁸⁰

33.7 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Në lidhje me periudhën e rivlerësimit, subjekti është i saktë kur deklaron se ajo është deri në plotësimin e deklaratës *vetting*, por në këtë rast Komisioni e ka shtrirë hetimin pasi, *së pari*, si burim për këtë automjet kanë shërbyer të ardhurat nga një pasuri e deklaruar në deklaratën *vetting* dhe, *së dyti*, Komisioni dyshon se kjo është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, sepse nga i gjithë hetimi, në më shumë se një rast, subjekti është përpjekur që të justifikojë si pasurinë, ashtu edhe të ardhurat, duke përdorur prindërit e tij. Një ndër këto raste është edhe ky automjet, për të cilin nga hetimi, Komisioni krijon bindjen se ka qenë në pronësi të fshehur të subjektit për t'u përdorur nga djali i tij, sikundër është deklaruar nga subjekti. Konkluzionet mbi këtë automjet do të jenë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave.

33.8 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se analiza e këtyre pasurive nga Komisioni është kryer tej objektit të hetimit dhe kompetencës së Komisionit, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, prima facie, duket se nuk ka pasur detyrimin për të provuar gjatë procesit të rivlerësimit ligjshmërinë e kësaj pasurie, pasi është krijuar jashtë periudhës së rivlerësimit. Komisioni ka arsyetuar lidhur me rrethanat objektive të cilat kanë çuar në hetimin administrativ të kësaj pasurie dhe kanë ndikuar në të, nisur edhe nga fakti që si burim krijimi të pasurisë së luajtshme, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar të ardhurat e përfituara nga nëna e tij prej shitjes së shtëpisë në Kodër - Kamëz, Tiranë, të kaluara në llogarinë e saj bankare, transaksione dhe pasuri për të cilat janë konstatuar problematika, si në deklarim, ashtu edhe në pamjaftueshmërinë e burimit të ligjshëm të krijimit të tyre. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se gjatë hetimit administrativ, nga pohimet e vetë subjektit të rivlerësimit, rezultoi i provuar fakti i përdorimit të automjetit “Volkswagen”, me targë: {***}, në mënyrë konstante dhe të qëndrueshme, jo vetëm nga djali i subjektit të rivlerësimit, por edhe nga vetë subjekti. Kjo sjellje, (i) e parë në këndvështrim të arsyetimit se të drejtat që djali i tij ka pasur mbi këtë pasuri, duket se nuk kanë qenë thjesht prej përdoruesi, (ii) e vlerësuar në harmoni me faktet e tjera që kanë rezultuar në lidhje me pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të tij, (iii) në konsideratë edhe të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të krijuar pasuritë e deklaruara në përdorim apo posedim të subjektit, së bashku, i jep kësaj situate vlerën e posaçme për t'u konsideruar në kuadër të një vlerësimi të përgjithshëm, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

33.9 Në kuadër të këtij arsyetimi, nuk qëndron as pretendimi i ngritur nga subjekti i rivlerësimit, *se shitja që i është bërë këtij automjeti në vitin 2021 dhe depozitimi i shumës nga blerësi në llogarinë e mamasë së tij, në Raiffeisen Bank, provon edhe njëherë faktin që ky automjet nuk ka qenë pasuri e tij*. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, të njëjtin pretendim për të legjitimuar të ardhurat, *post factum*, duket se e ka pasur edhe në rastin e shitjes së shtëpisë në pronësi të tij, në Kodër - Kamëz, Tiranë, për të cilën pretendoi se kalimi i shumës 75.000 euro, në llogarinë bankare të nënës së tij, tregon faktin se banesa në Kodër - Kamëz, Tiranë i përkiste asaj.

⁸⁰ Subjekti i rivlerësimit ka depozituar bashkëlidhur prapësimeve, pasqyrën e llogarisë bankare të nënës së tij në Raiffeisen Bank ShA, në të cilën evidentohet edhe gjendja aktuale e kësaj llogarie bankare.

B. Apartament banimi me sipërfaqe 60.16 m², të ndodhur në rrugën “{*}”, Tiranë, në emër të babait të subjektit të rivlerësimit**

34. Në përfundim, për këtë pasuri, Komisioni ka vlerësuar se mund të jetë në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit dhe konkluzionet për këtë pasuri i ka trajtuar në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

34.1 Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e mësipërme të Komisionit dhe, në shkaqet e ankimit dhe parashtrime, ngre këto pretendime: (i) Kjo pasuri është porositur nga babai. (ii) Është në pronësi të nënës së tij. (iii) Subjekti i rivlerësimit s’ka asnjë interes pasuror në këtë pasuri. (iv) Nuk ka asnjë të dhënë që të krijon dyshimin më të vogël se kjo është pasuri e fshehur e subjektit. (v) Verifikimi i mundësisë financiare të prindërve të subjektit për të blerë këtë pasuri është jashtë kompetencës së Komisionit. (vi) Kontrata e furnizimit me ujë nga UKT është lidhur në emër të nënës, sipas procedurave ligjore në fuqi, dhe është ajo që jeton në këtë apartament, fakt ky që duhet të ishte vlerësuar nga Komisioni dhe jo thjesht procedura e aplikimit për çeljen e kontratës së furnizimit me ujë, që mund të bëhet nga kushdo. (vii) Analiza financiare e audituesit ligjor, vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, tregon se babai ka pasur burime të ligjshme për krijimin e pasurisë “apartament”, duke konsideruar: (a) kursime të babait gjatë gjithë jetës; (b) pension pleqërie të nënës, duke filluar nga data 03.07.1994, sipas vërtetimit të DRSSH-së Tiranë; (c) pension pleqërie të babait të tij, për periudhën 07.09.1989 – 30.11.2016; (ç) të ardhurat e siguruara nga administrimi i ekonomisë blegtorale [...]; (d) të ardhurat nga pagat e motrave si pjesëtare të tjera të familjes; (e) kursimet e akumuluar deri në vitin 2013; (f) të ardhurat nga interesat bankare në vitin 2007, tërhequr në vitin 2010.

34.2 Në analizë të këtyre pretendimeve, pas shqyrtimit të akteve në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.

34.3 Nga hetimi administrativ në Komision⁸¹ ka rezultuar se, më datë 11.10.2007, babai i subjektit të rivlerësimit ka porositur me kontratë sipërmarrje nr. {***}/{***} rep./kol., te shoqëria sipërmarrëse “{***}” ShPK, të përfaqësuar nga Dh. T., apartament në katin e pestë, nr. {***}, në objektin {***}, me sipërfaqe 60.16 m², me vendndodhje në rrugën “{***}”, kundrejt çmimit 60.000 euro. Pagesa është kryer nga blerësi S. Sh., në numrin e llogarisë së shitësit, në Bankën Amerikane,⁸² më datë 05.10.2007, përpara lidhjes së kësaj kontrate. Kjo pagesë konfirmohet nga lëvizjet e llogarisë⁸³ së shoqërisë “{***}” ShPK, në Intesa Sanpaolo Bank ShA. Nga aktet bashkëlidhur shkresës së UKT-së rezulton se aplikimi për çeljen e kontratës së ujit për këtë apartament është bërë nga subjekti i rivlerësimit.

34.4 Referuar dokumentacionit që Drejtoria Vendore ASHK Tirana Veri i përcjell Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 18.10.2021, nga tabela në formatin *Excel*, përdorur gjatë procesit të legalizimit, rezulton se apartamenti {***} është në emër të subjektit të rivlerësimit, dhe se për këtë pasuri është lëshuar leje legalizimi nr. {***}, datë 01.10.2020, për objektin “{***}” ShPK, në emër të H. B. Sh., për pasurinë nr. {***}, me sipërfaqe 56.5 m², ndërkohë që kontrata e sipërmarrjes është

⁸¹ Shih shkresën e UKT-së nr. {***}, datë 03.02.2020.

⁸² Ish-Banka Amerikane e Shqipërisë ShA, aktualisht, Intesa Sanpaolo Bank ShA.

⁸³ Përcjellë Komisionit nga Intesa Sanpaolo Bank ShA, bashkëlidhur kthim përgjigje me shkresën nr. {***} prot., datë 21.10.2021.

lidhur nga babai i subjektit të rivlerësimit, i cili ka ndërruar jetë në vitin 2016.⁸⁴ Ndërsa, me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision certifikatë për vërtetim pronësie në emër të H. Sh., lëshuar më datë 27.10.2020.

34.5 Në përgjigjet e datës 07.10.2021, të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: [...] *Burimi i të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti nga babai i tij i ndjerë kanë qenë kursimet gjatë jetës së tij nga të ardhurat nga puna, të ardhurat nga toka bujqësore, nga pemëtaria, nga blegtoria, nga bletaria, si dhe një pjesë nga trashëgimia e lënë pas vdekjes nga familja e tij. Ky apartament kufizohet me mur të përbashkët me apartamentin e tij, pasi është në të njëjtin kat, por nuk është i lidhur me apartamentin e tij. Në këtë apartament kanë banuar vetëm prindërit e tij dhe aktualisht, pas vdekjes së babait të tij, banon nëna e tij. Aplikimin pranë UKT e kam bërë unë, për shkak se nëna, në atë kohë 79 vjeçe, nuk ishte në gjendje të mirë shëndetësore. [...].* Bashkëlidhur pyetësorit, subjekti ka vënë në dispozicion fotografitë e apartamentit dhe pozicionimin e tij.

34.6 Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi ka arsyetuar se nga verifikimi i fotografive të vëna në dispozicion prej tij duket se apartamenti në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe ai i blerë nga babai i tij janë të lidhur me njëri-tjetrin⁸⁵ dhe, në këto kushte, ka kryer një analizë financiare për të verifikuar mundësinë financiare të babait për ta blerë këtë pasuri, nga e cila ka rezultuar se babai i subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, në vlerën (-) 13.930.349,70 lekë.

34.7 Në përfundim, duke marrë në konsideratë faktet se: (i) Babai i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij apartamenti. (ii) Subjekti ka kryer aplikim për hapjen e kontratës me UKT-në për këtë apartament. (iii) Apartamenti i babait është i lidhur me apartamentin e subjektit të rivlerësimit. (iv) Apartamenti është regjistruar në emër të nënës së subjektit, ndërkohë që ai duhet t'i nënshtrohej regjimit të trashëgimisë ligjore, duke përfutur edhe vëllai dhe motrat e subjektit. (v) Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar asnjë dokumentacion provues për të provuar arsyet e AShK-së për regjistrimin e kësaj pasurie në emër të znj. H. Sh., ndërkohë që kontrata e sipërmarrjes është lidhur me z. S. Sh. dhe, rrjedhimisht, për t'u bërë kalimi i pasurisë, duhej të depozitohej dëshmia e trashëgimisë. (vi) Është e paqartë se pse në dokumentet e AShK-së, gjatë procesit të legalizimit, kjo pasuri ka rezultuar si në posedim të subjektit. (vii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka çelur ende trashëgiminë ligjore të babait të tij, duke u përjashtuar nga kjo pasuri trashëgimtarët e tjerë të tij, Komisioni ka arritur në konkluzionin që duket se ky apartament është në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

34.8 Në prapësimet për rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: [...] *Kontrata e furnizimit me ujë nga UKT është lidhur në emër të mamasë time sipas procedurave ligjore në fuqi dhe ajo jeton në atë apartament. [...]. Apartamenti është regjistruar në emër të mamasë H. Sh., pasi*

⁸⁴ Komisioni ka arsyetuar që është e paqartë se pse kjo pasuri është regjistruar nga ana e AShK-së në emër të nënës së subjektit të rivlerësimit, për sa kohë kontrata është lidhur nga babai i subjektit të rivlerësimit dhe kjo pasuri duhej t'i nënshtrohej regjimit të trashëgimisë ligjore, duke përfutur edhe vëllai dhe motrat e subjektit. Nga ana e subjektit gjatë hetimit nuk është depozituar dokumentacion që ka shërbyer për legalizimin e kësaj pasurie në emrin e nënës së tij, pavarësisht se i është kërkuar nga ana e Komisionit.

⁸⁵ Pasi: (i) veranda e apartamentit të subjektit dhe ajo e apartamentit të blerë nga babai i tij nuk janë të ndara dhe janë vazhduese; (ii) në pjesën e sipërme të kuzhinës së apartamentit të babait të subjektit konstatohen pllaka xhami, të cilat janë të njëjta me pllakat e xhamit të banjës së subjektit. Në kushtet kur nga hetimi duket se këto dy apartamente janë të lidhur me njëri-tjetrin.

*babai im, me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., të datës 09.12.2010, ka deklaruar që këtë apartament e ka porositur për bashkëshorten e tij (mamanë time) dhe regjistrimi i këtij apartamenti pranë ZRPP të bëhet vetëm në emër të saj [...]. Me shkresën kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 30.05.2022, Drejtoria Vendore AShK Tirana Veri, referuar relacionit nr. {***} prot., datë 30.05.2022, nga specialisti hartografik sqarojnë se kur është kryer printimi i planimetrive të të gjithë apartamenteve të katit të pestë, ka ndodhur një ngatërresë emrash dhe apartamentesh në të gjitha apartamentet e ndodhura në objekt dhe në këtë kat. Rrjedhimisht, në formatin Excel, në të cilin janë dërguar të dhënat, këto gabime emrash nuk u ndryshuan. [...].*

34.9 Pasi analizoi shpjegimet dhe provat e vëna në dispozicion nga subjekti, si dhe në konsideratë të fakteve të tilla: (i) ky apartament është në të njëjtin kat dhe i lidhur me apartamentin e subjektit si në verandë, ashtu edhe në sipërfaqe të tjera të tij, pavarësisht faktit se mund të jenë si pasuri të ndara; (ii) prindërit e subjektit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për këtë pasuri; (iii) ky apartament është vetëm në pronësi të nënës së subjektit, bazuar në deklaratën noteriale të babait të subjektit në vitin 2010; (iv) subjekti ka kryer procedurat për hapjen e kontratës me UKT-në; dhe (v) subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti, Komisioni vlerësoi se ky apartament mund të jetë në pronësi të fshehur të subjektit dhe se këto konstatime do trajtohen në vlerësimin tërësor të procedurave.

34.10 Për pretendimin e ngritur nga subjekti i rivlerësimit, *se verifikimi i mundësisë financiare të prindërve të subjektit për të blerë këtë pasuri është jashtë kompetencës së Komisionit*, trupi gjykues, sikurse interpretuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se organet e rivlerësimit nuk kanë ndonjë pengesë që të hetojnë çdo situatë të dyshuar se subjektet e rivlerësimit mbajnë pasuri të fshehura, dyshim i cili duhet të ngrihet mbi rrethana objektive, me relevancë për procesin e rivlerësimit të subjektit që i nënshtrohet këtij procesi. Kontrolli i ligjshmërisë së të ardhurave për krijimin e pasurive të prindërve, në vlerësim të trupit gjykues është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016, lidhur me detyrimin që kanë organet e rivlerësimit për të kryer hetime për çdo pasuri, për të cilën ka të dhëna apo dyshime të arsyeshme se është pasuri e fshehur e subjektit, pavarësisht se ajo mbahet në emër të personave të lidhur, të tjerë të lidhur apo shtetasve të tjerë, që nuk kanë asnjë lidhje me subjektin e rivlerësimit, në kuptim të përcaktimeve të nenit 3, pika 13/14, si dhe nenit 32 të ligjit nr. 84/2016⁸⁶.

34.11 Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, *se nuk ka asnjë të dhënë që të krijon dyshimin më të vogël se kjo pasuri është pasuri e fshehur e subjektit*, trupi gjykues, përveç rrethanave të arsyetuara nga Komisioni, vlerëson se në këtë konstatim ndërthuret vlerësimi logjik dhe i arsyeshëm i të gjitha rrethanave që kanë rezultuar nga hetimi administrativ i kryer në Komision, në konsideratë të indicies kryesore, mungesës së provueshmërisë së burimit të ligjshëm të deklaruar për krijimin e tyre, i cili nuk u provua asnjëherë me dokumentacion provues, mbeti në nivel deklarativ dhe, në një mënyrë apo tjetrën, lidhet me subjektin e rivlerësimit.

34.12 Në analizë të shkakut të ankimit të subjektit të rivlerësimit, *se aplikimi i bërë në UKT duhet të ishte vlerësuar thjesht si një procedurë aplikimi për çeljen e kontratës së furnizimit me ujë*, trupi gjykues vlerëson se Komisioni i është referuar aplikimit, si një ndër rrethanat nga të cilat ka marrë indicie për hetimin e mëtejshëm të kësaj pasurie, konstatim ky i vlerësuar në harmoni me situatat e

⁸⁶ Shih vendimet e Kolegjit: nr. 36/2023 (JR), paragrafi 24; nr. 21/2020 (JR), paragrafi 74, si dhe nr. 4/2021 (JR), paragrafi 147.

tjera faktike. Për sa sipër, konkluzioni përfundimtar i Komisionit për këtë pasuri nuk është bazuar vetëm në ekzistencën e këtij aplikimi, e në vlerësim të trupit gjykues, edhe ky pretendim i subjektit, nuk qëndron.

34.13 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se nëse në analizën financiare do të përfshiheshin edhe të ardhura të tjera përveç atyre të provuara me dokumentacion justifikues ligjor, si të ardhurat e siguruara nga administrimi i ekonomisë blegtorale [...], apo të ardhurat nga pagat e motrave si pjesëtare të tjera të familjes, kursimet e akumuluaru e të ardhurat nga interesat bankarë, analiza do të rezultonte me balancë pozitive, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, për sa arsyetuar më lart në këtë vendim, nuk provoi me dokumentacion provues ligjshmërinë e të ardhurave sipas standardit të vendosur në procesin e rivlerësimit. Analiza financiare e audituesit ligjor, vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit, vlerësohet nga trupi gjykues si akt i hartuar në funksion të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit. Konstatimet e aktit të ekspertimit janë pjesë përbërëse e pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, si në ankim, ashtu dhe në parashtrime, të cilave u është dhënë përgjigje e arsyetuar në këtë vendim.

34.14 Konkluzionet e arritura për pasurinë “apartament banimi me sipërfaqe 60.16 m²”, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, do të vlerësohen nga trupi gjykues së bashku me rrethanat e tjera të rezultuara për pasuritë në emër të prindërve të subjektit, sipas përcaktimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

C. Për pasurinë “depozitë në shumën 100.000 USD”, në Raiffeisen Bank ShA, në emër të babait të subjektit të rivlerësimit

35. Në përfundim, për këtë pasuri, Komisioni ka vlerësuar se mund të jetë në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit dhe konkluzionet për këtë pasuri i ka trajtuar në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

35.1 Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e mësipërme të Komisionit dhe, në shkaqet e ankimit dhe parashtrime, ngre këto pretendime: (i) Konkluzioni i Komisionit është i gabuar dhe në tejkalim të objektit të hetimit të tij. (ii) Babai i subjektit nuk është person i lidhur për këtë pasuri dhe nuk ka asnjë indicie që ta lidhë këtë shumë me subjektin. Në këto kushte, kjo depozitë nuk duhet të ishte objekt verifikimi nga ana e Komisionit. Për të konkluduar nëse një pasuri është pasuri e fshehur, Komisioni duhet ta vërtetojë këtë konkluzion me prova objektive. Indiciet e pasqyruara nga Komisioni janë tërësisht të parëndësishme dhe asnjë prej tyre nuk lidhet me subjektin. (iii) Fakti që babai i ka depozituar këto para në bankë, tregon që nuk ka pasur asnjë arsye për t’i fshehur këto para, sepse është fakt i njohur botërisht detyrimi i institucioneve bankare për të verifikuar ligjshmërinë e parave që depozitohen në bankë.

35.2 Në analizë të këtyre shkaqeve ankimore, pas shqyrtimit të akteve në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.

35.3 Raiffeisen Bank ShA, me shkresën nr. {***} prot., datë 22.01.2020, ka informuar Komisionin se babai i subjektit të rivlerësimit, S. Sh., ka depozituar në datën 22.08.2007, shumën 100.000 USD, me përshkrimin: “Kursime gjatë jetës dhe trashëguar nga prindërit”. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë së babait të subjektit të rivlerësimit në këtë bankë, konstatohet: (i) shuma 100.000 USD është investuar në depozitë me afat 12-mujor, në datën 22.08.2007; (ii) është maturuar më 22.08.2008, duke përfutur interes 4.981,67 USD; (iii) më datë 25.08.2008 është tërhequr shuma 54.483 USD;

(iv) shuma 50.000 USD është riinvestuar në depozitë me afat tremujor; (v) më datë 21.11.2008 është tërhequr shuma 45.136 USD dhe (vi) më datë 04.03.2010 është tërhequr shuma 5.086 USD⁸⁷.

35.4 Në përgjigjet e datës 07.10.2021, të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *burimi i kësaj depozite ka qenë një marrëveshje e babait të tij me shtetasin Dh. T., për shitjen e një sipërfaqe toke në fshatin Shëngjin të Njesisë Administrative Shëngjergj. Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit, subjekti ka depozituar Deklaratën noteriale nr. {***}/{***} rep./kol., datë 19.10.2021, të Dh. T., i cili deklaron, ndër të tjera, se: [...] Në vitin 2007 mendova t'i blija një pjesë toke S. [...] S. më tha se këtë tokë e kishte trashëguar nga babai i tij, por që nuk zotëronte certifikatë pronësie. [...], pas bisedës ne ramë dakord që sipërfaqen 5000 m,² që ishte në afërsi të rrugës buzë lumit Erzen, ta blija me një çmim 9.000.000 lekë. Duke qenë se ishin të interesuar disa persona për këtë sipërfaqe toke dhe unë nuk dëshiroja [...] ta merrte dikush tjetër, i dhashë S. shumën për të cilën ramë dakord. Për rreth një vit nga momenti që i dhashë shumën prej 9.000.000 lekësh S., gjatë bisedës [...], pasi e pyeta në lidhje me tokën që i kisha blerë, ai më tha se nuk kishte mundur ta pajiste akoma me certifikatë pronësie tokën. Për këtë arsye [...] i thashë që nëse do të ishte e mundur nga ana e tij të m'i kthente ato para. [...] shumën e paguar ma ktheu plotësisht, me dy këste, brenda vitit 2008. [...].*

35.5 Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, pasi: (1) është e paqartë se si Dh. T. i ka dhënë një shumë të konsiderueshme, në vlerën 100.000 USD, babait të subjektit, për një veprim në të ardhmen, pa një akt noterial. (2) Duke marrë në konsideratë faktin që babai i subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj depozite, si dhe ndodhet në kushtet e mungesës së dokumentacionit provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të tij, në rrethanat e dhënies në mënyrë të përsëritur nga të tretë, të shumave të konsiderueshme pa dokumentacion noterial, për veprime në të ardhmen, duket se kjo shumë ka qenë në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

35.6 Në përgjigje për rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka prapësuar se *babai i tij nuk është person i lidhur për këtë pasuri/depozitë dhe nuk ka asnjë indicie që ta lidhë këtë shumë me të. Për këtë arsye, kjo depozitë nuk duhet të ishte objekt verifikimi nga ana e Komisionit. Për të provuar interesin e z. Dh. T., për blerjen e disa pasurive të llojit “tokë arë”, për zhvillimin e bizneseve, në vijim të deklaratës noteriale bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 1, subjekti ka sjellë një deklaratë tjetër noteriale me nr. {***}/{***} rep./kol., datë 30.05.2022, në të cilën z. T. shprehet se këtë interes personal të tij e ka konkretizuar edhe me blerjen e disa sipërfaqeve të tjera toke në atë periudhë, në fshatin Pezë, Njësia Administrative Xhafzotaj, Durrës. Kjo deklaratë është e pashoqëruar me dokumentacion provues, pasi nuk u arrit të bëhej kontrata e shitjes së kësaj pasurie, për shkak të pamundësisë në atë kohë për ta regjistruar pronën në ZVRPP.*

35.7 Komisioni nuk i vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe, duke marrë në konsideratë: (i) mungesën e burimeve të ligjshme të babait të subjektit për të justifikuar shumën 100.000 USD; (ii) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me burimin e kësaj shume; (iii) periudhën e depozitimit dhe tërheqjen e kësaj shume në bankë, e cila përkon me momentin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes së subjektit me shoqërinë “{***}” ShPK, për blerjen e apartamentit të tij dhe (iv) përdorimin e interesave të kësaj shume si burim për huan e marrë nga subjekti prej babait të tij, ka arritur në përfundimin se kjo shumë mund të jetë në pronësi të fshehur të subjektit. Këto konstatime, Komisioni i ka trajtuar në vlerësimin tërësor të procedurave.

⁸⁷ Depozita rezultoi e mbyllur tërësisht më datë 15.11.2017.

35.8 Lidhur me shkakun e ankimit, *se babai i subjektit nuk është person tjetër i lidhur për këtë pasuri dhe kjo shumë nuk duhet të ishte objekt verifikimi i Komisionit*, ndryshe nga sa pretendon subjekti, trupi gjykues vlerëson se, në kushtet kur gjatë hetimit administrativ, vetë subjekti ka pretenduar si burim për krijimin e pasurisë “apartament me sipërfaqe 69.6 m²” në pronësi të tij, huan në shumën 4.000 euro, dhënë nga babai në vitin 2013, në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, babai i subjektit kualifikohet si person tjetër i lidhur, për shkak të lidhjes së interesit pasuror. Në vijim të kësaj dispozite, në kushtet që palët konfirmojnë marrëdhënien e huas, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e po këtij ligji, mbartin detyrimin për të provuar ligjshmërinë e krijimit të shumës së dhënë hua, arsyetuar gjerësisht edhe në jurisprudencën e Kolegjit.⁸⁸ Për më tepër, organet e rivlerësimit nuk duhet të kufizohen në kryerjen e hetimeve të nevojshme për të verifikuar dyshimet e ngritura për pasuritë, në rast se ka indicie për pasuri të fshehur.

35.9 Pretendimi i subjektit të rivlerësimit, *se fakti që babai im i ndjerë i ka depozituar këto para në bankë, tregon që nuk ka pasur asnjë arsye për t'i fshehur ato, sepse është fakt i njohur botërisht detyrimi i institucioneve bankare për të verifikuar ligjshmërinë e parave që depozitohen në bankë*, në vlerësim të trupit gjykues, jo vetëm që nuk qëndron, por bie ndesh me deklaratimet e vetë subjektit të rivlerësimit lidhur me burimet e krijimit të kësaj depozite. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion të Komisionit nga institucioni bankar në të cilin është depozituar shuma 100.000 USD, si burim krijimi të kësaj depozite janë deklaruar: “Kursime gjatë jetës dhe trashëguar nga prindërit”, ndryshe nga sa pretendohet gjatë hetimit, që *kjo shumë vjen si rezultat i marrëveshjes me z. Dh. T.*⁸⁹

35.10 Trupi gjykues, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se⁹⁰ Komisioni, me të drejtë, nuk është ndalur vetëm në verifikimin e disponimit të likuiditeteve në bankë nga ana e babait të subjektit, por ka kryer hetim të plotë administrativ, për të përcaktuar burimin dhe ligjshmërinë e krijimit të tyre. Në kushtet që subjekti i rivlerësimit, si gjatë hetimit në Komision, por edhe gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, nuk paraqiti dokumentacion që provon burimet e krijimit dhe ligjshmërinë e kësaj depozite, si dhe rezultoi kontradiktor lidhur me to, për rrjedhojë, depozita prej 100.000 USD nuk e kalon testin e ligjshmërisë, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, duke pamundësuar kështu dhe përfshirjen e huas në shumën 4.000 euro, në mesin e të ardhurave të ligjshme, me burim nga interesat e depozitës.

35.11 Fakti që në llogarinë e babait të subjektit është depozituar shuma prej 100.000 USD, si e ardhur e pretenduar nga një transaksion, të cilit nuk i paraprin apo pason asnjë arsye apo dokument ligjor, nuk është i mjaftueshëm për të konsideruar këtë vlerë si një të ardhur të ligjshme, në kuptim të dispozitave që rregullojnë kontrollin e pasurisë në procesin e rivlerësimit. Trupi gjykues, nga procesi i rivlerësimit të subjektit, vëren se ka një qasje të vazhdueshme të tij për të legjitimuar të ardhurat nëpërmjet kalimit të tyre në bankë, shuma të cilat nuk e arrijnë nivelin e besueshmërisë mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre dhe më pas deklarohen si burim për krijimin e pasurive të tij apo familjarëve të tij, duke pasur në konsideratë këtu shitjen e banesës në Kodër - Kamëz, Tiranë, shitjen e automjetit në emër të nënës apo pretendimet mbi depozitën dhe interesat e saj.

⁸⁸ Shih vendimin nr. 36/2023 (JR), paragrafi 20, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

⁸⁹ Deklaratat noteriale, të depozituara në Komision nga subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës, referuar jurisprudencës së Kolegjit, merren me rezervë në këtë proces, pasi janë kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe për shkak të tij, çka të krijon bindjen se janë konceptuar në favor të deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit. Marrja me rezervë e deklaratave noteriale forcohet sidomos kur nuk mbështeten dhe nuk janë në harmoni me provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit.

⁹⁰ Shih vendimin nr. 52/2023 (JR), paragrafi 13.30, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

35.12 Trupi gjykues kontrolloi analizën financiare të kryer në Komision, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, rezultatet e të cilës konfirmuan mungesën e burimeve financiare të ligjshme për të krijuar pasurinë “depozitë në shumën 100.000 USD”, në Raiffeisen Bank ShA, më datë 22.08.2007.

35.13 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson që konkluzionet e arritura lidhur me këtë depozitë në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, do të trajtohen së bashku me rrethanat e tjera të rezultuara për pasuritë në emër të prindërve të subjektit, sipas përcaktimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

36. Në përfundim të gjithë sa sipër, lidhur me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të prindërve të subjektit të rivlerësimit, përkatësisht: (1) automjet “Volkswagen”, në emër të nënës së subjektit të rivlerësimit; (2) apartament banimi me sipërfaqe 60.16 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, në emër të babait të subjektit të rivlerësimit; (3) depozitë në shumën 100.000 USD, në Raiffeisen Bank ShA, në emër të babait, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të këtyre pasurive, sjellje këto që do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes, sipas parashikimit të paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.
37. Në përfundim të kontrollit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
38. Në vlerësim tërësor të procedurave, lidhur me vlerësimin në tërësi të kriterit të pasurisë, trupi gjykues mban në konsideratë: (i) qëndrimin jobashkëpunues të subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016; (ii) marrëdhënien e tij me tokën bujqësore në fshatin Shëngjergj, (iii) posedimin pa asnjë akt ligjor të një toke në pronësi të shtetit, për të cilin nuk ka bërë asnjë deklaram; (iv) sjelljen e subjektit të rivlerësimit në lidhje me pasuritë e regjistruara në emër të prindërve të tij, për të cilat, nga analizimi i çështjes, rezultoi se subjekti ka tentuar t’i fshehë ose t’i paraqesë në mënyrë të pasaktë këto pasuri, rrethanat e cituara më lart janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
39. Në këto kushte, trupi gjykues e çmoi të panevojshëm analizimin e shkaqeve të tjera të ankimit, të paraqitura në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit, për sa kohë çdo konkluzion lidhur me to, nuk do të arrinte të ndryshonte vlerësimin përfundimtar të trupit gjykues dhe vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 546, datë 30.06.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Arben Sharra.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 26.03.2025.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi